

Miq e dashamirës në përvjetorin e dytë

REVISTË E DASHUR, E MIRËPRITUR...

Më 31 janar të këtij viti në sallën e ekspozimeve të Muzeut Historik Mat, Shoqata Historike-Kulturore “Dilaver Kurti” mbledhi miq dhe bashkëpunëtorë të revistës “emathia” për të bërë konkluzionet e një viti pune dhe shpërndarjen e çmimeve “Penda Budi 2008” për shkrimet, studimet dhe krijimet e publikuara në këtë revistë. Merrnin pjesë studjues, gjurmues, artistë, shkrimtarë e poetë: Gjokë Dabaj, Afrim Koçi, Ferit Këputa, Ramiz Fiçorri, Skënder Tuna, av. Sulejman Cakoni, Rakip Lasku, Halit Muharremi, Basir Bushkashi, Vasil Premçi, Esat Ruka, Hasan Huta, Sefedin Stafa, Myftar Cubaj, Behar Gjoka, Ilirjan Gjika, ma. Teki Kurti, Fatmir Gjestila, Kastriot Marku, Kujtim Porja, Adivie Hoxha, Valentina Kurti, Etleva Çoku, Fitim Sula, Ensuida Kola, Adriatik Doçi, Dritan Kurti etj, intelektualë, mjekë, juristë dhe lexues të apionuar pas revistës. Ishin të pranishëm kryetari i bashkisë së Burrelit Skënder Lleshi, deputetët Qemal Minxhozi e Idriz Xhomara, miku dhe sponsori i revistës, zoti Hasan Lleshi, i cili bashkë me djemtë, Ilir dhe Arian, që në kontaktet e para me ‘ta, me dëshirën për të kontribuar në evidencimin e vlerave të krahinës së tyre, morën përsipër sponsorizimin e revistës në shtypshkronjën e tyre, “ILAR”.

Takimin e nderonin, gjithashtu, përfaqësues të institucioneve dhe drejtorisë kulturore të bashkisë së Burrelit, drejtuesit e mediave lokale: Qemal Cenaj i gazetës “Mati”, Luftim Vani nga “MAT TV”, Genc Murati, “Radio e Parë”, Mat.

Pas fjalës së mirëseardhjes të mbajtur nga kryetari i shoqatës, Artan Kurti, foli sekretari, Aqif Ymeri, i cili bëri një panoramë të përgjithshme të punës me revistën dhe kontribute të tjera të shoqatës.

Revista “emathia” mbylli vitin e dytë të daljes në qarkullim dhe punës për evidencimin e jetës, kulturës dhe historisë që ajo pasqyron. Kjo revistë, në dy vite të daljes, duke shtuar numrat e saj, ka shtuar edhe bashkëpunëtorët dhe sferat që publikon për lexuesit, trashëgiminë kulturore të trevës së Matit, studime e krijime letrare, biografi të njerëzve me kontribute historikë dhe shoqërorë, zëjtare, artistë bashkëkohorë dhe të traditës, pejsazhin historik dhe natyror të mrekullueshëm të trevës së Matit. Në mirënjohje të kontributit të bashkëpunëtorëve, “emathia” shpërndan çmimet “Penda Budi”. Për vitin që kaloi, çmimi “Penda Budi 2008” në fushën e gjuhësisë, toponimisë dhe leksikut të Matit iu dha poetit dhe studjuesit Gjokë Dabaj. Çmimi, të cilin e dorëzoi shkrimtari dhe studjuesi Behar Gjoka, mban vlerësimin për shkrimet e botuara në revistën “emathia”, kushtuar toponimisë dhe leksikut të zonës së Klosit në trevën e Matit.

Në fushën e etnografisë u vlerësua mësuesi Isuf Çollaku. Çmimin për shkrimet kushtuar trashëgimisë kulturore të zonës së Batrës, në trevën e Matit, ia dorëzoi zoti Hasan Lleshi.

Në fushën e historisë u vlerësua me “Penda Budi 2008” historiani nga Fieri, Ilirjan Gjika, për shkrimet e botuara në revistën “emathia”, kushtuar ➡





Skënder Lleshi dhe Hasan Lleshi

← historisë mesjetare të trevës së Matit. Këtë çmim ia dorëzoi studjuesi dhe historiani matjan, Ferit Këputa.

“Penda Budi 2008” në fushën e përkthimeve iu dha përkthyesit matjan, Afrim Koçi, për përkthimin mjeshtror të romanit “Nekrologji Satirike”, të autorit izraelit Efraim Kishon, një fragment i të cilit është botuar në revistën “emathia”. Çmimin ia dorëzoi poeti i mirënjohur, Basir Bushkashi.

Për letërsinë për të rinj, shkrimtari e studjuesi Vasil Premçi, çmimin “Penda Budi 2008”, ia dorëzoi poetes Etleva Çoku, për ciklin me poezi “Rrahjen e zemrës prit!”, botuar në këtë revistë.

Më pas takimi vazhdoi me shfaqjen e fotomontazhit “Mati përballë historisë”, me skenar të Rakip Laskut dhe foto e montazh nga Artan Kurti, mbështetur dhe nga anëtarë të tjerë të shoqatës.

Takimi u mbyll me këngët e bukura, interpretuar nga Shkëlqim Farrici, i riu i tantelentuar Andi Nika dhe grupi folklorik i Teatrit të Fëmijëve Burrel, përgatitur nga Qamil Beshku dhe Igli Punavia. Pas një koktejl, të pranishmit fiksuan këtë pjesmarrje në një foto kolektive, historike, duke mbyllur veprimtaritë e vitit 2008 dhe duke u përgatitur për kontribute të tjera krahinore e kombëtare për vitin 2009.

Për lexuesin e nderuar po botojmë pjesë nga atmosfera e ngrohtë e diskutimeve të krijuesve dhe intelektualëve pjesëmarrës, të cilët kontribuojnë në daljen me sukses të revistës.

Skënder LLESHI, kryetar i bashkisë Burrel
Atë çfarë nuk arritën ta bënin para kësaj kohe, para dy vjetësh, historianët, me sukses po e arrin Artan Kurti, djali i historianit Dilaver Kurti me miqtë e tij dhe bashkëpunim shumë të ngushtë me shtypshkronjën “ILAR”. Evidencimi i vlerave të historisë dhe kulturës, për të cilën kanë nevojë brezat që do të vijnë për ta

pasur dokument të shkruar, po e bën me shumë dashamirësi Artani, të cilit i uroj sukseset më të mira për vazhdimin e botimit të kësaj reviste. Gjithashtu një falenderim desha të përcjell për shtypshkronjën “ILAR”, e cila ka dy vite që e sponsorizon dhe vazhdon ta sponsorizojë. Personalisht i ndjem shumë mirënjohës, sepse po i bën një nder shumë të madh Matit dhe historisë së tij. Ndaj e ftoj zotin Hasan Lleshi të marrë medaljen nga bashkia e Burrelit, ku i shprehim mirënjohjen më të thellë për kontributin që jep “ILAR”-i në evidencimin e trashëgimisë kulturore të trevës së Matit, nëpërmjet shtypit falas që i bën revistës “emathia”.

Hasan LLESHI, sponsorizues i revistës

Faleminderit shumë! E uroj revistën “emathia” në këtë përvjetor të dytë të saj. Sponsorizimin e kësaj reviste, bashkë me djemtë e mi, e bëjmë me kënaqësi duke kontribuar për vendin e rrënjëve tona. I jam borxhli jo vetëm revistës “emathia”, por të gjithë matjanëve, sepse dhe unë jam matjan. Jam lindur dhe rritur në Mat dhe kam shumë detyrime për Matin. Ndaj ftoj të vijnë dhe krijues të tjerë në shtëpinë botuese “ILAR”, se kur bëhet fjalë për trashëgiminë dhe të sotmen e Matit, duhet të jemi dashamirës. Faleminderit dhe njëherë për mirënjohjen dhe suksese në punën tuaj!



Esat Ruka

Esat RUKA, drejtor i Qendrës Kulturore të Veprimtarive Folklorike në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ndjehem i gëzuar që jam dhe një herë ballë për ballë matjanëve të mi, jo vetëm si këngëtar dhe kantautor, por edhe si miq të angazhuar në një nga zëdhëniet bashkëkohore të Matit, të vlerave të tij historike, të një mundësie për të përhapur dhe për të njohur kontributin e gjithë matjanëve, të cilët realisht nuk kanë

qenë të paktë në mundësitë e tyre intelektuale, por ndoshta korsa nuk ishte e pastër. Kam kënaqësinë që në këtë takim bëjnë pjesë jo vetëm matjanë, por dhe miq të Matit. Dua të falenderoj zotin Artan Kurti, i cili mendoj se duhet të ketë kënaqësinë e madhe, që iu dha mundësia të shpërshfaqë traditën, mundësinë e transmetimit të një gjenerate të kaluar, po e quaj Dilaver Kurtin, ndonëse asnjëherë s'është i kaluar kontributi për historinë e vendit të vet. Mendoj se këtë kënaqësi do ta kishin kërkuar shumë vetë, që janë këtu në sallë, të shpërfaqnin publikisht kontributin dhe vlerat e gjenerateve. Pikërisht kjo është arsyeja që na ka mbledhur, ajo që po përpiqem të bëj dhe unë me kolegët e mi. Duke përshëndetur ata që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë për Matin, po përmend vetëm njërin, që është sot midis nesh, zotin Afrim Koçi, i cili në një intervistë botuar në revistën "emathia" thotë se Matit nuk i kanë munguar vlerat. Matit nuk i ka munguar historia, por zëri për t'i shpërfaqur këto vlera në shkallë kombëtare. Kjo revistë është zë i qartë, i pastër, i fuqishëm. Shoh për të parën herë forca intelektuale, të cilët janë të gatshëm jo vetëm për të rrënuar, por mendoj se thellësia e kontributit të gjenerateve të kaluara na bën ne, që të jemi nxënës kokulur të këtij thesari të vyer kulturor. Do të vazhdoj të jem gjurmues dhe studjues i kësaj treve, që i bën nder kombit shqiptar, i cili gradualisht po kupton se Mati është vërtetë një trevë, që i duhet kthyer vëmendja. Mati po del nga sirtaret dhe të parët njerëz, që po evidencojmë këto vlera, jemi ne këtu, bashkërisht. Falemnderit dhe ju uroj suksese!

Behar GJOKA, shkrimtar e studjues

Do desha të shihesha në sy e të përshndetesha me matjanët dhe jo matjanët, artistët, aq sa mundemi, aq sa jemi. Është kënaqësi e veçantë që profesor Gjokë Dabaj, biri i Shestanit, i trojeve etnike, nuk harroi se para se t'i përkasë trojeve ku u lind, i përket Matit me ato studime dhe vlera që përcjell. Është kënaqësi për mua t'i dorëzoj vlerësimin që i bën revista emathia, njëkohësisht është kënaqësi që ai është pjesë e këtij takimi.

Revista "emathia" dhe shoqata "Dilaver Kurti" ka një meritë, që ka vënë okelio të çimeve Budin, poetin dhe prozatorin e parë të letrave shqipe, njeriun që na bëri jo vetëm ne matjanëve, por kudo që jetojnë shqiptarët, të flasin, të shkruajnë, të mendojnë shqip. Është dëshpëruese, kur sheh përpara atij busti hijerëndë të rrijë një hù-pishë. Kjo gjë është dëshpëruese për ata që mendojnë se shkruajnë poezi, kur dhunohet çdo ditë pamja e tij, jo se ka nevojë Budi kurrësesi. Dua tu përshëndes me disa vargje të Budit, kur flet për librin, për poezinë: "N'dorë merrni e këndon, ju që dini me kënduom, / vini veshtë e dëgjoni, ju që dini me dëgjuom". Ky ishte Budi. Të gjithë të tjerët janë stërnipat e tij. Kemi nevojë më shumë se asnjëherë për shpirtin e madh të tij, për shpirtin fisnik të Budit dhe gjithë figurave të tjera. Falemnderit!

Gjokë DABAJ, poet e studjues.

Behar Gjoka dhe Gjokë Dabaj



Unë nuk do të mund të flas aq sa do të dëshiroja, për arsye se jam shumë i emocionuar. Vetëm duhet të jem mirënjohës ndaj të gjithë matjanëve, ndaj të gjithë njerëzve me të cilët kam lidhur jetën time prej një çerek shekulli. Do të dëshiroja që një ditë të këtillë të lumtur për ta pasqyruar jetën, traditën, për të zbuluar rrënjët e veta, ta kishte fatin dhe krahina ime, siç e ka Mati. Do të dëshiroja që krahina ime të ketë djem të këtillë, siç i ka Mati. Por, fatkeqësisht, krahina ime nuk i ka këta, megjithëse mendohet se ka dhënë librin e parë në shqip, "Mesharin" e Gjon Buzukut. Ka dhënë në fushën e folklorit, në fushën e traditës etnokulturore, aq sa do të meritonte të kishte edhe sot një vlerësim të tillë. Një mungesë të tillë, që unë e kam përjetuar qysh në moshën njëzet vjeç, e gjeta këtu në Mat, te kujdesi i ju matjanëve për trevën që ju kanë lënë të parët ju dhe ne. Thuhet se Mati është vendi, nga ku buron shpirti i Arbërit. Nga studimet që janë bërë në fushën e etnogjenezës, del Mati, vendi, zemra ku lindi, rilindi ajo, që ishte reduktuar në



Isuf Çollaku dhe Hasan Lleshi



← kulturën e moçme ilire. Mati mban meritën e rilindjes së etnisë sonë në mesjetë. Uroj që Mati të jetë përjetësisht emblemë e kombit dhe e atdheut tonë! Isuf ÇOLLAKU, mësues në pension e hulumtues. Falenderoj Shoqatën Historike-Kulturore “Dilaver Kurti” gjithë stafin botues dhe ata që e mundësojnë daljen e revistës “emathia”. Kjo është një grimcë e vogël. Sa kemi filluar. Kjo ka qenë revista, që po na frymëzon për të paraqitur traditën kulturore të Matit. Ferit KËPUTA, historian

Më 2 mars 2009, në Muzeun Historik Kombëtar, Instituti i Historisë mban një tryezë shkencore për të debatuar rreth figurës së Skënderbeut dhe origjinës së tij. Në radhë të parë ftoj zotin Ilirjan Gjika, që të jetë mbështetje e jona në atë debat. Edhe historianë të tjerë, matjanë, janë të ftuar të japim kontributin e tyre, që së bashku të mundemi të vërtetojmë se Kastriotët



Ilirjan Gjika dhe Ferit Këputa

rrjedhin nga Mati, pasi padrejtësisht është deformuar vendorigjina e tyre. Kështu, të përpiqemi që Kastriotët t'i rikthejmë në Mat, aty ku e kanë origjinën. Urime revistës “emathia”, urime dhe Ilirjanit për vlerësimin! Ilirjan GJIKA, historian

Dua tu falenderoj të gjithëve, intelektualët matjanë, përfaqësuesit e pushtetit vendor, poetët, miqtë e mi dhe të mikëshës sonë, revistës “emathia”. Dua të falenderoj veçanërisht zotin Artan Kurti, i cili pavarësisht se e ka origjinën nga një familje plot talente, vazhdon të demonstrojë talente të reja. Përveç profesionit të tij, si skulptor, ai shfaqet nëpër faqet e revistës “emathia” si fotograf i talentuar, njohës i mirë i dizanjerit, veprimtar shoqëror, organizator dhe mbi të gjitha një mik i mirë, patriot i trevës së Matit.

Për mua është privilegj, që marr çmimin “Penda Budi 2008”. Në këto çaste ndjem vërtet i kënaqur. Faleminderit shumë!

Afrim KOÇI, përkthyes

E ndjej veten shumë të nderuar nga ky vlerësim që më bën Mati. E vërteta është se unë nuk kam pas shumë kontakte me Matin nga profesioni, se e tillë ka qenë jeta. Është vërtet nder i madh, por duke marrë parasysh dhe një veçori tjetër, që puna ime është punë që “nuk duket” dhe duke u vlerësuar kjo punë, tregon



Afrim Koçi dhe Basir Bushkashi

që Mati ka bërë hapa përpara dhe vlerëson tani jo vetëm punën konkrete, por atë intelektuale, që është punë me të vërtetë disi e veçantë. Kjo tregon që Mati po ecën përpara në fushën intelektuale dhe arrin të vlerësojë ato kontribute, që nuk janë shumë të dukshëm, por që kanë vlerat e veta dhe që tregojnë vlera të një shoqërie. Jam shumë i nderuar dhe falenderoj zotërinjtë e shoqatës “Dilaver Kurti”. Çmimet kanë një të mirë, por dhe një “të keqe”, sepse të detyrojnë që të bashkëpunosh dhe në të ardhmen. Marr përsipër të jem gjithmonë afër revistës “emathia” me kontribute në fushën time të letërsisë, që matjanët, në mënyrë të veçantë rinia, të lexojë më tepër dhe t'i futen fushës së përkthimeve, e cila është një fushë me të vërtetë e vështirë, por që ka vlera. Ju falenderoj të gjithëve!

Vasil PREMÇI, shkrimtar e përkthyes

Edhe unë dëshiroj t'iu përshëndes. Me çfarë shohim, revista “emathia” mbledh çdo vit krijues, njerëz të nderuar, historianë, shkrimtarë e poetë dhe personalitete të tjera publike. Ajo po kryen një mision të jashtëzakonshëm, që qytete të trjerë më të mëdhenj nga potenciali intelektual, nuk e kanë bërë. Kjo është zilia dhe ambicia, që kjo revistë po ngjall në qarqet studimore e letrare. E përmendën parafolësit traditën, siç themi ne oxhakun që prodhon, pra, djali i Dilaverit,



Vasil Premçi

Artani, shoku, miku ynë, që na mbledh me sakrifica shumë të mëdha dhe me përkrahjen e njerëzve fisnikë, ndoshta jo me biznese shumë të fuqishme, por që janë atdhetarë e patriotë matjanë. Unë falenderoj të gjithë ata, që njoh e nuk njoh dhe veçanërisht organizatorët e takimit. Sipas mendimit tim, “emathia” ka mbledhur historianë, ata që duan të sjellin kohën që ka kaluar, shkrimtarët, që merren me vitalitetin e artit, pra me atë, që s’ka ekzistuar kurrë, sepse letërsia dhe historia shkëmbejnë njëra me tjetrën të vërtetat, por dhe fantazitë, gënjeshtat, mashtrimet. Përsëritës krijuesit e rinj, që janë të shumtë dhe ecin në gjurmët e Basirit dhe disa poetëve e shkrimtarëve të tjerë, që kanë lëvruar me sukses letërsinë, poezinë, të ndjeshëm në gjithë Shqipërinë dhe mesa jam njohur, ka mjaft poetë e shkrimtarë të ardhshëm. Pra, radhët do të mbushen me prurje të reja. Sigurisht grupi i punës këtë vit ka vlerësuar poeten Etleva Çokun me çmimin “Penda Budi 2008” për ciklin e fundit me poezi, botuar në revistën “emathia”. Dëshiroj të nënvizoj, se këtu ka mjaft poetë e shkrimtarë të tjerë, që ndoshta me një fjalë të shkurtër nuk mund të veçohen, por që janë shumë interesante. Ndërkaq përsëritës Adivie



Hoxhën, e cila ka nxjerrë vëllimin e fundit “Kam mall”, që sapo ka dalë në qarkullim. Zonjusha Etlevë! Ta gëzoni çmimin dhe të keni suksese gjithmonë e më shumë!

Etleva ÇOKU, mësuese letërsie në shkollën e mesme “Papa Gjon Pali II” Ulëz.

Jam shumë e nderuar që ndodhem sot këtu. Unë kam botuar dy vëllime me poezi, “Diagrama e dhimbjes”, “Iki dhe vij” dhe kam në dorëshkrim një roman, që shpresoj, së shpejti, do të hyjë për botim dhe ju premtoj se do të vazhdoj të shkruaj për vendin tim. Falemnderit Artanit dhe organizatorëve për ftesën, falemnderit për çmimin dhe shumë suksese revistës “emathia”!

Myftar CUBAJ, piktor dhe mësues në Liceun Artistik, Tiranë.

Një pjesë nga të pranishmit më njohin, por disa dhe jo. Dua tu them se kam kaluar pjesën më të bukur të jetës sime në Mat. Tani jetoj në Tiranë dhe kur më pyet dikush se nga je, sa t’u them se nga jam me origjinë dhe ku jam lindur, u them se jam matjan. Pra, e kam për shumë krenari, që kam kaluar pjesën më të bukur të jetës sime në Mat. Me Artanin ruaj kontakte të vazhdueshme, me të cilin na lidh arti dhe periudha kur unë jetoja në Burrel. Numrat e revistës “emathia” i kam të gjitha dhe shpresoj që kjo traditë të vazhdojë. Mati ka djem që nuk e lënë “me rrëshqit”. Ju përsëritës të gjithëve dhe mbarësi!

Sefedin KURTI, vëllai dhe bashkëudhëtari i Dilaver Kurtit

Ju përsëritës të gjithëve, sidomos zotërinjtë e shtypshkronjës “ILAR”, të cilët bëjnë të mundur daljen e revistës, të gjithë ata që shkruajnë në revistë, veçanërisht zotin Ilirjan Gjika, shkrimet e të cilit i lexoj me pasion.

Mbaj mend para dyzet vjetësh, kur shkoja te shpellat e Bruçit, shikoja se të gjitha objektet historike ishin shpërndarë nga hyrjet e shpellave dhe në pjerrësitë para tyre. Unë i mbledha ato enë prej balte dhe i solla në muze. Kështu, mendova se i mbledha të gjitha, por nuk paska qenë kështu. Kur isha para dy vjetësh përsëri me historianët dhe gjurmuesit që shkruajnë në revistën emathia, unë pashë përsëri enë të tjera, të cilat i kishte nxjerrë nga dheu shiu. Pra dhe shiu, ndonjëherë, është zbulues i historisë...

Teki KURTI, master në histori

Kur flasim për Matin, flasim për zemrën e ilirisë. Duke punuar prej disa vitesh në arkivin e shtetit dhe Bibliotekën Kombëtare, kam hulumtuar dhe





Teki Kurti

← kam nxjerrë shumë dokumenta, që kur i lexon, ndjen një shqetësim në vetvete. Si ka mundësi që nuk i kemi ditur?! Unë jam matjan dhe Martaneshi është pjesë e Matit. Historianët e dinë se dokumenti i parë, që japin turqit, nxjerrin se Martaneshi është pjesë e vilajit të Matit. Më vonë, me ndarjet administrative, u kalua me Elbasanin dhe përsëri me Matin. Është me të vërtetë shumë emocionuese, pasi ne nuk kemi thënë që Skënderbeu është nga Mati. Historianë si Barleti e të tjerë, thonë se është nga Mati. Kjo revistë, mendoj, se është homazh që i bëhet vlerave të Matit, pasi po të mos ishin vlerat e kësaj krahine, sot nuk do ta kishim Budin dhe askush s'do ta mbante mend. Kështu, ai do të ishte i harruar. Kontributet e tij vijjnë si një përmendore e madhe vlerash jo vetëm për Matin, por për gjithë kombin shqiptar. Edhe kjo revistë, me faqet e saj, shpalos historinë e trevës së Matit dhe njëkohësisht e bën atë të jetë pjesë e ndërgjegjes sonë kombëtare. Duke punuar për një temë të rëndësishme, siç është qeverisja vendore 1912-1939, pjesa më pikante ishte periudha 1928-1939, përsëri një burrë nga Mati, Ahmet Zogu, ka drejtuar kombin shqiptar me ligjet dhe kodet e qytetërimeve më të zhvilluara, siç ishin ato të Francës dhe të Italisë. Kuptohet, që për arsye të ndryshme, të cilat dihen, këto vlera deri më sot nuk janë thënë, por kontributet dhe periudhat, pa zënë njëra-tjetrën, secila ka vendin e vet në histori, pa i bërë hije pjesës tjetër.

Revista “emathia” është një vlerë e fuqishme transmetuese e historike-kulturore e trevës së Matit, vlera që mbështeten nga shtypshkronja “ILAR”, të cilën edhe unë e falenderoj, sepse ne kemi kudo biznesmenë, që kanë biznese të fuqishme, por që harrojnë të kontribuojnë dhe për vlerat shpirtërore, krijuese, të cilat janë të rëndësishme më tepër se çdo biznes, sepse kush mbështet kulturën e vendit të tij, apo miqve të tij, ai i ka dhënë jetë, jetës. Ju falemnderit organizatorëve për ftesën, të gjithë të pranishmëve, sepse është nder dhe emocion të jesh para jush!

Halit MUHARREMI, teolog e përkthyes

Kam kënaqësinë t'iu përshëndes të gjithëve në 2-vjetorin e ditëlindjes së revistës “emathia”. Gjithashtu kam amanet nga shoqata “Miq të Dijes për Mirëkuptim dhe Paqe”, prej stafit të saj akademik, që t'iu sjell përshëndetjet më të mira, t'i uroj revistës “emathia” jetë të gjatë dhe gjithë bashkëpunëtorëve të saj punë të mbarë në përmbushjen e misionit të tyre fisnik. Erdha në këtë takim me dy qëllime: për të respektuar ftesën, por dhe për tu njohur me bashkëpunëtorët e revistës. Ka shumë personalitete që kanë kontribuar në të gjitha fushat, por nuk kam pasur rastin të njihem me 'ta. Psh, me Gjokë Dabajn mua më duket sikur kam jetuar gjatë, të cilin po e përmend në emër të gjithë të tjerëve, që kanë kontribuar për këtë revistë. Përshëndes të gjithë stafin e revistës, duke filluar nga Artani, që është themeluesi, bashkëpunëtorët më të afërt: Basirin, Aqfin, Rakipin, Hamdiun, Mimosën dhe gjithë të tjerët, që po kontribuojnë për mbajtjen e kësaj reviste. Falemnderit dhe mirupafshim në veprimtari të tilla edhe herë të tjera!

“emathia”



Halit Muharremi

REVISTA “EMATHIA” NË VITIN E DYTË TË SAJ

Aqif YMERI

SEKRETAR I SHOQATËS HISTORIKE KULTURORE “DILAVER KURTI”

Në numrin e parë të revistës emathia kemi shprehur qartë edhe synimet tona, që do të realizojmë me anë të saj. Veç të tjerave kemi theksuar: *“Të ndërgjegjshëm për vlerat, luftërat dhe kontributet madhore të Matit e matjanëve për vendin, por edhe për detyrimin e konservimit të thesareve kulturore dhe evidencimin e arritjeve ndër kohëra, me anë të kësaj reviste kemi vendosur të trokasim në zemrat, portat dhe vetëdijen e çdo matjani, kudo ku jeton e punon, por edhe më tej, duke ndihmuar e kërkuar ndihmë që, ajo çka kemi mundur të krijojmë e trashëgojmë ndër breza, të mos varet, por të përcillet te fëmijët tanë, si edhe në fondin e kulturës, arritjeve dhe trashëgimisë kombëtare. Dhe në se nuk kemi mundur, apo nuk kemi ditur ta përmbushim këtë detyrim deri më tash, ta bëjmë këtë në vazhdimësi, së bashku, për të larë shpirtin dhe realizuar amanetet e të parëve tanë, që krijuan, dhanë e na lanë aq shumë...”*

Shoqata jonë në funksion të këtyre synimeve, që në fillimet e saj, ka bërë kujdes në planifikimin e veprimtarive duke u mbështetur në tabanin e shëndoshë të krijuar nga historiani, arkeologu e etnologu Dilaver Kurti e mjaft historianë të shquar e studiues të tjerë të vlerave të Matit, të qytetërimit iliro-arbëroro-shqiptar të lidhur pazgjidhshmërisht me këtë trevë. Kështu shoqata jonë ka arritur të arkivojë e publikojë shumë dokumente shkrimorë, fotografikë e filmikë, me të cilët po mundësojmë mjaft veprimtari, madje edhe duke bashkëpunuar me institucione për evidencimin e vlerave dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Pjesëmarrje të tilla janë dy aktivitetet kombëtare me iniciues kryesor studjesin e afirmuar Behar Gjoka në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar, që kanë lidhje me ngjarje dhe personazhe të shquar nga historia e letërsisë dhe gjuhësisë të trevës së Matit. Fotomontazhi filmik “Guri i Bardhë në 440 vjetorin e lindjes së Budit” i shfaqur fillimisht nga shoqata jonë në sesionin shkencor kushtuar shkrimtarit patriot Pjetër Budi, në sallën e Muzeut Historik Kombëtar, fotomontazhi kushtuar “545 vjetori i shkrimit më të vjetër të shqipes së shkruar” shfaqur po në Muzeun Historik Kombëtar në tryezën shkencore kushtuar Formulës së Pagëzimit dhe fotomontazhi “Mati përballë historisë”, shfaqur për herë të parë në simpoziumin shkencor kushtuar 31 Korrikut 1943, në Muzeun Historik Mat, në kuadrin e 65-

vjetorit të kryengritjes popullore të Matit, janë realizime me vlera të mëdha të mundësuar me përkushtimin e skulptorit Artan Kurti, poetit Rakib Lasku e veprimtarëve të tjerë pasionantë, që nuk kursehen për të dhënë ndihmesën e tyre modeste.

Kontribute të tjera me vlera shkencore janë dhe shkrimet studimore të publikuara herë pas here në faqet e organit të shoqatës sonë, revistës emathia. Shkrime të tilla si “Mati në labirintet e historisë” apo “Pesha e një embleme”, nga studiuesi i njohur Gjokë Dabaj, ku kundërshtohen shkencërisht historianët fqinjë dhe synimet e njohura ndaj vendit tonë për të përvetësuar territoret dhe simbolet e kulturave të shqiptarëve. Problematika të tilla që ndeshim në këto shkrime me të vërtetë me peshë, na vënë përpara detyrimesh të mëdha që shkallë-shkallë nga hulumtuesit dhe studiuesit e thjeshtë e deri në qarqet akademike, kërkojnë vemendje e vlerësim serioz. Ndonëse çështje të tilla kërkojnë angazhim serioz të akademikëve tanë, por edhe studiuesit matjanë duhet të dinë të gjejnë dyert e bashkëpunimit e të sigurojnë ndihmesën e tyre.

Një nga temat historike e pashtershme është ajo e Kastriotëve, të cilët me Matin i lidh trualli familjar dhe qendrat e mëdha rezidenciale e administrative si: Shtjefni, Stelushi e Petralba. Që në numrin e parë të revistës emathia është prekur kjo temë dhe vazhdon me ambicjen e shumë gjurmuesve e studjuesve, si Ferit Këputa, Lush Susaj, Aqif Ymeri e diku shkarazi edhe nga autorë të tjerë. Na gëzon fakti që historianë jomatjanë si Ilirjan Gjika, pikërisht në periudhën kur jo vetëm deformohet origjina e shtratit familjar dhe epiqendra arbërore, por ka tendenca dhe ➡





← denigrimi të figurës së Skënderbeut, heroit tonë kombëtar, hulumtojnë dhe publikojnë fakte që Mati është vendorigjina e Kastriotëve, ku ata ngritën lavdinë e tyre dhe ku në vazhdimësi trashëguan genin e pastërtisë etnike dhe qëndresës shqiptare.

Gjatë vitit 2008 në faqet e revistës sonë ka zënë një vend të veçantë edhe mbledhja e të dhënave në fushën e etnokulturës. Kjo veprimtari doemos kërkon të stimulohet më shumë dhe është varianti më i mirë për të intensifikuar punën e shumë studiuesve. Në këtë fushë edhe toponimia është një arkiv me vlera të pallogaritshme, por ajo duhet grumbulluar e dokumentuar për t'i shpëtuar harresës dhe asgjësimit pjesë-pjesë në kohë. Një thirrje e tillë është bërë më parë edhe nga studiuesi Adem Kuka, në shkrimin me titull: "Toponimia, thesar i trashëgimisë sonë" në numrin 3 të vitit 2007. Kështu, shkrimi me titull "Thesar kulturo-historik i fshatit Fshat në emrat e vendeve" me autor Gjokë Dabajn, është me të vërtetë thesar i madh i kësaj fushe dhe mendojmë se do të shërbejë si metodikë pune për mjaft studiues nga gjithë treva e Matit. Po ashtu në

këtë fushë edhe shkrimet me titull "Legjenda e toponime në Batërr të Vogël" dhe "Arkitektura, etnografia dhe tradita në Batërr" me autor Isuf Çollakun, meritojnë vemendje të veçantë dhe duhen vlerësuar. Këtë e ka pohuar qartë edhe historiani Gani Mërzira, i cili duke shkruar me nostalgji për fshatin e tij "Kapi, tradita dhe historia", ka nënvizuar thënien e Barletit që mbetet aktuale në çdo kohë: "Njeriu në botë ndjek gjurmët e gjakut të fisit të vet, ky është ligj". Me këtë motiv edhe autorë të tjerë si Skënder Tuna, av. Sulejman Cakoni, Ramiz Fiçorri, Halit Muharremi, Gazmend Kurti, Idriz Pasha etj, sjellin me dashuri e respekt traditat e

vendlindjes së tyre.

Folklori i trevës sonë dhe mbartësit e tij, matjanët, janë pasqyruar me nostalgji dhe profesionalizëm nëpër faqet e revistës nga studiuesit e kësaj fushe Qamil Alushi, Ali Hysneli e Esat Ruka, meritë e të cilit është dhe mbajtja në Burrel e Festivalit të Parë Kombëtar të Këngës Lirike. Gjatë kësaj veprimtarie, tubimi dhe kumtesat e mbajtura në tryezën jubilarë kushtuar orkestrinës së Matit qenë aktivitete, sa homazh e jubilar, aq dhe nxitës e pararendës për veprimtaritë e mëtejshme. Në të ardhmen kontigjente të shoqatës sonë do të ndihmojnë në gjurmimin dhe kultivimin e elementit të traditës, gjë që do të ndihmojë edhe institucionet në këtë fushë për përfaqësim dinjitoz lokal e kombëtar.

Me demokratizimin e Shqipërisë, pas viteve '90, lindi si domosdoshmëri procesi i rishikimit të historisë për periudhat që koha e mëparshme e kishte politizuar e tjetërsuar. Këtu vlejnë për t'u përmendur, në veçanti, periudha e qeverisjes së mbretit Zog dhe Lufta Antifashiste. Për këtë mjaft të spikatura dhe me vlera referimi janë shkrimet e prof. dr. Muharrem Dezhgju, analistit Astrit Kola, Ma. Ilirjana Kaceli, Ma. Teki Kurti e Kujtim Porja të botuara gjatë vitit 2008.

Letërsia, një fushë sa popullore për lexuesit, po aq dhe e specializuar për një nivel të caktuar krijuesish, si një nga prioritetet e shoqatës dhe revistës sonë, ka pasur hapsirën dhe interesimin e duhur. Me nivel kulturor dhe artistik në revistën tonë janë pasqyruar vlerat e shkrimtarëve, poetëve, përkthyesve e studjuesve të letërsisë Afrim Koçi, Basir Bushkashi, Vasil Premçi, Kujtim Stana, Namik Selmani, Hamdi Hysuka, Mimoza Keçi, Fatmir Gjestila, Spartak Kadiu, Zahide Noka (Cenaj), Luan Stafhasani, Fatmir Neli, Valentina Kurti, Etleva Çoku, Iljaz Stana e Fitim Sula. E më pas të rinjtë Dritan Kurti, Lisandër Kola,



Spartak Doku, Ingrid Llaveshi, Olta Klosi, Viola Vata, Rijana Keçi, Fjoralba Vani etj. Interesimi i grupit botues të revistës emathia nuk mjafton vetëm në publikimin e talenteve të reja, por në konsolidimin e formimit të tyre të mëtejshëm në fushën e letërsisë duke e zgjeruar gamën e kontributeve të tyre. Kështu pjesëmarrës të konkursit “Penda Budi 2007” Ensuida Kola dhe Adriatik Doçi, apo të rinjtë Mimoza Tuna, Sokol Llozhi e Bujar Vani, gjatë vitit 2008 kanë pasqyruar edhe shkrime në fushën e gjeografisë, kritikës letrare dhe arteve figurative.

Artet figurative përbëjnë një fushë pak të prekshme pas viteve '90, sa nga krijuesit matjanë, aq edhe nga interesimi i qeverisjes vendore, kur dihet se Mati ka me dhjetra krijues të kësaj gjinie dhe para këtyre viteve ata kishin dhe galerinë e arteve ku ekspozoheshin dhe konservoheshin punimet që përcillnin vlera. Duhet afuar dhe inkurajuar këta, mbase edhe duke u bërë pjesë në projekte që kanë lidhje me planet rregulluese të bashkive dhe komunave tona. Me shumë dashamirësi dhe transparencë kemi prekur në revistën tonë momente të tilla ku artistë të artit figurativ janë lënë jashtë këtyre nismave. Këtu vlen për t'u ritheksuar edhe gjendja aktuale bustit të poetit patriot Pjetër Budi, vepra e të cilit na motivon të shpërndajmë çmime inkurajuese për gjurmime, studime e krijimtari letrare, ndërkohë që busti i tij, në mos para bibliotekës së qytetit, ka mjaft hapsira të tjera dinjitoze për tu ekspozuar. Revista emathia ka pasqyruar vlera dhe aktivitete të artit figurativ, që kryhen apo trashëgojmë në këtë fushë. Përmendim vizitën në qytetin tonë në qershorin e 2008-ës të Artistit të Merituar Naxhi Bakalli, vepra e të cilit duke ilustruar muret e M H Mat, hyn njëherazi në fondin e artë të vlerave të artit figurativ të Matit, po ashtu



vlerat e piktorit, të titulluar “mesdhetar”, Sefedin Stafa janë maja të arritjeve të artit tonë figurativ dhe krenarisë matjane në këtë fushë.

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së shoqatës në 2008, ka qenë bashkëpunimi me shkollat, duke kryer takime sensibilizuese në ruajtjen dhe grumbullimin e kulturës shpirtërore e materiale dhe realizuar projekte kurrikulare në funksion të edukimit të nxënësve me vlerat e trashëgimisë sonë historike e kulturore. Në faqet e revistës publikuam projektin që po e realizojmë, suksesshëm, me nxënësit e fshatit Fshat në Klos, për ta përdorur si shembull për të gjitha shkollat e tjera të rrethit të cilave u afrojmë ndihmesën tonë në metodikë dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Në objektin e shoqatës sonë një nga prioritetet është gjurmimi dhe grumbullimi i trashëgimisë shpirtërore të trevës së Matit. Për këtë përveç materialeve që trashëgojmë nga arkivi i studjuesit Dilaver Kurti, të studjuesve të tjerë dhe veprimtarëve të shoqatës,

synojmë në të ardhmen ta zgjerojmë sofrën e bashkëpunësorëve duke publikuar metodika pune, për t'u ardhur në ndihmë pasionantëve të grumbullimit të folklorit dhe leksikut. Mendojmë se jemi të vonuar përballë rrënimit e asgjësimit të shumë monumenteve të kulturës së trevës sonë, për thirrjen drejtuar të gjitha njësive të qeverisjes vendore për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e këtyre vlerave të cilat nëse i humbasim koha do të na ndëshkojë.



TRYEZË DEBATI KUSHTUAR FIGURËS SË SKËNDERBEUT



Më 5 mars në sallën e aktiviteteve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nën drejtimin e prof. dr. Beqir Metës, drejtor i Institutit të Historisë, u zhvillua tryeza e debatit rreth figurës së Skënderbeut e kërkuar nga një grup studjuesish matjanë kryesuar nga Ferit Këputa. Prej vitesh studjuesi Ferit Këputa ka bërë një punë të mundimshme, gjurmuese e studimore për përcaktimin e vërtetë origjinës së Kastriotëve dhe heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Përfundimet e arritura ai i ka konkretizuar në librin “Vendlindja e Kastriotëve është Mati”. Ndërhijet e shpeshta pranë Institutit të Historisë nga ana e tij, bënë që më në fund ky aktivitet të mbahet, duke përbërë rastin e vetëm, ku institucionet qendrore marrin në konsideratë dhe ulen për të debatuar me matjanët për çështjen e origjinës së Kastriotëve. Zoti Këputa në diskutimin e tij solli njëmbëdhjetë pika referimi, që provojnë drejt për së drejti, apo tërthorazi, origjinën matjane të Kastriotëve, bazuar në dëshmi dhe dokumente lëndore, në të dhënat dhe shkrimet historike të bashkëkohësve të Skënderbeut, Marin Barleti, Dhimitër Frangu etj, të cilët përcaktojnë Matin si vërtetë origjinë të Kastriotëve. Ai nga kjo tryezë kërkoi pranimin nga studjuesit dhe rikthimin në tekstet e historisë, lavdinë dhe vërtetësinë e votrës së Kastriotëve dhe lidhjet e Skënderbeut me Matin.

Në këtë debat referuan profesorë, studjues, njohës të dokumentave dhe historisë së mesjetës si Luan Malltezi, Ferit Duka, Valter Shtylla, Behar Gjoka dhe Dritan Egro. Megjithatë ishte kërkuar që debati të shtrihet rreth Kastriotëve dhe lidhja e tyre me Matin, kryesisht nga diskutantët pati tema mjaft interesante që sollën të dhëna të reja për periudhën e mesjetës, por u anashkaluan prononcimet për burime dokumentare apo materiale që e lidhin trevën e Matit, qendër mesjetare si vendi ku jetuan dhe zhvilluan jetën familjare Kastriotët.

Në këtë tryezë, që nga mediat u publikua si “Konferencë e posaçme shkencore”, ishin të pranishëm zv/ministri i MTKRS-së Ekrem Spahija, studjues të historisë mesjetare, letrave të kësaj periudhe dhe shumë matjanë.

Tendencën e çmitizimit, por dhe largimin nga etniteti i vërtetë i heroit, që vihet re në shtypin dhe studimet e botuara së fundi, e preku në diskutimin e tij prof. dr. Luan Malltezi. Janë të pakuptueshme përpjekjet e të huajve, -tha ai, -për të çmitizuar figurën e heroit tonë kombëtar, por ne, historianët shqiptarë, duhet ta konsiderojmë detyrë tonën tu përgjigjemi me dinjitet. Më pas iu referua veprës së Barletit, si një dokument historik real, që ka paraqitur me vërtetësi figurën e heroit kombëtar. Para përpjekjeve të studjuesve të huaj për ta paraqitur veprën e Barletit si të fryrë dhe jo të vërtetë, na vijnë në ndihmë burimet osmane dhe bizantine, arkivat e shumtë që venë në dukje rolin e Skënderbeut si udhëheqës i rëndësishëm i luftës antiosmane në shekullin XV. Këto të dhëna provojnë se vepra e Barletit është një vepër e vërtetë në thelb të saj.

Prof. dr. Ferit Duka në hyrje të diskutimit të tij theksoi se për figurat e mëdha të historisë në çdo vend ka debate. Në fushën e kërkimeve shkencore asnjëherë nuk reshtin idetë, opinionet, diskutimet, sepse kjo është dhe logjika e kërkimit, herë pas here dalin në dritë fakte dhe dokumente. Ajo që vihet re sot është se në emër të çmontimit të miteve apo të demitizimit të historisë ka tentativa të njerëzve të caktuar për tu bërë sa më të modës, për të pasur akses sa më të madh në diskutimet publike, apo në medja, disa çështje të tilla kanë marrë karakter të mprehtë dhe në emër të demitizimit, ka rrezik që në shumë raste jo vetëm të zbehet figura, në rastin konkret e Skënderbeut, por ajo çka është më e keqja deformohet perceptimi i drejtë që ka publiku për këtë figurë të rëndësishme të

historisë sonë. Duke prekur etnicitetin e Skënderbeut, të përfolur në librin historik më të fundit të dalë në qarkullim, të historianit Oliver Jens Schmitt, prof. dr. F. Duka tha se duhet të bazohemi në të dhënat e burimeve osmane të cilat për shumë çështje konsiderohen primare, në këtë pikpamje janë më të saktë dhe asnjëherë nuk vihet në dyshim etniciteti shqiptar i Skënderbeut.

Prof. dr. V.Shtylla e nisi diskutimin e tij me fakte lidhur me qytetin e Tiranës që theksojnë se fusha e Tiranës ka origjinë antike dhe jo mesjetare. Ajo ka qenë qendër e kryqëzimit të rrugëve antike në territoret shqiptare në drejtimet veriut-jugu dhe perëndim-lindje. Një nga këto rrugë të rëndësishme ka qenë dhe Rruga e Arbërit. Ajo fillonte nga Durrësi, nëpër fushën e Tiranës, kalonte në Gurë të Bardhë për në Dibër të Madhe, me vazhdim drejt lindjes. Pikë tjetër e diskutimit të prof. dr. V. Shtyllës ishin burimet e huaja që tregojnë vazhdimësinë e nderimit të pasardhësve të Skënderbeut. Ka ardhur koha, -theksoi ai, -që për historinë dhe muzeologjinë shqiptare të trajtohen vlerat e familjes së Kastriotëve dhe të princave shqiptarë që aziluan në perëndim pas pushtimit osman, -duke përmendur vendvarrimet e nipërve e pinjollëve të derës së Kastriotëve në Valencia, Mal të Zi, Napoli etj.

Dr. Dritan Egro duke iu referuar dokumentacioneve të kohës solli në vëmendje se Marin Barleti nuk duhet përdorur me cilësinë e burimit të vetëm. Është domosdoshmëri plotësimi i tij me informacion të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga burimet osmane dhe kronikat e tjera lindore si dhe ato italiane. Insistimi i kronikave osmane në faktin se Skënderbeu u kthye për të marrë në zotërim tokat e të atit, është një element i cili ka të bëjë me shkakun se pse Skënderbeu u largua nga osmanët dhe ngriti krye kundër tyre. Që kur ishte personalitet i lartë osman ai kërkoi zotërimet e të atit. Pas vitit 1443 e bëri publikisht një kërkesë të tillë dhe i konsideroi të tijat e të trashëgueshme në linjë familjare. Shteti osman, për vetë natyrën e tij imperiale, tokat e Gjon Kastriotit i konsideronte territore perandorake, pjesë integrale të shtetit osman, ndaj dhe konflikti në fjalë nuk mund të kishte kompromis, fitorja do i përkiste o njërit o tjetrit, Skënderbeu luftonte për tokat e të atit perandoria për sundimet e veta.

Faktet që paraqesin epërsinë që një dokumentacion i caktuar ka në raport me një tjetër në varësi të vendit se ku ka jetuar Skënderbeu, kontakteve të tij politike dhe diplomatike na bëjnë të besojmë se përtej shkrimit empirik të historisë së Skënderbeut, i cili nuk do të shterojë për sa kohë do të zbulohen fakte të reja, aktualisht jemi vetëm në fillimin e përdorimit të metodave dhe teknikave bashkëkohore për studimin e personalitetit të Skënderbeut dhe epokës së tij.

Studjuesi Behar Gjoka duke folur për Skënderbeun në letrat shqipe, theksoi se amplifikimi i figurës së tij fillon të trajtohet në shekullin XIX, shekull i përlindjes shqiptare, si mit i krenarisë dhe vetëdijes kombëtare, simbol i bashkimit dhe qëndresës. Skënderbeu në letërsinë shqipe shpërfaqet i plotë si protagonist, personazh i pashkëputshëm në letrat gjithëkohore dhe gjithëhopsinore duke u trajtuar si luftëtar, prijës dhe simbol i qëndresës arbënore në motet 1444-1468. Ai ka zënë vend në literaturën letrare, historiografike, në artin figurativ, në librat e letërsisë së hershme shqipe me Budin, Frang Bardhin, në vazhdim të Zef Jubani, Zef Serembe, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Gavril Dara i Riu e më pas, duke vazhduar adhurimin e skajshëm të heroit deri në mitizim të figurës së tij e cila ndodhi pikërisht prej rrethanave historike të sundimit shumë shekullor osman si dhe prej ndikimit dhe përhapjes së kulturës letrare romantike.

Nga drejtuesi i tryezës prof. dr. Beqir Meta u kërkua që në këtë debat të sillte të dhëna nga studimi i tij në dorëshkrim dhe studjuesi Ramiz Fiçorri. Studjues e gjurmues të tjerë matjanë, të cilët ishin përgatitur për të sjellë në këtë debat të dhëna dokumentare, materiale e gojëdhana, që lidhen me rrethinat e Petralbës, Stelushit, Shtjefnit e Macukullit (Ilijar Gjika, Aqif Ymeri, Gazmend Kurti, Haziz Porja etj), për arsye kohe nuk e morën dot fjalën, por i arkivuan materialet pranë kryesisë së shoqatës “Mati” me premtimin e kryetarit të saj zotit Gani Hoxha, që ishte i pranishëm në këtë aktivitet, se në të ardhmen do të përmbledhen në një botim, krahas diskutimeve të mbajtura.

“emathia”



EDHE NJË HERË MBI PREJARDHJEN E KASTRIOTËVE

(Burrel, 10 shkurt 1976)

Dilaver KURTI

Kohët e fundit në gazetën “Mësuesi” është bërë një polemikë lidhur me vendin nga dolën Kastriotët dhe ku lindi Skënderbeu. Shkak i këtij fillimi u bë historiografi Kristo Frashëri, i cili në gazetën e sipërme, datë 4 dhe 11 shtator 1974, ndryshe nga dy tezat e derisotme, që i binin Kastriotët nga Mati dhe Hasi, solli një burim të tretë, Dibrën. Pas tij, Kasem Biçoku (“Mësuesi” 11 dhe 18 dhjetor 1974), rimbroti tezën e Hasit. Kurse Aziz Ndreu, në mbështetje të K. Frashërit (“Mësuesi” 14 janar 1976), solli të dhëna nga toponimia e Dibrës. Meqenëse në polemikën e autorëve ka vend për diskutim, këtu poshtë po parashtrojmë mendimet tona. Rruga e ndjekur nga K. Frashëri, si nga ana metodike dhe shkencore, nuk na duket e bazuar. Ai nuk u bën interpretim të drejtë burimeve. Në anën tjetër, nuk u beson bashkëkohësve, të cilët shkruan historinë e Skënderbeut, por merr si të vërteta të dhënat e sotme, pavarësisht se nuk janë bindëse.

Dihet se historiografi i parë i Skënderbeut është humanisti shkodran, Marin Barleti, i cili në veprën e tij monumentale (1508-1510), përveç të tjerave trajton dhe origjinën e Kastriotëve, ku shkruan: “...nuk e quaj me vend, që fisi i Skënderbeut të mbetet krejt i panjohur, por edhe nuk kam ndërmend të përshkruaj gjithë vargun e të parëve të tij, do të jem i kënaqur të prek vetëm një gjë, se krerët e fisit të Kastriotëve e kanë rrjedhën nga Mati prej një dere fisnike...”. Mirëpo për habinë e të gjithëve, K. Frashëri pohon se Barleti me termin “Aemathia”, nuk ka parasysh Matin e sotëm, por Maqedoninë. Që Barleti flet për Matin, nuk ka as më të voglin dyshim. Këtë e ka provuar tashmë historiografia jonë, por megjithatë po sjellim këto fakte:

Barleti na thotë se Petralba është një qytet në Mat, se Stelushi është gjithashtu një qytet po në Mat, se Skënderbeu bëri shumë ndërtime e rindërtime, sidomos në Mat, se Pjetër Perlati ishte nga Mati, se Vojsavës dhe Mamicës iu caktua një tokë në Mat, se Vrana Kontin e bëri dukë të Matit. Dhe për të gjitha këto ai përdor të njëjtin term: *Aemathia*.

Një dokument tjetër i pavarur, bashkëkohës i Skënderbeut, është dorëshkrimi i Pal Engjëllit, i cili la të shkruar në Trininë e Matit më 8 nëntor 1462, Formulën e Pagëzimit, dokumentin e parë të gjuhës shqipe (N. Jorga, *Notes, ext, povers serv. Al'hist. XV, Bucarest. f. 195*). Në këtë dokument përmendet Sancte Trinitatis de Emathia dhe Andrea apiscopus Lissing”. Raste të tilla do të rreshtonim edhe më, por mjaftojnë.

Për të përligjur këtë, K. Frashëri shton se Barleti, kur përmend Krujën, thotë se gjendet në fushat e Matit,

gjë që, sipas tij, nuk është e vërtetë. Edhe kjo e dhënë e Barletit për kohën qëndron. Mati ishte treva nga dolën Kastriotët, kurse Kruja e Dibra u aneksuan më vonë. Pikërisht duke qenë Kastriotët zot e sundues të Matit edhe aneksimet e tyre i lidheshin kësaj krahine. Madje historikisht, për atë kohë, vetëm Mati e Dibra njiheshin

si krahina, kurse Shkodra, Lezha e Kruja, qytete me hinderlandet e tyre. Lumi i Matit kalonte nëpër fushat e Krujës e të Lezhës, prandaj quheshin fushat e Matit, gjë që do të vazhdojnë të emërtohen edhe në burimet e mëvonshme e deri në ditët tona.

Ku qëndron vërtetësia e Barletit? Ai thotë shprehimisht: “...nuk kam ndërmend të përshkruaj gjithë vargun e të parëve të tij...”, gjë që për deri sa thotë kështu, kur ai dinte gjithë të parët, nuk kishte si mos të dinte origjinën e tyre dhe në mos ai, familja e Kastriotëve nga e mori të dhënë. Por ai nuk e bën këtë, se nuk ka ndërmend të merret me paraardhësit e tij, sikundër e thotë vetë, por me hitorinë e popullit tonë me në krye Skënderbeun.

Në anën tjetër dihet se Barleti e shkruan veprën me shtytjen e Pjetër Engjëllit, këshilltar ushtarak i Skënderbeut dhe ia dedikon nipi të Skënderbeut, i cili jetonte në atë kohë në Napoli. Mos vallë i nipi nuk dinte nga ishte gjyshi Skënderbeu dhe familja e tij? A do t'i lejonte vetes një gjë të tillë i nipi dhe Barleti, që t'i vendosnin trojet e tyre atje ku nuk i kishin pasur? Barleti është shumë i informuar në këtë pikë, sa që në “Rrethimi i Shkodrës” (1504), na thotë se Kastriotët sunduan plot njëqind vjet në Mat dhe Shqipëri. Dhe ky realitet përkon me përmendjen e Kastriotasit të parë më 1368 dhe vdekjen e Skënderbeut më 1468. I vetmi gabim i Barletit është se ai nuk shënon në Mat fshatin nga dolën Kastriotët. Por kjo hollësi ishte e tepërt dhe nuk i shkonte për shtat famës së tyre, pasi ajo i kishte kaluar jo vetëm caqet e krahinës, por vendin dhe jashtë.

Pikërisht nga kjo mungesë e Barletit, në kërkim të këtij fshati, studjuesit kanë sjellë interpretime jo të sakta. Gabimi i parë qëndron në atë se ato kërkojnë të gjejnë detyrimisht një fshat ose kështjellë me emrin *Kastri* apo *Kastriot* për të lidhur origjinën e tyre me ‘të dhe, meqenëse në Mat mungon dhe as mund të ekzistonte, kanë dalë jashtë trevës së tij. Pse u dashka ky vend, që në asnjë burim ose të dhënë, nuk thuhet



se Kastriotët kanë dalë nga një vend i tillë. Prandaj nuk ka pse të ngrihen hipoteza dhe legjenda të paqena rreth origjinës së tyre, deri sa burimet më të lashta i njohin me origjinë nga Mati.

Pas Barletit janë dy autorë të tjerë shqiptarë të shekullit XVI, që i bijnë Kastriotët me origjinë po prej Mati. Madje, Andrea Engjëlli (1553), plotëson dhe gjenealogjinë e tyre (*Du Cange, Historia Byzantina, Venetia 1728, f. 348*), sipas radhës së shtrirjes së sundimit nga Mati. Kështu e nis rrjedhën me Konstandin Kastriotin, të cilin e quan zot e princ të Matit dhe Kastrit. Ky i fundit për ne është Stelushi, që pranohet si seli e Kastriotëve deri në pushtimin e Krujës, por ka mundësi të jetë ndoshta Kastri i Mirditës, që e shënon Gegaj. Dhe pastaj shton Gjergj Kastriotin, gjyshin e Skënderbeut, ku zotërimeve të sipërme i shtohet dhe Ujmishti (Lura), të dashura për familjen e Kastriotëve dhe për shtatë breza me radhë, një brez po dhe një jo, përsëriten nga tri herë ashtu si dhe emri *Gjon*. Po këtë do të ndjekë një autor tjetër shqiptar, Dhimitër Frangu (1584) dhe në kuadrin e tyre autori francez Lavardin (1576) etj.

Mirëpo, si Barleti ashtu dhe Engjëlli e Frangu, nuk janë marrë në konsideratë dhe, për çudi, pa asnjë argument bindës, disa studjues janë mbështetur tek autorët e huaj të shekullit XVII e mbrapa.

Bazë e kësaj nisme është konsideruar kronisti raguzian P. Lukari (1605), me të cilin nis vazhda e lajthitjeve mbi Kastriotët. Sipas nesh, ku autor mundohet të plotësojë Barletin, Engjëllin, Frangun dhe në mos të tre, njërin, që duhet t'i ketë pasur parasysh. Në kërkim të një *Kastri* që mungon te këta, duke mos e njohur emrin *Kastri* në Has, që në fakt nuk ekziston për kohën e Kastriotëve. Edhe etimologjikisht, sikundër është provuar, nga trajta *Kastrati* nuk mund të rrjedhë Kastrioti. Nga ana tjetër, Kastriotët nuk e kishin shtrirë sundimin e tyre deri atje, sepse ato vende ishin nën Dukagjinët. Lukari mund të merrej i saktë, po të shënonte burimin nga e mori të dhënë, por për deri sa ajo mungon, i duhet besuar më tepër Barletit si vendas dhe bashkëkohës i Kastriotëve se sa këtij pas dy shekujsh.

I këtij burimi është dhe dokumenti i botuar nga E. Fermentxhin (1892), gjetur në një manastir françeskan të Bosnjes. Ndryshe nga Lukari, që fshatin e shënon *Kastrat*, ai e jep *Kastriot*, por e vendos në Has, afër lumit Drin. Dokumenti i Fermentxhin, sikundër dihet, është lista e një kleriku, i cili shënon familjet fisnike e mbretërore boshnjake e midis tyre dhe disa shqiptare. Dokumenti nuk ka datë dhe duke qenë autentik me Lukarin, është rikopjim i kronikës, ose i pasuesve të tij, duke saktësuar vendin nga *Kastri* në *Kastriot*.

Duke e quajtur të rrëzuar tezën e Hasit, K. Frashëri nuk përfill origjinën matjane të Kastriotëve dhe e rihap problemin me një tezë të tretë, duke e lidhur prejardhjen e tyre me Kastriotin në Dibër, mbështetur te Gjon Muzaka (1510) dhe toponimia.

Dihe se Muzaka, në memoriet e tij, u le kujtim pasardhësve historinë e familjes së tyre, ku midis të tjerave flet dhe për Skënderbeun. Aty ai shënon se gjyshi i Skënderbeut quhej Pal dhe zotëronte fshatrat Sinë e Gardh në Dibër. Pikë së pari, e dhëna e Muzakës nuk është dokument dhe as histori, por kujtime të një personi, të cilit, për aq sa di, nuk mund t'i vihet faj, nëse gabon. Skënderbeun e trajton me përçmim në sy të pasardhësve, sepse në rrugën e centralizimit të pushtetit feudal Skënderbeu aneksoi dhe një pjesë të pronave të Muzakajve. Është ky shkaku që e zvogëlon rëndësinë e origjinës së tyre.

Problemi më i rëndësishëm nuk qëndron këtu, por në faktin se Muzaka na thotë, se Pali ishte zot i këtyre dy fshatrave dhe jo nga këto fshatra. Pra, puna ndryshon, sepse është tjetër të jesh sundues apo zot i një vendi dhe tjetër të kesh dalë nga ai vend. Dhe kjo bie poshtë nga fakti, se Pali nuk mund të ishte nga dy fshatra njëherësh, edhe nga Sina edhe nga Gardhi. Prandaj kjo nuk ka lidhje me fillimet e Kastriotëve dhe as me origjinën e tyre, por me kohën e rritjes së familjes së Kastriotëve dhe coptimin e saj. Në anën tjetër, asgjëkundi nuk është provuar se Pali ishte gjyshi i Skënderbeut. Më tepër në këtë pikë i duhet besuar Engjëllit, i cili shënon Gjergjin, sepse dy parardhësit e tij, Pal e Pjetër Engjëlli, qenë këshilltarë të Skënderbeut, njëri në fushën diplomatike, tjetri ushtarake, nga ka mundësi t'i ketë trashëguar të dhënat pasardhësi i tyre, Andrea Engjëlli.

Në kohën e Gjon Kastriotit familja e tij jo vetëm ishte fuqizuar, por edhe zmadhuar në pikpamje numerike. Ky fakt gjen dëshminë te goja e vetë Gjon Kastriotit, i cili në aktin e dhurimit të Manastirit të Hilandrit thotë: "...kushërinjtë e mi..." (*Burime II 1962, dok. 153*). Këtu është fjala në shumës dhe nuk bëhet fjalë për një kushëri, por shumë, të cilët, kuptohet, zotëronin dhe administronin pronat e kësaj familjeje. Pikërisht me këtë ka të ngjarë se lidhet Pali i Muzakës si zot i Sinës dhe Gardhit, që me sa duket edhe pas vdekjes së Skënderbeut ngelën po aty, pasi më 1467 defteri turk shënon një fshatar me emrin *Dhimitër Kastrioti* në Sinë të Poshtme dhe më 1602 do të shohim që Zef Kastrioti, së bashku me tre krerë të tjerë, ➡



Fragment muri
fortifikues, Stelush

← përfaqëson Dibrën në Kuvendin e Dukagjinit të Matit (*M. Ugolin, "Pagine di Storia Veneta ai tempi di Scanderbeg", Studi Albanesi, 1933-1934, f. 21-25*).

Lind pyetja: A ka pasur në mikrokrahinën e Çidhnës së Dibrës fshat me emrin Kastriot, me të cilin K. Frashëri lidh prejardhjen e Kastriotëve? Ashtu sikundër ka provuar K. Biçoku, një fshat i tillë nuk ekzistonte në të kaluarën. Por, përveç defterit të 1467-ës, që nuk jep asgjë, shënojmë se ai nuk përmendet as në relacionet e Mark Skurës të 1641-1644 (*Relacione II, Tiranë 1965, dok. 36, 63*) në të cilat përmenden fshatrat e dioçezit të Lisit në Mat, nga varen kishat e Matit, Mirditës dhe Katër-Grykëve, Lurës, Muhurrit, Gurrës (Luznisë), Çidhnës, Sinës, Arnit, mikrokrahina në Dibër e deri në Ujmisht dhe Surroi të Lumës.

Dega e Kastriotëve të Sinës mesa duket i shtoi pronat dhe përtej Drinit, në Fushën e Thatë, midis fshatrave Bllaçe, Kukaj, Suhadoll, Brest, Kandër dhe Kishavec, tokë e cila, në saj të pronësisë së tyre, u quajt *Fusha e Kastriotëve*, por duke ruajtur dhe emërtimin natyror *Fusha e Thatë* nga përbërja gjeologjike si tarracë buzë Drinit dhe afluentit të Bllaçës dhe jo Has i Thatë. Kastrioti i sotëm dikur kishte tre emërtime, që ruhen deri në ditët tona: Fusha e Thatë, ose Suhadoll, që kanë të njëjtin kuptim dhe Fusha e Kastriotit, ose Kastriotëve. Historiku i saj duhet lidhur me degën e Kastriotëve të Matit, të vendosur në Sinë e Gardh, fshatra në mikrokrahinën e Çidhnës dhe rrjedhën e majtë të Drinit. Fusha e Kastriotëve gjendej në rrjedhën e djathtë dhe nuk ka pasur, as ka familje të lidhur me emërtimin e Kastriotëve. Në mbështetje të këtij fakti është jo vetëm rrjedha historike, por dhe realiteti, që disa nga ato fshatra janë të populluar me banorë të shpërngulur nga Mati.

Duke mos pasur në këtë trevë, ku sot është Kastrioti, as familje, as lagje dhe as fshat me emrin *Kastriot*, nuk ka asnjë bazë të lidhet origjina e Kastriotëve me këtë vend. Në këtë shekull kjo fushë inproduktive u caktua si qendër e fshatrave përreth, në fillim si komunë e më vonë lokalitet dhe qendër kooperative, ku gradualisht nga Fusha e Kastriotëve u mbiquajt, thjeshtë, Kastriot duke u ligjëruar më vonë edhe si

fshat me këtë emër. Prandaj edhe toponimia e legjendat e kësaj mikrokrahine, të pasuruara e veshura ndër shekuj, lidhen me këtë dukuri dhe jo me origjinën e fillimet e Kastriotëve. Kështu, toponimet e Gjonit nuk kanë të bëjnë me Gjon Kastriotin, por një Gjon tjetër që ka ekzistuar para 5-6 brezave, kurse ai i *Çelia* me prejardhje kishtare nga *Çelë*. Sa për toponimin *Trojë*, këtë mund ta gjeshe jo vetëm një herë në fshat, por disa herë çdo fshat. Por, në mbledhjen dhe interpretimin e këtyre toponimeve dhe të tjera, vihen re shtrembërime e egzagjerime subjektive, për të cilat këtu nuk është vendi të ndalemi.

Kështu, mendimi i K. Frashërit në rrugën historike, *Shgjerdhet* nuk është *Shën Gjergji*, ku sipas K. Frashërit ka lindur Skënderbeu, por Gardhi i shënuar në burime.

Provë në mbështetje të tezës së origjinës nga Mati të Kastriotëve është defteri i vitit 1467, i cili shënon Mark Kastriotin *jamak* në fshatin Shtjefën të Matit. Në këtë dokument, ndryshe nga Dhimitër Kastrioti i Sinës që është fshatar, Marku i Shtjefnit të Matit është *jamak*, dmth fisnik. Kjo përkon me Barletin, i cili shprehimisht tregon se : "...krerët e fisit të Kastriotëve e kanë rrjedhën nga Mati...". Pra, midis familjes së madhe të tyre, e cila tashmë ishte copëtuar, burimi i saj ishte nga Mati. Dhe më tej vazhdon: "...prej një dere fisnike...", gjë që gjen vërtetësi në fisnikërinë e Mark Kastriotit të Shtjefnit.

K. Frashëri e ve në dyshim se Mark Kastrioti mund të jetë nga Shtjefni, pasi tradicioni feudal mesjetar nuk pranon që zotërit e një vendi të ishin vendas. Nëse do t'i referohemi defterit, megjithëse ai nuk shënon gjendjen reale të banorëve, bie në sy se Andrea Kipota (*Këputa*, DK) i shënuar si *jamak* po në Shtjefën, krahas Markut e gjejmë të regjistruar në Derjanin kufitar. Madje si për çudi, ky Mark Kastrioti ka lënë gjurmë në Shtjefën. Kështu edhe sot e kësaj dite një varrezë e veçantë quhet "Vorret e Markajve". Disa familje me zë të vendosur në mikrokrahinën e Çidhnës e lidhin origjinën e tyre me këtë derë. Fshati Shtjefën gjendet në mikrokrahinën e Prellit të Matit, ku gojëdhana e toponimia, që lidhet me Kastriotët, është aq e madhe, sa do të duhej një volum t'i përmbledhje.

Por ne po shënojmë disa:

Të dhënat burimore, bibliografike, toponimike e gojdhane shënojnë një katërkëndësh të vërtetuar në hapsirë dhe kohë midis defterit 1467, Barletit, toponimisë e gojdhane të mbledhur gjatë shekullit XIX-XX, para botimit të historisë së Skënderbeut nga një varg studjuesish, si Ippen, Hahn, Barbarik, Sirdan, Noli etj. Kështu, të gjithë këta studjues njëzëri pranojnë se në Shtjefën të Matit është një fis me emrin *Kastriot*, të cilët e mbajnë veten të një gjaku me Skënderbeun, paralelizëm që nuk gjendet në asnjë vend tjetër. Edhe sot e kësaj dite një lagje e këtij fshati quhet *Kastriot*. Ky fis e lidh veten e tij jo vetëm me Skënderbeun, por dhe me kështjellën e Stelushit, që gjendet aty pranë dhe është konsideruar një ndër

Stelushi



kalatë më të rëndësishme dhe kryeqendra e Kastriotëve, deri në pushtimin e Krujës. Për karshi varrezës, në krye të fshatit, janë Trojet e Vjetra, që lidhen me Kastriotët, ku ka rrënoja e mure. Më poshtë është një pus, që quhet “Bunari i Skënderbeut” dhe ara Skënderbe. Përroi aty pranë, së bashku me një arë, quhet Masrek. Gojdhana pohon se e ëma e Skënderbeut, Vojsava, është varrosur te kisha. Kurse një varr i shenjtë quhet *Vorri i Gjokës*, që me sa duket ka lidhje me Gjokën e Shllit, që sipas gojzës, ishte arkëtari i Skënderbeut.

Në popull ekziston shprehja: *“Shqefanjakë e barbullej, turku mrena asnja s’i len”*, duke e lidhur domethënien e saj, se këto ishin të një gjaku me Skënderbeun, prandaj turku nuk i len brenda. Duvaku i nuses së Prellit ishte i stolitur në ballë me një shqiponjë dykrenare, simbol që ruhet dhe te guna fshatare dhe në dekoracionet e kullave, ku madje në disa të moçme shqiponja shoqërohet me yllin me gjashtë cepa, duke përkuar në mënyrë të plotë me stemën e Kastriotëve. Gojdhana pohon: *“Kastriotët e Shtjefnit i nifte Stamolli, ishin derë me za, gjak i idhët e shpëi zakoni. Po raje në dorë të tyne nuk të pritshin, të prinë përpara të çilshin, po s’i gave nuk të gitshin”*. Në Lis, në kufi me Shtjefnin, ishte peshkopata e Lisit. Mbi Shtjefën, te Trinia, më 1462, pra në kohën e Skënderbeut, u shkrua dokumenti i parë i gjuhës shqipe. Po afër kësaj është Stelushi, pranë të cilit kalonte rruga tradicionale nga Shufadaja për në Dibër e Kosovë, e cila kontrollohej nga Kastriotët. Kalaja e dytë me zë në Mat e Kastriotëve është Petralba, e cila, sipas Barletit, ishte ndeja e Skënderbeut, ku ai la gruan pas martesës së tij.

Po tu shtojmë këtyre kujdesin e veçantë që pati Skënderbeu për Matin, si vendin e prejardhjes së tij, kuadri del edhe më i qartë. Barleti dhe burimet na informojnë se ai në

Mat bëri shumë ndërtime e rindërtime. Në Stelush caktoi të nipin, Hamzanë, si komandant. Në Petralbë rrinte vetë. Mamica në Petrelë, Pjetër Perlatin nga Mati e caktoi komandant të Sfetigradit. Vrana Kontin, që mesa duket ishte nga Vranajt e Macukullit, komandant të Krujës dhe më vonë kryepar të Matit.

Edhe të dhënat e mëvonshme, si një trevë nga dolën Kastriotët, lidhen me këtë truall. Kështu, i

biri i Skënderbeut, Gjoni, më 1481, në përpjekje për të fituar principatën atërore, synon Stelushin si seli të tyre. Kujtimi i tyre mbetet këtu, saqë në emër të Kastriotëve, më 1594 në Lis mbledhet kuvendi i parë shqiptar për luftë kundra turqve, që pasohet më 1601-1602 nga më i madhi kuvend shqiptar i mbledhur në Dukagjin po të Matit, afër Shtjefnit, ku morën pjesë delegatë nga 15 krahina të Shqipërisë.

Të gjitha këtyre po u shtojmë një paralelizëm, që lidhet me emrin e Kastriotëve. Edhe sot e kësaj dite në fshatin German të Matit gjendet një familje e madhe e coptuar, që mban emrin e një burimi me të Kastriotëve dhe quhen *Barioti, Bariotët, Bariotëve*.

Të gjitha këto të dhëna përputhen në mënyrë bindëse dhe hedhin dritë mbi të vërtetën e Barletit për origjinën matjane të Kastriotëve, duke e plotësuar dhe lidhur prejardhjen e tyre me fshatin Shtjefën të Matit, afër Stelushit.

Nga kjo bjen vetvetiu çdo hipotezë mbi lidhjen e Skënderbeut jashtë Matit. Kuptohet, që duke qenë djalë i Gjon Kastriotit, i cili e kishte fuqizuar principatën dhe në Mat, përveç Stelushit, si seli kishte dhe Petralbën e ndoshta dhe kështjella të tjera dhe lindja e tij duhet kërkuar këtu.

Lidhur me lindjen e Skënderbeut në Mat ekzistojnë katër legjenda, që lidhen me Stelushin, Petralbën, Komsinë dhe Kishën e Dukës në Rripë. Pra, ashtu si figura e tij, që është bërë legjendare edhe lindja e tij mbetet legjendë. Por, më shumë ka të ngjarë që ai të ketë lindur në Stelush, ku Kastriotët patën selinë, sidomos i ati, Gjoni. Megjithatë gojdhana për Petralbën thekson: *“Skanderbegju ka lë në kalanë tonë kur e ëma ishte gjeshtare”*, dmth kishte dalë për verim. Sidoqoftë në një nocion më të gjerë, duhet pranuar se ai lindi në Mat dhe i përket epokës së tij, popullit shqiptar nga doli dhe i shërbeu me heroizëm.

Petralba



HISTORIA TË RISHKRUHET MBI FAKTE TË VËRTETA

Ilirjan GJIK

1.

Rishkrimi i historisë ishte një term që qarkulloi rreth një vit më parë dhe u prit në forma të ndryshme nga publiku shqiptar, i cili nxitoi menjëherë të jepte opinionet e tij rreth këtij problemi. Rreth tij u shprehën mendime të ndryshme, ku nga sa e pamë auditori i gjerë u nda në dy kampe. Në të parin, ata më radikalët, ngritën zërin që: historia duhet rishkruar, ndërsa më pas erdhi reagimi i kampit të të moderuarve. Këta të dytët u shprehën që: çdo gjë duhet të ruhet me kujdes, se historia nuk çbëhet, dhe gjithçka që ka ndodhur nuk mund të ndryshohet. Por kur debati nisi të fashitet paksa, kur në "horizont" u shfaq profesori Schmid, i cili nga pozicioni i një historiani të huaj, me veprën e tij mbi Skënderbeun shkaktoi një polemikë të fuqishme e cila po vazhdon përsëri të diskutohet.

Gjatë këtyre zhvillimeve midis deklaratave dhe konstatimeve të shumta, (nuk mbaj mend mirë se deklarata ishte e Zotit Schmid, apo e dikujt tjetër), fiksova thënien se: "njerëzit që kanë shkruajtur historinë e Shqipërisë në periudhën e monizmit janë po ata, që po merren me trajtimin e saj dhe sot. Ky fakt më bëri përshtypje të thellë dhe ndjeva se vërejtja ishte e drejtë dhe menjëherë artikulovala shprehjen se duhet të rishkruhet historia, sepse ajo ka qenë e ndikuar drejtpërdrejtë nga politika dhe është trajtuar me metodologjinë marksiste, por të metodës Shqiptare dhe ka qenë e trajtuar në mënyrë të njëanshme.

Pikërisht si një nga njerëzit, që në këto vitet e fundit kam qenë nga më aktivët në shtypin e përditshëm, për pasqyrimin e figurës së Skënderbeut, mendoj se rishkrimi i historisë duhet të fillojë nga periudha e jetës së Heroit e kështu me radhë të pasohet edhe për periudhat e tjera.

Mendoj se çmitizimi i figurës së tij nuk ka përse ti trembë shqiptarët. Për jetën dhe bëmat e Skënderbeut kanë shkruar bashkëkohësit, të cilët për kohën ishin njerëzit më të ditur, përfaqësues të denjë të humanizmit evropian. Ndërkohë që edhe vepra të tilla, si ajo e profesorit të nderuar Schmid, nuk kanë përse të shkaktojnë aq polemika të ashpra dhe panik. Mjafton të lexohet bibliografia në fund të tekstit dhe të shihet burimi i dokumentave, kur dihet që: të gjithë subjektet, individët dhe strukturat politike të shekullit të XV, që kanë pasur kundërshtar Skënderbeun në çdo moment kanë mbajtur qëndrim fyes ndaj tij. Mjafton të shohësh dokumentat Venedikase dhe Osmane, që të kuptosh se çfarë përcaktimesh autentike kanë shkruar kronistët turq dhe zyrtarët venedikas ndaj Skënderbeut.

2.

Pikë së pari Skënderbeu është dhe mbetet i madh dhe ideja ime është se rishkrimi duhet bërë duke sqaruar, theksuar dhe trajtuar fakte e ngjarje që qëllimisht ose jo, janë anashkaluar. Probleme të tilla që mendoj se duhet të ndalemi janë origjina e Kastriotëve, Dasma e Skënderbeut, Familja e



Arianitëve, Dukagjinët, Kastriotët e Italisë, etj. Ndërkohë një nga problemet kryesore që duhet të sqarohet historografia jonë është origjina e Kastriotëve. Akoma vazhdohej të thuhet se Kastriotët ishin ga Dibra, pavarësisht se Barleti vlerësohet si biografi më i madh i heroit, ai fyhet nga përfaqësuesit më në zë të historografisë shqiptare. Barleti thotë se: "Kastriotët ishin nga një derë fisnike në Mat", ndërsa historianët tanë të nderuar që deri vite më parë citonin Barletin, e ndryshuan faktin duke i vendosur Kastriotët në Dibër. Përse?! Një veprim i tillë a nuk ishte ky një rishkrim i detyruar. Ndoshta gaboj në aludimin e mëposhtëm, por them se: Mos vallë regjimit të kohës nuk i interesonte që Kastriotët të ishin nga Mati i Ahmet Zogut?

Kështu Skënderbeu na dilte me biografi "të keqe". Ndërkohë në media është publikuar porosia që shoku Enver i kishte dhënë drejtorit të atëhershëm të Institutit të Historisë, që: "Gabimet duhet ti ndreqësh me punë". Dhe ai u përpoq që "sjelljen ta rregullonte", duke i nxjerrë Kastriotët nga Dibra, ku shoku Enver ishte dhëndër. Për këtë, atij i erdhi në ndihmë Gjon Muzaka. E kush do ta hetonte Muzakën, që në vitin 1510 kur shkroi memorjen e tij, e dinte se nga ishin Kastriotët?

Patjetër që e dinte, sepse ai ishte martuar me një nga motrat e Skënderbeut, por atij i interesonte tjetër gjë, siç ishte fakti që: familja e tij të dilte si familja më e fisme dhe më e vjetër e Shqipërisë, biles me origjinë nga Perandorët Romakë. Që dëshmitë e Muzakës janë të dyshimta dhe të qëllimshme kjo gjë dihet dhe ka filluar edhe të pohohet tashmë. Duke lënë mënjanë Muzakën ne mendojmë se ka ardhur koha të themi se: Kastriotët nuk janë nga Dibra apo Hasi, por janë nga Mati. Arsyet që më shtyjnë të pohoj këtë gjë janë disa.

Së pari, në Shqipëri ka shumë toponime mesjetare që lidhen me emrat e familjeve të mëdha si: Dukagjin, Aranitas, Blinisht, Skënderbegas, Kastriot etj, të cilët nuk tregojnë origjinat e këtyre familjeve, por

zotërimet e tyre. Kjo ndodh edhe me fshatin Kastriot të Dibrës, të cilin as Barleti dhe as Muzaka nuk e përmendin si zotërim të Kastriotëve. Përsa i përket toponimisë së pasur të Dibrës që lidhet me familjen e Kastriotëve mund të themi se ekzistojnë shumë dëshmi që lidhen me veprimtarinë e tyre në këtë zonë. Kjo gjë nuk mohohet, por ndërkohë dua të shtoj se edhe në Vlorë, në rrëzë të Kaninës, buzë malit të Shashicës ka toponime të tilla si: Ara e Skënderbeut, Vau i Skënderbeut, ose Rrapi i Skënderbeut. Ndërkohë që ky fakt nuk do të thotë se Skënderbeu ishte nga Vlora. Edhe dëshmia e Rafael Valaterranos që Gjon Kastriotin e quan Dibrani nuk qëndron. Atë e rrëzojnë dokumentat Venedikase, Raguziane dhe Turke, të cilat heshtin në këtë pikë. Po kështu edhe Gjon Muzaka i cili thotë që Pal Kastrioti zotëronte dy fshatra në Dibër, por po aty nuk thotë që Kastriotët ishin nga Dibra, Gardhi i Poshtëm, Sinja, Kastrioti apo Çidhna. Gjithashtu në Shqipëri ekziston me fanatizëm zakoni që, në gjallje shumë njerëz e lënë amanet që të varrosen në vendlindje. Si ka mundësi që asnjë nga Kastriotët nuk është varrosur në Dibër?! Kështu thuhet se Vojsava, e ëma e Skënderbeut është varrosur në kishën e Shtjefnit në Mat, Mamica në Petrelë ose Rodon, Gjoni nuk dihet se ku, kurse Gjergji u varros në Lezhë. Në metodën e studimit historik thuhet se, për të shkruar historinë mbështetemi tek dy burime kryesore siç janë burimet e shkruara dhe burimet e tërthorta, që mund të jenë gojore, etnografike, arkeologjike, gjuhësore, antropologjike etj. Megjithatë vendin kryesor e zënë burimet e shkruara ku në rastin e Skënderbeut kemi përveç Barletit dhe dëshmitë e Dhimitër Frëngut dhe Andrea Engjëllit. Ato dëshmojnë drejtpërdrejtë origjinën e Kastriotëve nga Mati. Tek Historia e Skënderbeut e Barletit autori në parathënie thotë: *“Unë nuk kam shkruar trillime por ato që më kanë treguar me kujdes të medhenjtë dhe ato që kanë parë me sytë e tyre, disa që kanë marrë pjesë në luftë”*. Pra vepra është shkruar nga tregimet e marra nga njerëzit e kohës. Sqarojmë të nderuar lexues se Barleti lindi në Shkodër në vitin 1460, tetë vjet përpara se të vdiste Skënderbeu, kurse në vitin 1479 në moshën 19 vjeçare ai mori pjesë në mbrojtjen e Shkodrës, e cila ishte rrethuar nga Turqit. Ndërsa si intelektual ai u formua dhe kulturua në Venecia. Në moshën 50 vjeçare, kur ishte në kulmin e pjekurisë intelektuale Barleti botoi në vitet 1508-1510 Historinë e Skënderbeut në Romë. E cilësuar nga studjuesit e mirëfilltë si vepër historike, Historia e Skënderbeut i kushtohet nipit të Skënderbeut Don Ferrantes, i cili nuk mund ta lejonte ndonjë lajthitje të Barletit lidhur me origjinën e familjes së tij. Mos vallë ai nuk e dinte se nga ishte gjyshi?, Skënderbeu dhe familja e tij?! Një tjetër dëshmi, që nuk duhet anashkaluar është përkrenarja e Skënderbeut e cila ruhet së bashku me shpatën e tij në KUNSTHISTORISHE MUZEUM në Vjenë, në sallën XXV e quajtur e Maksimilianit. Përkrenarja prej çeliku përbëhet nga një rrip i larë me ar në të cilin është gdhendur mbishkrimi (IM*PE*RA*TO*RE*BT) që dëshifrohet: Jezusi i

Nazaretit, bekon Skënderbeun, Princin e Matit, Mbretin e Shqipërisë, Tmerrin e Osmanëve, Mbretin e Epirit. Thuhet se Përkrenarja ju dhurua Skënderbeut nga Papa Piu II, kurse rripi me mbishkrimin e tij iu shtua nga pasardhësit e familjes Kastrioti që lindën pas emigrimit të kësaj familjeje në Itali, pas vitit 1468. Është e natyrshme se kushdo që porosi mbishkrimin, qoftë Papa ose pasardhësit e heroi, të dyja palët e njihnin mirë origjinën e Skënderbeut dhe u kujdesën që aty të shënonin edhe titullin e parë të tij: Princ i Matit dhe pastaj Mbret i Shqipërisë, apo i Epirit.

Pra edhe ky fakt nuk mund të mohohet dhe anashkalohet sepse edhe ai është një tjetër tregues që Kastriotët ishin nga Mati.

Ndërkohë që të tjera argumenta tonat që historia të rishkruhet saktë janë edhe këto: Së pari familja e Kastriotëve ishte shumë e madhe dhe pronat e mëdha të Gjonit nga Drini në Shkumbin dhe Prizreni e Pollogu në Lindje deri në Adriatik në Perëndim, administroheshin nga kushërinjtë e tij. Këta Kastriotë të vendosur në Has, Dibër, Mat, Prizren, Mirditë, Krujë apo gjetkë kanë qenë shpesh referimet e kronistëve të huaj që i kanë ngatërruar ata rreth origjinës së Kastriotëve, siç është edhe rasti i Lukarit.

Ndërsa në Shtjefën të Matit është edhe sot një fis me emrin Kastriot të cilët e mbajnë veten të një gjaku me Skënderbeun, fakti i rrallë që nuk gjendet as në Dibër, Has, Mirditë apo gjetkë. Një tjetër autor që përmendëm më sipër është edhe Dhimitër Frëngu lindur në 1443 dhe vdekur në vitin 1525 në Trevi të Italisë. Dhimitër Frëngu ishte arkëtar dhe bashkëluftëtar i Skënderbeut dhe rridhte nga familja e Engjëllorëve të Drishtit. Në vitin 1539 botohet në Venedik në gjuhën latine vepra e tij komentar i punëve të Turqve dhe zotit Skënderbe, Princ i Epirit. Përkthyes i veprës ishte Pali, i biri i Pjetër Engjëllit, i cili mbante emrin e të ungjit, Pal Engjëllit, ambasadorit dhe bashkëpunëtorit të Skënderbeut. Në këtë vepër theksohet se Kastriotët ishin nga Mati. Kështu pohon autori Dhimitër Frangu dhe përkthyesi Pal Pjetër Engjëlli. Duke iu referuar këtij fakti ngamë pyetjen: A mos edhe këta zotërinj që i kanë shërbyer Skënderbeut, nuk e dinin se nga ishte ai? A mos ndoshta edhe nipi tjetër i Dhimitër Frangut, Andrea Engjëlli gënjen, kur boton në vitin 1555 në Romë veprën “Gjenealogjia e Perandorisë Romake dhe Kostandinopolite”, sepse në faqen 490 thotë se Kastriotët ishin nga Mati.

3.

Deri në vitin 1974 mendimet e historinëve për origjinën e Kastriotëve ndaheshin më dysh. Një pjesë argumentonin se Kastriotët ishin nga Mati, ndërsa pjesa tjetër mendonin se ata ishin nga Hasi. Të dy kampet argumentonin tezat e tyre duke sjellë në mënyrë të pavarur fakte të ndryshme.

Kujtojmë se tezat e mësipërme të origjinës dibrane dhe Hasjane të Kastriotëve janë përfaqësuar në këto 35 vjet nga emra autoritarë në fushën e historografisë Shqiptare të cilët kanë qenë edhe drejtues



PJESË NGA KRONIKA E GJON MUZAKËS

KRONIKË E SHKURTËR MBI DINASTINË TONË TË MUZAKËS

Gjon Muzaka

Unë, princ Gjon Muzaka, despot i Epirit, pasi jam përzënë nga trojet e mia nga sulltani dhe pasi jam privuar nga vendi im, mbërrita në mbretërinë e Napolit, ku mbreti Ferdinand i Aragonës, duke u kujdesur për nevojat e mia bazë dhe ato të familjes sime, premtoi të më ndihmojë duke më dhënë tokë në Aspice, gjithashtu dhe gjëra të tjera. Mbreti na pranoi në oborrin e tij. Ishte fati im i keq që mbreti u rrëzua dhe luftëra të papritura filluan. Unë mbeta si një anije në mes të stuhisë duke mos ditur dhe italishten. Por siç e desh i madhi zot, unë isha i aftë t'ju rrisja ju, t'ju ushqeja, ju fëmijët e mi, princ Teodor, princ Adrian, princ Konstandin dhe dy motrat tuaja: princeshë Helena dhe Porfida. Ndonëse me mjaft vështirësi, kur unë erdha në këtë vend, ti princ

Teodor ishe një vjeç e gjysmë, ti princ Adrian ishe një muajsh e gjysmë, ndërsa ti princ Konstandin u lindi këtu, në këtë mbretëri.

Unë dua t'ju mësoj për shkatërrimin e perandorisë së bizantit, që solli dhe shkatërrimin tonë. Kjo rënie filloi nga një grindje mes Palaeologus dhe Kontakuzenit. Kjo grindje e çoi Palaeologus të kërkojë ndihmë nga Murati I, mbreti i turqve. Ai më vonë vuri këmbën e tij në Europë më 1363.

Duke kaluar në gjithë këto vende, ai pushtoi shumë tokë, mes së cilës ishte dhe qyteti Adrianopoli (Edirne). Kur Murati II hypi në fron, ai mori Serbinë dhe Bullgarinë me një masakër të madhe. Lazari, despoti i Serbisë, mbreti Marko i Bullgarisë dhe Teodor ➡

↩ të institucioneve shkencore. Prandaj tezave të tyre u është dhënë më tepër prioritet në dëm të tezës sonë se Kastriotët ishin nga Mati. Kjo shihet tek tekstet e historisë së Shqipërisë.

Ndërkohë që botimet e tjera e mohojnë këto aludime. Shembulli më tipik është historiku i kishës ortodokse autoqefale të Shqipërisë i autorit Andrea Llukani, botimi i vitit 2005, ku midis shumë fakteve për familjen e Kastriotëve, në faqen 38, theksohet se Mati është vendi i origjinës së Kastriotëve. Ky historian i pa ndikuar nga asnjë prej tezave të mësipërme, pasi u njoh me burimet historike nuk hezitoi që të orientohej drejt duke gjykuar me arsye dhe profesionalizëm. Kështu kanë vepruar edhe një sërë intelektualësh dhe historianësh të cilët dinë të vlerësojnë dhe kanë vullnetin të gjykojnë pa subjektivizma historinë tonë kombëtare. Kjo u pa edhe tek botimi i autorëve të sotëm katolike si Marin Sirdoni dhe Frano Ilia, të cilët në studimet e tyre të mirëfillta nuk theksuan se Kastriotët janë dibranë. Pikërisht në emër të parimeve shkencore dhe të gjykimit intelektual ka ardhur koha që të kërkojmë që të mos fyhet më Barleti, si i pari biograf i heroit. Të botohen veprat e Dhimitër Frëngut dhe Andrea Engjëllit që janë dëshmi të drejtpërdrejta krahas Barletit për origjinën e Kastriotëve.


Të merret parasysh argumenti i Thallocit i cili duke çmuar dokumentin Raguzian të vitit 1368 të nënshkruar në Kalanë e Kaninës, dhe që i përmend për herë të parë Kastriotët thotë se: Kastriot do të thotë qytetar. Pra Kastriotët ishin qytetarë. Por, nga cili qytet? A ka

patur qytete Hasi apo Dibra nga të cilat pretendohet se ishin Kastriotët? Gj. Muzaka nuk thotë se ata ishin nga vetë qyteti i Dibrës. Ndërsa Mati ka patur dy qytete në periudhën që po flasim, Petralba (Guri i bardhe) dhe Stelushi.

Pikërisht këto dëshmi duhet të merren në konsideratë nga institucionet tona kompetente, të cilat duhet të dalin jashtë rutinës së punës së tyre. Duke kapërcyer marrëdhëniet, raportet dhe qejfmbetjet midis kolegëve, individët që janë pjesë përbërëse e tyre duhet të dëshmojnë tashmë të vërtetën, duke mos e mbajtur më peng të tyre historinë e Shqipërisë.

Historia nuk mund të shkruhet vetëm në Tiranë. Ajo nuk është eskluzivitet i disa individëve të caktuar, të cilët dashje pa dashje kanë qenë të detyruar të ndërtojnë teza të paracaktuara nga të tjerët. Të tillë "personalitete" u panë në imazhet televizive, kur u prezantua libri i profesorit Schmid, ku si pjesëmarrës në auditor nuk dinin se si të reagonin, duke mbetur rob të tezave të së kaluarës.

Për këtë qëllim po kujtoj, Lukianin dijetarin e shquar të antikitetit që jetoi në shekullin e dytë. Qysh përpara 1800 vjetësh ai formuloi panfletin e titulluar. Si duhet shkruar historia ku në pasazhin e fundit thotë: "Historia shkruhet me pasion për të vërtetën, duke pasur parasysh atë që mund të pritët nga e ardhmja, dhe jo me lajka, për tu bërë qejfin bashkëkohësve. Ja këto janë për ju rregulla dhe metri i një veprë historike të vërtetë".



← Muzaka II, i familjes sonë dhe princat e tjerë të Shqipërisë u bashkuan dhe nisën një betejë të cilën kristianët e humbën. Në këtë betejë, u vra i sipërpërmenduri, Teodori, që pati një grup të madh shqiptarësh. Lazari i Serbisë u burgos, pastaj u vra. Filloi një periudhë me luftra të vazhdueshme me turqit në të cilat shumë princër dhe zotërinj dhanë jetët e tyre. Siç u përmend më sipër, ishte një mungesë kurajoje mes tyre që i çoi ato në humbje. Qyteti i Croya (Krujës), ra gjatë sundimit të Bajazidit I, siç ra më vonë dhe Velona (Vlora), megjithëse ne u përpoqëm të mbrojmë pa ndërprerje. Megjithatë fuqia e sulltanit po rritej, ndërsa fuqia jonë po binte...

Të gjithë pricat e rinj shqiptarë vdiqën në betejë. Mbetën gjallë vetëm: princ Arianit Komnenus, princ Gojko Balsha, princët Nikollë dhe Pal Dukagjini, babai im Gjin Muzaka, princ Andrea Topia dhe princ Peter Spani. Të gjithë jetuan dhe sunduan gjatë. Ata patën fëmijë, por pak në numër, se ishin të lodhur nëpër luftra. Megjithatë ata mbrojtën tokën e tyre sa mundën, ndonëse humbën shumë nga territoret e tyre.

Më vonë, gjatë sundimit të Muratit të dytë, hyri në skenë Skënderbeu, djali i princit Gjon Kastrioti, që sundonte mbi Matia (Matin) e Shqipërisë. Gjoni dha atë dhe dy vëllezërit e tij, peng te sulltani, kur ata ishin të vegjël. Dy të tjerët vdiqën. Kur u kthye turk, i ashtuquajtur Gjergj Kastrioti, u bë i njohur si Skënderbeu, që nënkuptonte: beu Aleksandër, i cili ishte një sundues...

Skënderbeu i mblodhi sunduesit e Shqipërisë në Alessio (Lezhë). Disa princër erdhën vetë, disa çuan përfaqësues. Kështu, i ashtuquajtur Skënderbë, u bë

krye-komandant në Shqipëri dhe çdo princ dha njerëzit e vet ose para, sipas mundësive. Djem të tjerë të këtyre dyerve fisnike shërbyen nën komandën e tij, duke marrë pjesë në luftë dhe duke mbrojtur vendin e tyre nën komandën e Skënderbeut.

Princi Skënderbë ishte i shkathët dhe trim në luftë dhe u bë kryepinc i princave dhe të gjithë iu bindën atij.

Skënderbeu u martua me të bijën e princit Arianit Komneni dhe ky princ çoi babain tim si ndërmjetës, sepse princ Arianiti ishte kunat i babait tim. Gruaja e Skënderbeut Andronica Komneniata ishte kushërira ime. Skënderbeu ishte shumë i zgjuar dhe kishte prirje për të bërë mirë dhe ishte më i madhi nga të gjithë paraardhësit...

Princi Gjon Kastrioti, babai i Skënderbeut, sundoi atë krahinë të Shqipërisë që quhej Mat. Më vonë, princi Skënderbë u bë jo vetëm princi i Matit, por edhe i Krujës, Dibrës, Birinës, Randisisë, Tomoristës, Misias dhe Gjonëmit, deri në det...

Pasi mori Matin, principatën e të atit, ai mori edhe Krujën, që i ati nuk e pati dhe u bë kryekomandant i princave të Shqipërisë. Pas një kohe të shkurtër ai synoi sundimin e krejt vendit. Ai kapi princin Gjon dhe Gojko Balsha, që ishin vëllezër dhe i çoi te mbreti Ferdinand i Napolit, ku i mbajti në burg dhe Skënderbeu mori zotërimin e principatës së tyre, që shtrihej mes Krujës dhe Lezhës, që quhej toka e Misjes. Ai mori, gjithashtu dhe principatën e princit Moisi Komnenus (Golemi), që ishte larg nga principata e tij, në Dibër. Moisiu ishte njeri i mirë me forcë e guxim. Por meqë ai nuk ishte i aftë ta duronte një akt të tillë dhune, që u bë kundra tij, duke i marrë principatën e Dibrës, ai iku te sulltani. Sulltani e bëri Moisiun komandant të njërës nga ushtritë e tij dhe e çoi në luftë kundra Skënderbeut. Por më vonë Skënderbeu i çoi një lajm që i lutej të kthehej në atdhe e që do ta trajtonte si një vëlla. Moisiu u kthye duke e kuptuar se nuk ishte i sigurtë me sulltanin dhe se nuk duhej humbur më gjak kristian. Kur babi im vdiq, Skënderbeu mori gjithashtu Tomonishtën, larg nga ne, në Myzeqenë e Poshtme. Ai bëri të njëjtën gjë me princat e tjerë duke marrë tokat e Commit (Koman) dhe Randisisë...

Ju duhet ta dini se gjyshe i princit Skënderbë quhej Pal Kastrioti. Ai sundoi veç në dy fshatra të quajtura Signa (Sinja) dhe Gardi (Gardhi) i Poshtëm. Nga princi Pal lindi princi Gjon Kastrioti, që u bë princi i Matit dhe nga princi Gjon u lind princi Skënderbë. Nëna e princit Skënderbë ishte princesha Voisava Tribalda, që ishte nga një familje fisnike...

Përktheu nga anglishtja,
Sokol CENAJ

NGA HISTORIKU I NDËRTIMIT TË RRUGËVE AUTOMOBILISTIKE

Ramiz FIÇORI

Rruga e parë në Shqipëri konsiderohet e hapur për qerre nga qeveria turke në linjën Manastir-Korçë-Janinë, filluar më 1892 dhe ndërtuar me punë angari nga banorët lokalë ku kalonte rruga. Çdo fshat, sipas sasisë së banorëve, ishte i detyruar të ndërtonte pjesën e caktuar. Nga fundi i shekullit XIX u projektua hapja e rrugës tjetër Berat-Këlcyrë-Përmet-Janinë. Një pjesë e asaj rruge, ura e Beratit, u hap që në atë kohë, ndërsa pjesën Berat-Këlcyrë e morën në sipërmarrje bejlerët e Këlcyrës, të cilët përvetsuan fondet dhe nuk e hapën kurrë. Në 1885 u morën masa për të filluar rrugën Durrës-Tiranë, më 1888 rrugën Shëngjin-Shkodër si dhe Sarandë-Delvinë-Jergucat, me qëllim për në Janinë, por këto segmente nuk arritën të përfundojnë.

Në vitin 1900 në qeverinë turke u ngrit problemi për të ndërtuar një rrugë kryesore, e cila të lidhte Stambollin me viset perëndimore të Perandorisë. Fjala është për rrugën Egnatia. Më 1902, për ndërtimin e kësaj rruge nga Manastiri e Elbasani, puna filloi në dy drejtime. Në fazën e parë u krye një pjesë, Manastir-Ohër dhe nga drejtimi tjetër Elbasan-Fushë Bual-Polis. Pas vitit 1908, nga një kompani ushtarësh turq, u ndërtua një segment prej Qukësit në Hotolisht. Popullit iu vunë taksa për të siguruar fonde, por rruga nuk u përfundua kurrë. Kështu, viti i pavarësisë, 1912-ta, e gjeti Shqipërinë vetëm me 160 km rrugë për qerre. Gjatë viteve 1913-1914 nuk u punua fare në ndërtimin e rrugëve në Shqipëri, përveç riparimit dhe vënies në efikasitet të rrugës Durrës-Tiranë, e cila funksiononte vetëm për qerre. Pra, siç shihet, Shqipëria ishte gati pa rrugë. Në fillim të luftës së parë botërore 1914-1918 në vendin tonë erdhën ushtri të huaja: greke, italiane, franceze, serbe, austro-hungareze, bullgare dhe e kthyen vendin në shesh lufte. Makina ushtarake e tyre nuk bënte dot pa rrugë transporti, natyrisht për nevojat e tyre. Kështu, iu vunë punës për ndërtimin e rrugëve për automjete, ndërtim dekovilash e teleferikësh, sipas zonave ku shtriheshin ushtritë e secilit pushtues.

* * *

Ushtria austro-hungareze, që në ditët e para të pushtimit të Shqipërisë Veriore, krijoi një aparat të madh të udhëheqjes teknike me oficerë xhenerierë. Caktoi forca për ndërtimin e rrugëve, duke përdorur ushtarë, robër, të dënuar dhe punëtorë vendas me pagesë. U ndërtua e re rruga Shkodër-Vorë, u përshtat për lëvizje automjeteve rruga e qerreve Durrës-Tiranë dhe Durrës-Kavajë, si dhe rruga Kavajë-Tërbuf-Lushnjë. Paralel me këto rrugë ushtarët austriakë ndërtuan rrugën Lushnje-Berat si dhe rrugët Shkodër-Shirokë e Shkodër-Hani i Hotit. Për t'i bërë ballë

nevojave të tyre për furnizim ushtria austro-hungareze ndërtoi një rrjet dekovili (*hekurudha me binarë të ngushtë 0.65 m*). Vagonët e tyre tërhiqeshin nga lokomotiva, të cilat punonin me avull ose benzinë. Ky rrjet dekovili fillonte në Shkodër dhe shkonte në Lezhë e Shëngjin, ku ushtria shfrytëzoi portin. Nga Lezha



vazhdonte deri në Vorë, nga ku ndahej një degë për në Tiranë, ndërsa dega tjetër vazhdonte linjën Durrës-Kavajë-Rogozhinë. Nga Rogozhina, një degë vazhdonte për gjatë bregut të lumit Shkumbin, në Peqin-Papër-Elbasan, deri tek ura e Labinotit, ndërsa një krah tjetër, pasi kapërcente Shkumbinin në Rogozhinë me një urë druri e trarë hekuri, vazhdonte për në Lushnje. Pasi arrinte këtu, ndahej në dy drejtime: njëra përmes Myzeqesë kalonte Bishqethëm-Kolonjë-Mbrostar-Fier-Levan deri në Vjosë, ndërsa dega tjetër kalonte në Karbunarë-Barbullinjë-Ura e Kuçit-Ura e Hasan Beut dhe në Berat. Ishte ndërtuar si e veçuar dhe një vijë nga Shtërmenci i Elbasanit deri në Frashër të Sulovës. Me qëllim për të bërë furnizim më të shpejtë të trupave, gjatë kohës që ndërttoheshin rrugët, austriakët, disa javë pas pushtimit, në fillim të dhjetorit 1916, ndërtuan teleferikun Shëngjin-Lezhë-Vorë, rreth 40 km i gjatë dhe menjëherë filluan transportin e municioneve dhe ushqimeve, madje dhe të trupave. Ushtria austro-hungareze ndërtoi gjithësej 650 km rrugë e 450 km rrugë dekovili. Por më 1918, gjatë tërheqjes së trupave, shkatërruan shumë ura, që i patën ndërtuar më parë. Linjën e dekovilit e shkatërruan fshatarët, duke i marrë shinat dhe traversat gjatë viteve 1919-1922, aq sa në 1925 nuk dukej më "*as nam, as nishan*". Dekovili i ndërtuar në atë kohë që në fakt një vepër e madhe, që mund të shfrytëzohej për ndërtimin e hekurudhës Vlorë-Durrës-Shkodër. Prishja e vijës së dekovilit që një absurd, një çudi e rrallë, që u përsërit në ditët tona me shkatërimin e hekurudhës Shkodër-Hani i Hotit dhe Milot-Rrëshen-Klos, të cilat ishin të përfunduara, më përjashtim të aksit Rrëshen-Klos, që ishte ndërtuar deri në 75 %.

* * *

Ushtria italiane, për të mbrojtur frontin gjatë Vjosës, kundër ushtrisë austro-hungareze, ndërtoi rrugën Vlorë-Tepelenë-Gjirokastrë. Vetë traseja e kësaj rruge tregon qëllimin strategjik e ushtarak të saj, e cila nuk u hap për qëllime ekonomike. Në vend që rruga të

kalonte luginave, ajo shtrihej nëpër male e pjerrësi malore, me kthesa të shumta e të rrezikshme, si ato të Salarisë, Matohasanaj etj. Kjo ishte një vijë për transportin e topave dhe mjeteve ushtarake, larg frontit armik, nëpër vende dominuese. Rrugë të tjera janë: Vlorë-Llogara-Himarë-Sarandë, me gjatësi 135 km, Vlorë-Mifol si dhe Sarandë-Delvinë-Gjirokastrë. Ushtria italiane riparoj rrugën ekzistuese Tepelenë-Këlcyrë-Berat. Përveç rrugëve, italianët ndërtuan dhe një rrjet dekovili 120 km, i cili fillonte nga Vlora në Qafë të Koçiut, ku një degë shkonte deri te ura e Penkovës. Këtu një degë shkonte përroit të Vllahinës, deri në Gërrec, kurse tjetra vazhdonte anës së djathtë të Shushicës, deri në Mavrovë. U ndërtuan dhe degë të tjera më të shkurtra, Vlorë-Gorricë-Panaja dhe Topana-Bestrovë-Panaja. Përveç këtyre, ushtria italiane ndërttoi dhe 15 teleferikë të gjatësive të ndryshme, që plotsonin nevojat e komunikacionit dhe të transportit të materialeve ushtarake.

* * *

Ushtria franceze në të njëjtën periudhë ndërttoi rrugët Korçë-Voskopojë, Korçë-Zvezdë, Korçë-Maliq-Pogradec, Korçë-Follorinë dhe Pogradec-Progër. Shumica e volumnit të punimeve u krye gjatë kohës kur administrata vendase në Korçë ishte në dorën e vendasve, pra të kohës së “autonomisë”.

RRUGËT E NDËRTUARA GJATË PERIUdhës SË ZOGUT

Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjes krijoi një drejtori të përgjithëshme për punët botore, e cila në fillim u mor me riparimin e rrugëve dhe urave në ato vende ku nuk funksiononin. Nga fundi i vitit 1920 u dërguan inxhinierë në qendrat e prefektuarve Tiranë, Vlorë, Korçë, Elbasan etj, të cilët hapën zyrat e punëve botore. Qëllimi i tyre ishte mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve e urave ekzistuese. Gjatë vitit 1921 drejtorja u ngrit në rang ministrie. Qeveria e atëhershme, për të përballuar situatën, kërkoi kuadro nga jashtë dhe vendosi sistemin e punës pa pagesë (angari). Çdo shtetas mashkull, nga 18-58 vjeç, ligji e detyronte të bënte 10 ditë punë angari në rrugë e ura. U ndërtuan disa rrugë të reja, Elbasan-Peqin 37 km, Pogradec-Qafë Thanë, u plotësuan dhe u riparuan pjesë të rrugës Elbasan-Qukës-Prrenjas. Me punë angari u riparua rruga Tiranë-Durrës, e cila në vitin 1922 mori formën e një rruge të vërtetë automobilistike.

Siç thamë më lart, në disa krahina ishin hapur rrugë, por, nga mungesa e urave mbi lumenjtë Mat, Drin, Seman e Vjosa, ato qenë të papërdorshme. Për të kapërcyer këtë vështirësi, Ministria e Punëve Botore më 1922 organizoi batalionet e rrugëve, që ishin organizma ushtarake me nga 800 puntorë. Por ato nuk vazhduan gjatë për mungesë fondesh. Gjatë vitit 1923-1924 u bë ndërtimi i pjesëve, që mungonin në rrugën Durrës-Elbasan-Korçë. Në vitin 1925 u çel plotësisht rruga Durrës-Elbasan dhe në gusht 1926, pjesa tjetër Elbasan-Korçë, ku shënuan dhe hapjen e trafikut Tiranë-Durrës-Korçë. Të gjitha punimet u kryen me punë angari dhe pak me sipërmarrës. Po në vitin 1925, me përfundimin e rrugës Rrogozhinë-

Lushnje, ishte rregulluar deri diku dhe trafiku midis Tiranës e Vlorës, Beratit, Gjirokastrës e Sarandës. Gjatë periudhës 1912-1930 rëndësi të madhe kishte transporti me anën e mjeteve detare, të cilat komunikonin nëpërmjet porteve detare Shëngjin-Durrës, Durrës-Vlorë, por dhe në skelat më të vogla: Shirokë, Seman, Himarë e Sarandë, ku transportoheshin njerëz dhe mallra. Me kohë qarqet politiko-ushtarake italiane patën hedhur vështrimin mbi bregun lindor të Adriatikut. Ata vleresonin se, për të depërtuar thellë në Ballkan, kishte dy drejtime: nga ana e Sllovenisë dhe nga Shqipëria. Nga drejtimi i parë, megjithëse kontakti ishte i drejtpërdrejtë tokësor, kundërshtari kishte më tepër favore. “*Kufiri ynë me Jugosllavinë nuk ishte shumë i përshtatshëm për ofensiva dhe për kundërshtarin ishte më i përshtatshëm për mbrojtje. Nga Shqipëria, përkundrazi, ne kishim mundësi të depërtonim më drejt në drejtim të Beogradit e t’i mernim krahët ushtrisë jugosllave. Prej kësaj rritte domosdoshmëria për të pajisur terrenin shqiptar me rrugë, ura, skela, porte, aerodrome etj, për të kaluar trupat tona*”. Kështu pohonte një diplomat i rëndësishëm italian. Sipas kësaj strategjie, qeveria fashiste italiane hartonte plane nga më të ndryshmet për ekspansion në lindje. Kështu, pas trazirave të vitit 1924 në Shqipëri filluan veprimet konkrete për pushtimin e Shqipërisë, për ta përdorur si bazë nisjeje për të sulmuar Greqinë e Jugosllavinë. Më 15 mars 1925, midis qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, nëpërmjet një grupi financiar, krijuar posaçërisht për këtë qëllim, u nënshkrua marrëveshja për t’i dhënë Shqipërisë një hua. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, më 23 prill 1925 u krijua shoqëria SVEA (Società per la Sviluppo Ekonomiko d’Albania - Shoqëria për Zhvillim Ekonomik të Shqipërisë). Huaja u emetua për një shumë nominale 70.5 milion franga ar, nga e cila qeverisë shqiptare do t’i jepeshin 50 milion. Por më 1927, me ndryshimin e kursit të liretës italiane, u bë 65.768 mijë franga ar. Huaja u dha me kushte të rënda, me një interes 7.5% të të gjithë shumës prej 78 milionë e jo të asaj 50 milionë. Qëllimi i kësaj huaje ishte strategjike për Italinë fashiste. Sipas orientimeve të huadhënësve, por dhe të nevojave që kishte Shqipëria, e cila ishte pa rrugë, pa ura, pa porte e skela detare, fondet e huasë u përdorën pikërisht për ndërtimin e këtyre objekteve. Këtu fshiheshin e justifikoheshin qëllimet italiane.

Punimet filluan menjëherë. Megjithëse që folur për të hapur fronte pune për shqiptarët, italianët sollën jo vetëm personel inxhiniero-teknik, por dhe një sasi të madhe punëtorësh, megjithëse në marrëveshje thuhej se 70% e punëtorëve do të ishin shqiptarë.

Të gjithë materialet e ndërtimit si çimento, hekur, dërrasa, trarë e deri te gozhdët, u sollën nga Italia dhe kështu një pjesë e madhe e të hollave të huasë u kthyen përsëri në xhepat e fabrikantëve italianë. Po kështu, kontraktimet e bëra me sipërmarrës italianë, ishin 4 herë më të mëdha se me ata shqiptarë. Psh, në kapitullin “ndërtesa” sipërmarrja italiane



← kishte 8.753 mijë franga ar, kurse sipërmarrsit shqiptarë kishin 1.877 mijë franga ar.

Gjatë viteve 1926-1934 vazhduan punimet me intensitet të lartë, të financuara me huanë e SVEA-s. Në fund të vitit 1935 sipërmarrsit italianë kryen 75% të punimeve, ato shqiptare 21,8% dhe pjesa tjetër u krye nga dy shoqëri gjermane dhe një franceze. Nga viti 1926 deri në 1936, për 10 vjet, u ndërtuan 253.3 km rrugë të reja. Urat kryesore që u ndërtuan janë urat e Bunës, Drinit në Lezhë, Matit në Milot, e Gjoles, Rogozhinës mbi Shkumbin, Paprit, Shkumbinit në Elbasan, Murrashit, Librazhdit, Mbrostarit mbi Seman, Vjosës në Ferras, Kuçit në Berat mbi Seman, e Erzenit në Mullët, Drinit në Topojan, e Drinit në Vaun e Dejës e Gomsiqes, Dragotit mbi Vjosë, Kuksit mbi Drin etj. Kështu, në Shqipëri kishin hyrë në shfrytëzim 2 224 km rrugë dhe 611 km ishin në proces ndërtimi. Gjithësej mbi këto rrugë qenë ndërtuar 4 371 ura të mëdha e të vogla dhe tombina të mëdha me gjatësi 13 km. Nga rrugët më të rëndësishme ishte rruga Shkodër-Pukë-Kukës-Qafë Morinë. Traseja e kësaj rruge deri në Qafë të Malit kalonte nëpër rrugën e vjetër të karvaneve. Rruga tjetër, Milot-Rrëshen-Kulla Pashë(Urakë)-Burrel-Klos-Peshkopi, është bërë sipas një projekti të vjetër dhe i jepej shumë rëndësi, pasi lidhte Dibrën nga lugina e Matit me portin e Shëngjinit. Me punë angari, duke mobilizuar fshatarët, u hap një degëzim i kësaj rruge, nga Sukbulli (Zenisht)-Qafë Murrë-Muhurr-Peshkopi, e cila përfundoi më 1932. Dukej sikur kjo rrugë hapej për të lidhur Burgajetin, vendlindjen e mbretit me Tiranën, por në të vërtetë kishte qëllime strategjike ushtarake. Ajo hapej për një drejtim të ri, për të depërtuar në Maqedoni. Gjithashtu hapej për shfrytëzimin e pasurive natyrore të asaj zone verilindore, sidomos për pyjet e dendura të Mbas-Dejës, Balgjajt, Llapushit etj. Me huanë e SVEA-s është ndërtuar dhe rruga Krujë-Qafë Shtamë-Burrel. Traseja e kësaj rruge kalon nëpër vende malore e shkëmbore dhe ishte shumë e vështirë për tu hapur, sidomos porsa kalon qytetin e Krujës. Rruga është 50 km, prej të cilave 5 km i kishte krejt në shkëmb. Ajo kushtoi 500 000 franga ar. I filloi punimet në 1926 dhe mbaroi më 1930. Rruga u hap me punëtorë shqiptarë, të cilët kur punonin në shkëmb, lidheshin me litarë. Për ndërtimin e kësaj rruge u bë një punë heroike dhe në një kohë të shpejtë në krahasim me sipërmarrjet e tjera. Të huajt, sidomos gazetarët e fotoreporterët, që shkruanin për gazetatat e Europës, kur shihnin punimet dhe vështirësitë e trasesë së kësaj rruge nëpër shkëmb, habiteshin. Kjo rrugë kaq e kushtueshme dhe e vështirë nuk është hapur aspak për qëllime ekonomike. Qëllimi i ndërtimit të kësaj rruge që krejtësisht ushtarake, sepse siguronte lëvizjen e ushtrisë italiane në një drejtim të ri, Durrës-Krujë-Mat-Dibër-Tetovë dhe plotësonte kërkesat strategjike të Italisë për të depërtuar në Ballkan. Siç dihet, kjo rrugë gjatë 60 vjetëve nuk u shfrytëzua, pothuaj fare, mbasi traseja e saj dhe terreni ku kalonte, që shumë i vështirë. Rruga Tiranë-Krrabë-Elbasan është ndërtuar me fondet e huasë SVEA, nga një kompani (shoqëri) gjermane.

Për ndërtimin e saj nuk u morën parasysh projektet e vjetra, as leverdia ekonomike, por vetëm qëllimi dhe kërkesat ushtarake, sidomos për të transportuar artileri në lartësitë e rajoneve të Tiranës, Elbasanit e Durrësit. Traseja e saj kalon nëpër vende të thyera shkëmbore e të rrezikëshme. Megjithatë ajo vazhdon të shfrytëzohet që kur u hap e deri më sot, plot 75 vjet, si rruga kryesore Tiranë-Elbasan-Korçë. Rruga përfundoi në vitin 1933 me një ceremoni në Elbasan. Qeveritë shqiptare, megjithëse ndër vite e kanë pasur projekt-ide për ta kaluar këtë rrugë nga fshati Krrabë nëpër luginën e Mamlit, në Elbasan, shumë shkurt nëpër qendrat të banuara dhe fushave, asnjëherë nuk i hynë punës, qoftë dhe për të kursyer shumë jetë njerëzish, që kanë marrë aksidentet në këtë rrugë. Rruga nga Lushnja deri në Mbrostar duhej të rindërtohej e gjitha, mbasi kalonte nëpër vende moçalore dhe që prishur. Ajo kalonte nëpër vijën që dikur kalonte dekovoli, i ndërtuar nga ushtria austriake. E gjithë traseja e rrugës formohej me mbushje dheu, e cila ekziston dhe sot. Mbushjet, nga ku kalonte dekovoli, u zgjeruan dhe lartësuan duke u përshtatur për rrugë me dy kalime. E gjithë rruga deri në Mbrostar u mbush dhe u shtrua me kalldrëm me gurë të marrë në Karbunarë të Lushnjës. Një drejtim tjetër rrugor që Librazhd-Ostren-Peshkopi, ku në gusht 1930 përfundoi hapja deri në Lunik. Vështirësi pati në shkëmbin e Lunikut, por e gjithë rruga përfundoi deri në Shupenzë, në fillim të vitit 1931. Edhe kjo rrugë në tërë trasenë, që kalonte nëpër fshatrat e Gollobordës, u hap me punë angari, ndërsa një pjesë e vështirë shkëmbore me fonde të shtetit. Të gjitha punimet në Shqipëri ndiqeshin drejtpërdrejt nga qeveria italiane, e cila kishte caktuar tre lloj kontrollorësh për një zbatim të përpiktë të fondeve me fashistin Gambino dhe përfaqësuesi i SVEA-s ing. Sotili, një tjetër me një kolonel xhenier, i cili ishte bazuar në Ministrinë Botore në Tiranë dhe një ekip në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Itali. Mbi këta qëndronte dhe vigjilonte gjeneral Pariani, përfaqësues personal i Musolinit në Shqipëri. Të gjitha rrugët që u ndërtuan në Shqipëri nuk iu nënshtuan një studimi e projektimi strategjik për zhvillimin e ekonomisë shqiptare, por për qëllime strategjike ushtarake të qeverisë fashiste italiane, për të ndërhyrë në Ballkan si dhe për të shfrytëzuar pasuritë, siç ishin pyjet, minierat e serës, kromit, bakrit etj. Me privilegjet që krijonte huaja SVEA, kapitali monopolist italian i diktoi qeverisë së Zogut programin e përdorimit të kësaj huaje sipas interesave të saj dhe në të njëjtën kohë, mori në sipërmarrje shumicën e ndërmarrjeve, që filluan të zbatoheshin në kuadrin e kësaj huaje. Për këtë qëllim u vendosën në Shqipëri kompani e shoqëri italiane të ndërtimit, siç ishin “A. M. Ragaci”, “M. Sako e F”, “Ansoldo”, “Makarana e K”, “Venanceti V”, “Mario Roko” etj.² (Un descnnio di vita della SVEA ... f. 55-63 këtu Gj. Ek. E Shqipërisë .. f 85) Qarqet e Romës e përdorën huan e SVEA-s si mjet të fuqishëm presioni jo vetëm për ekspansionin e gjerë ekonomik, por dhe për ta lidhur politikisht qeverinë shqiptare pas Italisë fashiste. Megjithatë nuk mund të themi se rrugët

nuk sollën zhvillim. Ato i shërbyen Shqipërisë për më vonë. Por, një strategji e mirëmenduar ekonomike, nuk do të kishte sjellë vështirësi e harxhime të tepërta e të pa nevojshme, pasi këto rrugë i trashëgojmë dhe sot e kësaj dite e shumë pak po rigjenerohen, apo po zevendësohen me rrugë më të përshtatëshme, më të shkurtra, më të pa rrezikëshme dhe më të dobishme për ekonominë.

NDËRTIMI I RRUGËVE PAS ÇLIRIMIT

Menjëherë pas çlirimit të vendit filluan dhe punimet për hapjen e rrugëve të reja dhe riparimin e atyre të dëmtuara. Kështu, u hap me buxhetin e shtetit e pjesërisht me vullnetarë rruga Kukës-Peshkopi, ndërsa nga ushtria u hap rruga e Malsisë së Madhe. Në fillim për nevoja e ndërtimit të hidrocentralit të Ulzës u hap rruga Milot-Shkopet-Ulëz-Burel dhe me krijimin e liqenit u ndërpre rruga Rrëshen-Kulla Pashë-Shoshaj, pasi u përmyt ura mbi Urakë dhe nuk u vu më në punë. Kështu, u vu në shfrytëzim rruga Burrel-Ulëz-Shkopet-Milot, shumë e rrezikshme dhe krejt e pa përshtatëshme për të lëvizur njerëzit. Shteti ynë që nga viti 1956 nuk e rihapi rrugën e vjetër, ndonëse nuk kërkonte harxhime të mëdha. “Udhëheqësit” e atëhershëm thonin se “*rrugën e kemi, ç’na duhen dy rrugë*”. Por rruga e Shkopetit vetëm riparime, ndërtime, mure mbajtëse anësorë, deri tani ka harxhuar sa të ndërtohen 10 ura, pa llogaritur dëmin ekonomik që iu është bërë fshatrave, të cilët lidheshin me Rrëshenin e Burrelin, sidomos zonën e Prellit,

Kthellës, Lurës etj. Vitet e shkuara një ndihmesë të madhe për ndërtimin e rrugëve ka dhënë ushtria me trupat e saj të xhenios, por dhe me ato të këmbësorisë. Kështu, janë ndërtuar, në fillim rruga Gramsh-Lozhan më 1949, Kakrukë-Skarpar-Malind-Frashër-Përmet, Korçë-Mali i Kuq-Qafë Kazan-Ersekë, rruga Hani i Hotit-Vermosh, rruga Berat-Shpirag-Mallakastër. Po kështu u bënë riparime e zgjerime në shumë rrugë si në Llogara, në rrugën Vlorë-Tepelenë etj. Me forcat e ushtrisë janë hapur dhe rruga Rrëshen-Fush Arrës dhe Vau i Dejës-Koman etj. Shumë rrugë janë hapur për lidhjen e fshatrave, por shumë herë ka shkuar munda e djersa kot, pasi janë bërë pa zbatuar rregullat teknike dhe kanë dalë jashtë përdorimit, janë bërë rrugë vjetër për verë dhe jo të përherëshme. Këto kanë sjellë dëme dhe aksidente, duke marrë dhe jetë njerëzish. Shumë rrugë në Shqipëri, sidomos në fshatra e qendra të banuara, nuk janë miratuar për të lëvizur automjete, se kanë pasur të meta teknike, si kthesa të forta, pjerrësi mbi normat e lejuara etj. Për rrugët në Shqipëri ka pasur gjithmonë një vizion dritëshkurtër, pa asnjë strategji zhvillimi dhe gjithmonë, edhe sot, janë prirur për shfrytëzimin e rrugëve të vjetra apo riparim e harxhim fondesh në gjurmët e vjetra të rrugës, edhe pse ajo rrugë ka qënë e rrezikëshme, jashtë parametrave teknikë, antiekonomike dhe janë influencuar tmerrësisht nga fondet, organizimi i punës dhe nga telashet që nxjerr ndërtimi. E si ka mundësi që të shfrytëzohen rrugët ekzistuese që prej 75 vjetësh,

kur plot kthesa kanë rreze 10, 15 apo 20 m. Automjetet duhet të ecin me 5 km në orë, që t’i marrin këto kthesa, se po të ecet më shpejt del nga rruga e përmyset. A ka patur ndonjëherë organe teknike shtetërore, studimore e projektuese dhe inspektuese që t’i bëjë problem rastet? Sot në Shqipëri janë dhjetëfishuar automjetet, është dhjetëfishuar sasia e mallrave dhe ka lëvizje të dendur, prandaj elementi i parë i zhvillimit është rruga. Ekonomia e tregut sot kërkon të kesh një strategji të hartuar me shumë kujdes, ku të merren parasysh se cili korridor rrugor do të kompletohet më parë me transversalet e tij, cilat nga këto kanë më tepër leverdi ekonomike, politike, turistike etj, dhe të punohet për të zbatuar e jo të ndryshohen planet sa herë ndërrohen qeveritë. Kështu vendi ynë do të ketë prespektivë të madhe në shfrytëzimin e resurseve, si të mineraleve, prodhimeve buqësore, blektorale, pyjore, turizmin malor, që është nga më të përshtatshmit, sepse nga Tirana shkon për një orë në plazh, ashtu si mund të shkosh për klimë të freskët në Qafë-Shtamë ose Qafë-Murrë etj, në qoftë se rrugët janë të përshtatëshme.

RRUGA E ARBËRIT

Banorët e rretheve verilindorë prej kohësh e kanë ngritur zërin që të ndërtohet rruga ➡



← e Arbërit, pra rruga e Dibrës, sepse kjo krijon mundësi për gjallërimin ekonomik dhe të industrisë dhe shton mundësi të mëdha turistike, lëvizjen e njerëzve dhe mallrave. Gëzohemi që ajo ka filluar. Rruga e Arbërit, me degëzimet e saj, do të krijojë mundësi për gjallërimin e bujqësisë dhe të industrisë, për mundësitë turistike dhe lëvizjen e njerëzve si dhe për të përmirësuar aksesin ekonomik të dibranëve dhe të shqiptarëve në atë anë të kufirit deri në Shkup, për të cilën ato janë shumë të nevojshme. Kjo do të mundësojë zhvillimin e tregut, zhvillimin ekonomik, marrëdhëniet midis trevave shqiptare, stabilitetin social e kulturor të të gjithë rajoneve të Shqipërisë. Duke e ditur se zona e Matit, Bulqizës, Dibrës etj, janë vende me pasuri nëntoksore, sidomos krom, rregullimi i rrugëve do të mundësojë interesin e investitorëve të huaj për të shfrytëzuar mineralet e për të hapur vende pune. Ky korridor rrugor, Dibër-Qafë Bual-Çafë Murrizë-Tiranë, nuk do të kishte të plotë vlerën, në rast se traseja e saj nuk do të kalonte në qytetin e Klosit. Qyteza e Klosit është njëje dhe qendër e rëndësishme rrugore për gjithë zonën verilindore. Klosi ka qenë njëje e vjetër rrugore që në kohën e ilirëve. Aty bëhej pazari i Urës, që Hahn dhe udhëtarë të tjerë të huaj e kanë vlerësuar si një njëje tregtare midis trevave të Tiranës, Krujës, Matit, Dibrës e më gjërë. Jemi të mendimit që të ripunohet strategjia rrugore, duke patur për bazë si qendër Klosin, nga ku mund të nisin rrugë të shkurtra për në qendra të rëndësishme, si në portin e Shëngjinit, në liqenet e Lurës, Peshkopi, Rrëshen e në shumë qendra rurale dhe ekonomike. Kjo mund të arrihet duke rikonstruktuar rrugët ekzistuese dhe duke hapur rrugë të reja nëpër vende të përshtatshme dhe me leverdi ekonomike.

1. Rikonstruksioni i rrugës Klos-Shoshaj-Rrëshen, takimi me rrugën Rrëshen-Morinë. Kjo rrugë do të kishte leverdi shumë të madhe për shqiptarët e Maqedonisë dhe për vetë Maqedoninë, e cila mund të përdorë këtë rrugë, Bllatë-Klos-Shëngjin, për të shfrytëzuar portin e Shëngjinit, për të shkuar në Mal të Zi, Kosovë e në zona të tjera. Shteti maqedonas shfrytëzon për tregëti portin e Selanikut, që është 100 km më larg se porti i Shëngjinit.

2. Duke ndërtuar një rrugë Klos-Cerujë-Patin-Qafë Burrel-Qafë Murrë-Guri i Vashës-Liqenet e Lurës, bëhet e mundëshme ndërtimi dhe vënia në efikasitet e qendrës turistike të liqeneve të Lurës dhe të zonave turistike të tjera, të cilat mund të bëhen më të mirat në Evropë dhe mund të konkurojnë me sukses turizmin alpinistik, malore e klimaterik. Kjo zonë ka objekte shumë të rëndësishme historike, sidomos për historinë e Kastriotëve, Arbërve etj. Krijohen mundësi të mira për shfrytëzimin e mineraleve të kromit, bakrit e pyjeve dhe lidhjen e fshatrave të thella me qendrat rurale e qytetare të rëndësishme.

3. Në Klos mund të ndërtohen e të vendosen agjensi të shumta tregtare, informacioni, të ndërtohet infrastrukturë për ruajtjen dhe shpërndarjen e mallrave në veri dhe jug. Kjo qendër forcon lidhjet midis

shqiptarëve e maqedonasve, marrëdhëniet midis dy kombeve, paqen, mirëkuptimin e ndërveprimin ndërmjet palëve. Gjithashtu ringjall traditën e vjetër qindrvjeçare të bashkpunimit e bashkjetesës midis shqiptarëve e maqedonasve. Dikur në kohë të vjetra Durrësi ka pasur si fuqi qytetin e Dibrës. Midis këtyre qyteteve të vjetër bëhej tregëti, zhvillohej qytetërimi, që ne mundohemi ta ringjallim. Natyrisht, ka vështirësi ndërtimi i këtij koridori dhe kërkon fonde, por është plotësisht i mundur dhe ia vlen që çdo shqiptar të bëjë sakrificë, qoftë kjo dhe përmes ndonjë takse të lehtë. Kjo do të shkurtonte ndjeshëm kohën e udhëtimit dhe do të rriste fitimet nga shkurtimi i kohës, kursimi i karburantit, amortizimi i automjeteve. Fitimet nga kjo janë 50% për çdo vit të ekonomisë shqiptarëve. Specialistët këtë e kuptojnë fare mirë, por nuk kanë ngritur zërin, nuk shpalosin ide e propozime të qarta. Korridori i rrugës së Arbërit, bashkë me rikonstruksionin e rrugës tashmë të vjetër, Klos-Shoshaj-Rrëshen-Milot, do të përmirësojë dukshëm gjendjen e keqe ekonomike të trevave verilindore Mirditë, Mat e Dibër dhe në kompleks me rrugën e re Rrëshen-Kalimash-Qafë Morinë, do të ishte një rilindje e krejt zonave verilindore të vendit tonë, që për nga sipërfaqja, përfaqsojnë 1/3 e krejt territorit të vendit. Mosinteresimi i duhur i qeverisë sonë për korridorin ka bërë që ky shans i madh me të vërtetë të humbë, duke bërë të mundur ngecien në vend të ekonomisë dhe zhvillimit. Zytratët përkatës nuk e kanë pasur dhe as e kanë të qartë se çdo të thotë zhvillim rrugor i vendit, ç'janë të mirat që na sjellin koridoret ndërballkanike e ndëreuropiane. Në rast se krerët e dikastereve nuk janë specialistë të këtyre fushave, atëherë ata duhet të thithin mendimin e specialistëve të mirfilltë, që vendi ynë ka me bollëk dhe shumë të zotë e të përkushtuar, por ata nuk i pyet njeri. Politika e ka vënë në dukje rëndësinë e rrugëve në Shqipëri dhe ka plot 17 vjet që hidhen fjalë në ajër, jepen variante, propozime nga mediat deri dhe në absurditet, si hapja e tunelit Durrës-Bari, apo Fushë Krujë-Burrel. Por konkretisht, siç theksuam më sipër, nuk është bërë sa u bë në 10 vjet të monarkisë së Zogut, 80 vjet më parë, kur shkëmbejntë hapeshin me varë e qyskia. Kurse sot zhvillimi i teknikës rrugore ka arritur perfeksionimin më të lartë. Punimet rrugore për gjurmim e betonim sot janë gjërat më të thjeshta dhe vetëm kërkojnë fondet përkatëse, mbasi nuk ka ndonjë vështirësi teknologjike të sofistikuar. Të mos hapësh rrugë sot në shekullin XXI është pazotësi, dembelizëm dhe antizhvillim. Sot është duke u kryer një punë shembullore për ndërtimin e rrugës Rrëshen-Kalimash-Morinë dhe kjo duhet konsideruar si një aksion i madh mbarëkombëtar e nuk duhet të hiqet vemëndja në realizimin dhe lënien e punëve, sepse kjo rrugë, siç është thënë, është shpresa e kombit shqiptar. Jo vetëm kjo, por dhe koridore të tjera, si ai me Maqedoninë, qytetet bregdetare shqiptare dhe zonat e brendshme të Shqipërisë, do të bëjnë që vendi ynë të shkojë në Europë me dinjitet.

PAZARI I URËS KLOS

Aqif YMERI

Pazari i Urës ka qenë pika më nevralgjike, që ndërlidhte rrugët e komunikimit jo vetëm me gjithë Matin, por edhe me Tiranën, Durrësin, Krujën, Dibërën dhe krahina të tjera brenda e jashtë vendit. Emërtimi “Pazari i Urës” lidhet me urën më të madhe, që gjithnjë ka qenë mbi lumin Mat në atë vend, urë e cila lidhte “Fushat e Urës” me “Stragjun”. Të moshuarit sipas thënieve të paraardhësve, thonë se ura ka qenë aq e madhe, sa në njërën anë fillonte nga arat ku ndante kufiri i Fushatit me Darsin dhe në anën tjetër mbaronte në fushën të rrapat (Pazari i Vjetër). Ndërsa etnologu Dilaver Kurti, duke përshkruar qytezën ilire të Xibrit dhe rrugët që lidheshin me të, shkruan se kjo urë ka qenë me një gjatësi prej rreth 150 m dhe me 6 deri 8 harqe (Trashëgime Iliro-Arbërore, faqe 23). Në shekullin e XVIII deri në fillim shekullin e XX, ka funksionuar një urë tjetër me gjatësi rreth 35 m, me tre harqe dhe dy dritare shkarkuese në mes, rrënojat e së cilës kanë qenë të dukshme deri në ditët tona. Jo shumë larg saj, mbi sheun, që vjen nga Kloskatundi (ky është emërtim i sotëm për ta dalluar fshatin e Klosit nga qyteti i Klosit), ka qenë një urë tjetër që lidhte Bejnin me Klosin për të dalë te “Stragju”. Kjo urë ka patur fizionomi të plotë deri në vitet 30-të të shekullit që kaloi. Emërtimi “Stragj”, është i lidhur me fjalën shqipe “treg” (tregju-treg). Hapësira e tregut kryesisht ka qenë midis dy ujërave, të Matit dhe të sheut, që vjen nga Klosi (Kloskatundi). Ky vend sot quhet “Pazari i Vjetër”. Për madhësinë e tij nga të huajt është quajtur edhe “Pazari i Matit”. Nisur nga emri i njohur në shekujt XVIII-XX, “Pazari i Urës”, të duket sikur ura ka qenë më e hershme se pazari dhe shumë shkruet të huaj e vendës e shprehin këtë. Por e vërteta është ndryshe. Ura e madhe në atë vend në çdo kohë është diktuar nga “Pazari i Madh “. Me të vërtetë fise nga fshati Fshat, kanë patur tokë në anën tjetër të lumit, siç kanë sot Sinajt, por ura e madhe nuk u ndërtua prej tyre asnjëherë, ajo është ndërtuar në atë vend vetëm prej tregut. Po të duhej vetëm si ndërlidhje midis zonave, si degëzim i “Rrugës së Arbërit” ajo mund të ndërtohej në një vend më të ngushtë midis brigjeve dhe të tilla vende ka patur shumë, sepse shtrati ka qenë shumë më i ngushtë në krahësim me shtratin e sotëm. Pra ndërtimi i urës me gjatësi 150 m është diktuar vetëm nga tregu, aq i madh e i rëndësishëm ka qenë ai. Edhe ura tjetër me gjatësi 35 m, me tre harqe e dy dritare shkarkuese në mes, e shkatërruar nga përmbytjet e mëdha të fillimshekullit të XX, është ndërtuar në shekullin e XVIII, po në atë vend, vetëm prej tregut, sepse edhe në atë kohë mund të ndërtohej në një vend tjetër të ngushtë shumë më

lehtë. Një vrojtues i kujdesshëm edhe sot mund t'i shquajë gjurmët e këmbëve të saj, por fatmirësisht pleqtë që kanë jetuar deri në vitet '70-të të shekullit që kaloi, kanë dëshmuar qartë për madhësinë, formën e pjesët përbërëse të saj. Edhe kjo urë, ashtu si edhe urat e tjera të gurta afër saj, mund të themi se ka qenë e stilit



venecian. Gjatë vrojtimeve e gërmimeve, arkeologu e etnologu Dilaver Kurti, ka përcaktuar tre pika të këmbëve të saj. Ai ka shkruar se në cepin lindor gjurmët e bazamentit të këmbës kishin përmasat 4 x 4 m dhe 22 m larg kësaj pike ka ndeshur gjurmë muresh të një trakti tjetër, që në sipërfaqe dukej me përmasat 2 x 2 m. Më tej 10 m larg tyre është gjetur një trakt tjetër, mbase e pjesës prëndimore, ku edhe aty pjesa e dukshme ishte me përmasa 2 x 2 m. Nga gojëdhënat kjo urë ka qenë ndërtuar prej familjes feudale të Allamanit nga Kurdaria, pasardhësit e së cilës dokumentohen që nga shekulli i XVI.

Duke qenë tregu më i madh i krahinës së Matit dhe nyje nevralgjike me rëndësi, gojëdhënat dëshmojnë se në atë vend në çdo kohë ka patur urë, e cila ndërtohej sipas mundësive që diktonte koha. Pranë Pazarit të Urës të bien në sy disa ura të gurta harkore të ngjashme me njëra tjetrën, të cilat ishin të domosdoshme në këtë pikënyje kryesore. Urën më të afërt mbi sheun e Klosit e treguam më parë. Pastaj vijojnë Ura e Halilit (Dars), Ura e Allamanit (Klos), Ura e Shahinit (Patin), ura e famshme në rrjedhën e sipërme të Matit, e njohur me emrin Ura e Vashës, Ura e Skurës dhe e Kulmares mbi zallin e Dishit (Guri i Bardhë), Ura e Hoxhës dhe Ura e Gurrave, përsëri në Gur të Bardhë, Ura e Shën e Premtes në Gurrë etj. Pra një rrjet i dendur urash të lidhura me degëzimet e Rrugës së Arbërit dhe kryqëzimin e tyre në Pazarin e Urës. E theksoj fjalën “degëzime”, sepse aksi kryesor i kësaj rruge ka qenë e do të jetë nga URA E VASHËS, dhe stacioni kryesor i saj ka qenë në Gur të Bardhë, pikërisht në lagjen Mansaj, emri i së cilës, siç e kemi shpjeguar edhe më parë lidhet me “stacionin rrugor”. Porta kryesore e kësaj treve ka qenë Qafë-Murriza, e cila është e vendosur në jugperëndim të luginës së Matit, në kufi me Zall-Dajtin. Kjo përbënte pikën kyçe të lidhjes së Ultësirës Perëndimore pranë adriatike me pjesën lindore e verilindore të vendit. Nga Qafë-Murriza, siç kemi treguar edhe kur



← kemi përshkruar Rugën e Arbërit, kalonin dy rrugë:

-Qafë Murrizë-Guri i Bardhë-Ura e Vashës-Plani i Bardhë-Qafë Buall-Bulqizë...Shkup.

-Qafë Murrizë-Qafë Shkallë-Klos. Në Klos kemi ndarjen në tri drejtime:

-Klos (Dars)-Ura e Halilit-Bel Unjate-Gurrë (krahu perëndimor i luginës së Matit).

-Klos-Suç-Shoshaj-Urakë-Perlat...Shkodër.

-Klos-Ura e Allamanit-Cerujë-Patin me dy variante:

Varianti veror: Patin-Qafë Dardhë-Qafë Mesi-Qafë Murrë...

Varianti dimëror: Patin-Kurdari-Gjalish-Lis-Qafë Murrë...Prizren.



Pazari i Klosit në vitet '70

Bri njërit degëzim, atij që kalon nga Qafë Shkalleja, ka qenë Kalaja Ilire e Xibrit, për të cilën dëshmitë historike pohojnë se kjo qytezë ka patur kulmin e zhvillimit në shekujt IV-II p. l. K. Nga Pazari i Urës janë tri rrugë që të çojnë në këtë qytezë. Dy prej tyre përshkojnë katundin Dars dhe e treta lagjen Ballosh të fshatit Fshat. Me rrënimin e kalasë Ilire të Xibrit, në majën mbi Lezedër në fshatin Fshat, u ndërtua kalaja e Petralbës, që njihet nga vendësit me emrin Kalaja e Skënderbeut. Për rrugët dhe zhvillimin e tregëtisë në këtë vend kemi dy dokumente të vjetra: I pari bën fjalë për një marrëveshje në fillim të shekullit të XIII, e firmosur nga Dhimitri, "Princ i Madh i Arbërit", me të cilën ky u garanton raguzianëve kalim të lirë nëpër tokat e tij, pra nëpër shtetin e Arbërit, që përfshin këtë zonë dhe në tërësi Matin. Dokumenti i dytë është i vitit 1429, i firmosur nga Gjon Kastrioti, me të cilin gjithashtu u sigurohet tregëtarëve raguzianë kalim i lirë nëpër tokat e Kastriotëve, pra nëpër këtë trevë me nyje të rëndësishme Pazarin e Urës. Ndërsa Hahni në udhëtimin e tij të vitit 1863, shkruan: "Afro një çerek ore në jug të Bejanit (Bejnit), i cili kishte një shpërndarje shumë të gjërë, drejtpërsëdrejti në shërgun e djathtë të Matit, ndodhet një shesh i cili quhet Pazari i Matit. Këtu, çdo të dielë, zhvillohet tregu më i madh i të gjithë Matit. Popullsia vërshon drejt tregut nga zona që ndodhen gjashtë deri tetë orë larg për të shitur prodhimet e për të blerë artikuj që i nevojiten. Në tregje të tilla si rregull, burrat përbëjnë shumicën dërrmuese, megjithëse nuk mungojnë dhe gratë e moshuara dhe vajzat e reja. Nganjëherë ndodh që të zbresin në Pazar edhe gra të reja nga viset që ndodhen fare pranë, ndonëse një frekuentim tepër i shpeshtë i tregut nga ana e tyre nuk shihet me sy të mirë. Nga gratë që patëm rastin të takojmë rrugës, vetëm ato më të moshuarat guxuan të na hidhnin vështrimin, ndërsa shumica kthenin kokën mënjane sipas mënyrës turke". Duke përshkruar më tej udhëtimin e tij, Hahni përsëri shkruan: "...Rrethi

në të cilin ndodhet qendra e Mudirit, quhet Lisa, ose me parafralën e vendosur përpara Mlisa, që në të vërtetë do të thotë: në Lisa (në Lis). ...Kur kaluam pranë atij vendi prej të cilit e merr emrin ky rreth dhe me të cilin nuk duhet parafratyruar një fshat në kuptimin që i japim në këtë fjalë, por një shesh i lirë i rrethuar prej disa shtëpish të veçanta me një përhapje të madhe, në të cilin çdo të diel zhvillohet tregu i dytë Matit për nga rëndësia, ne gjetëm të grumbulluar rreth 400-500 njerëz dhe vumë re se zhvillimi i tregut ishte në lulëzim të plotë". Pra tregu i parë e më i madhi, ishte Pazari i Urës, i dyti ishte ai i Lisit. Në Mat kanë qenë të njohur edhe dy tregje të tjerë: Tregu i Komsisë dhe ai i Derjanit. Në Pazarin e Urës përveç fshatrave përreth të zonës së Klosit, vinin për tregëti edhe fshatarë nga Gurrat, Xibrat e Guri i Bardhë, Suçi, Kurdaria, Martaneshi, Bulqiza, Zerqani etj. Në veçanti vinin tregëtarë nga Dibra, Elbasani, Tirana, Kruja, Durrësi etj. Mbi Pazarin e Urës, në fshatin Fshat, është vendi i quajtur Kodra e Pazarit dhe rreth 250 metra më lart është një luginë e ngushtë e njohur me emrin Lugu i Arrave. Rrënojat e atij vendi banorët, brez pas brezi, i kanë njohur me emrin Dyqanet e Venedikasve. Nëpërmjet tregëtarëve venedikas, familja e Llaveshajve, që në shekullin e XV, ka siguruar nitratin e potasit (KNO₃), lëndën e parë kryesore për prodhimin e barutit. Tregëtarët venedikas kanë luajtur një rol të rëndësishëm në Pazarin e Urës në kohën e Kastriotëve. Në këtë Pazar, në çdo kohë, përveç prodhimeve të shumta bujqësore e blegtorale, tregëtohej edhe kripa, që vinte nga Durrësi nëpërmjet Qafë Murrizës, po ashtu vajguri, prodhimet e poçerisë, të zejtarisë vendëse, të veshmbathjes, pëlhura të ndryshme, prodhimet e mëndafshit që në Kryemat kanë qenë me shumicë, prodhime që përgatiteshin me tezgjahë, si qashe (shajak) dy liçe e katër liçe, pëlhura të ndryshme, flokje, qilima, varëse e stoli për gratë, prodhime artistike prej druri e vegla pune, prodhime të farkëtarëve etj. Prodhimet e enëve prej balte vinin kryesisht nga Keta e nga Martaneshi, ndonëse

prodhoheshin dhe në fshatra të Klosit. Shajaku që prodhohej nga vendësit ka qenë mjaft cilësor. Pëlhurat prej leshi në tullarë endeshin nga gratë në çdo fshat të trevës së Klosit. Valanica ka patur më shumë në Dars, Fullqet (në kufi me Darsin), Bel, Bejnë e Klos, po ashtu prodhohej e tregtohej edhe pëlhura prej lini. Të moshuarit tregojnë se në shumë shtëpi bëhej kujdes i veçantë për prodhimin e mëndafshit, madje kishte dhoma të veçanta për rritjen e krimit të mëndafshit. Mbasi tregu i Klosit ishte i madh dhe shumë i zhvilluar, tregëtarë nga krahina të ndryshme të vendit zinin shtëpi me qira në fshatrat e Klosit dhe hapnin dyqanet e tyre, siç është rasti i Vath Bajronit (Lushit) nga Tirana, që kishte magazinë dhe dyqan të Llaveshajt në fshatin Fshat, pranë Pazarit të Urës deri në vitet '40-të të shekullit që kaloi. Pra përveç tregëtarëve që vinin nga larg ditën e pazarit, kishte edhe të tjerë të ardhur, që ishin vendosur në Klos e në fshatrat e tjerë, që për arsye të ndryshme për të cilat s'është vendi të zgjatemi, kishin zënë shtëpi dhe hapur dyqane, pra kishin shtëpi-dyqane. Nga që gjithë zona të ne ishte myslimane, të moshuarit për këta tregëtarë që kishin ardhur kryesisht nga Maqedonia e trevat shqiptare përtej kufirit, i tregojnë edhe sot me emërtimet "kaurri i Bejnës (Nikolla), "kaurri i Fullqetit" (Dhimitri), "kaurri i Cerujës" (Spiro), "kaurri i Patinit etj. Këto kishin shtëpi dyqane në fshatrat që përmendëm, madje kanë qëndruar deri vonë kur regjimi diktatorial tregëtinë private e quajti "të zezë" dhe e ndaloi. Në Mat pazaret kanë qenë ditore, reklamoheshin mallrat ditën e pazarit paradite e pasdite, pra nuk ka patur ndërtim dyqanesh. Pazarit i Urës dallonte nga pazaret e tjerë, sepse ka patur edhe dyqane në të cilët përveç ditës së pazarit tregëtohej edhe në ditë të tjera të javës. Ndërtesa dykatëshe e Dodës të Pazarit i Vjetër është edhe sot. Përveç Dodës, dyqane në Klos patën ndërtuar edhe fise të tjerë si Llaveshajt e Çupajt nga fshati Fshat, Hoxhajt nga Fullqeti, Mëziri nga Klosi etj. Disa nga ato ndërtesa janë edhe sot.

Duhet përmendur një fakt i rëndësishëm: Në kohën e Zogut, për katër artikujt më të nevojshëm për jetesë bëhej kujdes i veçantë; për bukën, kripën, vajgurin (gazin siç thuhej atëherë) dhe sapunin. Gryka e thesit të misrit, të kripës apo fuçia e gazit nuk hapeshin pa reklamuar tellalli çmimin, që diktohej nga qeveria. Për këto artikuj jetësorë kishte çmim tavan, mbi të cilin nuk lejohej shitja. Në atë kohë ditë pazari ka qenë e shtuna.

Tregu i Klosit ishte sa i madh, aq edhe i larmishëm. Këtu gjithashtu tregëtohej edhe baruti që prodhohej me shumicë nga Llaveshajt në Fshat, Reçi e Halili në Dars, Dishajt në Ketë etj. Dihej se Llaveshajt kryesisht e shisnin barutin në Prizren, Gjakovë, Dibër, Elbasan, Tiranë, Berat e deri në Janinë, Rumeli e Greqi. Në Pazarin e Urës ishin krijuar lidhjet me tregëtarët e këtyre vendeve. Reçi barutin e tij e shiste në Shkodër e Gjakovë. Megjithatë baruti tregëtohej shumë edhe në Pazarin e Urës ku vinin tregëtarë nga vise të ndryshme brenda e jashtë vendit.

Pazaret përveç shitblerjes së mallrave e të kafshëve kishin edhe një funksion tjetër. Ata luanin edhe rolin e

vendtakimeve, lajmërimeve e komunikimit midis fshatarëve me njëri-tjetrin. Këtë rol që nga koha e Kastriotëve, për shumë kohë e ka luajtur një vend i njohur me emrin "Dardhat e Kuvendit", që është rreth 350 hapa larg Kodrës së Pazarit në Fshat, rrëzë malit ku është qyteza e Petralbës. Në atë vend merrnin pjesë në kuvend jo vetëm banorët e dy lagjeve të Petralbës (Tanushë e Gurëza), por edhe të zonës përreth, sidomos në kohën e Kastriotëve ku për kuvendim thirreshin përfaqësues nga gjithë krahina. Më vonë këtë rol e luajti vendi i njohur me emrin Kodra e Plakut që ndodhet gjithashtu në Fshat, midis Petralbës dhe Pazarit të Urës. Thëksojmë se pellgu rreth e mbi Pazarin e Urës, ka qenë i populluar dhe ka patur aktivitet në çdo kohë të ekzistencës së shoqërisë njerëzore. Është e nevojshme të pohojmë, se banesat, më shumë për arsye sigurie, kanë qenë ndërtuar në majat mbi luginë, siç është qyteza ilire e Xibrit mbi malin e Darsit, kalaja e Petralbës, e Cerujës, etj. Ato nga koha në kohë, kanë ardhur duke zbritur nga lartësitë e shpatmaleve e kodrave, poshtë në taracat e tipit erozivo-akumulues të kësaj luginë dhe së fundi në luginë deri mbi shtratin e lumit. Disa studiues mendojnë se ky pellg, madje e gjithë lugina dikur ka qenë liqen. Kjo është e vërtetë, por kjo luginë ka qenë e tëra liqen në epokën e Miocenit, epokë e Cenozoikut, që zgjati nga 24 deri në 5 milion vjet më parë, ndërsa njeriu u shfaq në Tokë 5 milion vjet më parë (era kuaternare). Pra nga koha e ekzistencës së njeriut ky vend ka qenë i liru nga uji. Liqeni është tharë nga vetë lumi nga fundi i miocenit.

Pazarit i Urës ka qenë një pikënyje e rëndësishme jo vetëm për krahinën tonë por edhe për zona të tjera brenda e jashtë kufijve të vendit. Ai ka qenë i njohur edhe në botë. Megjithatë regjimi diktatorial duke e quajtur atë "treg të zi", u përpoq ta eliminonte si treg. Goditjen më të madhe ky treg e mori në vitet '70-'80-të të shekullit që kaloi, në kohën e varfërisë e skamjes më të madhe dhe sikur të mos mjaftonte kjo, tellallët e regjimit me artopolant shanin e përgojnin njerëzit që me shumë mund e dërsë mudoeshin të tregëtonin ato pak prodhime për të mbijetuar. Nën maskën e "tregut të zi" përndiqeshin e persekutoheshin njerëz jo vetëm të pafajshëm por edhe të vuajtur. Në ditët tona tregu i Klosit e ka rifituar gjallërinë. Tani pazari bëhet në të dalë të qytetit, në hapësirën pranë urës që lidh Klosin me fshatrat Fullqet, Dars, etj.

Materiale të shfrytëzuara:

1. D. Kurti, "Trashëgime Iliro-Arbërore", fq.23, 187, 228-229, 250.
2. R. Fiçorri: Mati, fq.150-153.
3. V. Shtylla: Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri, Tiranë 1998, fq.24.
4. K. Kamsi, "Shkodra", 1962, Nr.2, fq.251.
5. J. Adam: Buletini i Shkencave Shoqërore, Tiranë 1953, fq.23-64.
6. Johann George Von Hahn: Njëpër viset e Drinit, fq.60-61, 69.
7. R. Drishti: Armët dhe armëtarët shqiptarë, fq.176.
8. Të dhëna e dorëshkrime të të moshuarve në Klos.

PASURI GJUHËSORE

Thesar kulturo-historik i fshatit Fshat në emrat e vendeve

Treguar Nga Osman Doka, 89 vjeç, viti 2008

Vijon nga numri i mëparshëm.

103. FUSH' E URS (FUSHA E URËS), fushë pak më lart se përballë Pazarit të Vjetër, që është në krahun e djathtë të lumit Mat dhe i takon Klosit. Fush' e Urs ndodhet në krahun e majtë të lumit. Në fund të kësaj fushe ka qenë një urë e madhe prej guri. Tani është urë teli, por themelet e këmbëvevet janë aty. Dëshmohej kështu lashtësia e urës, pasi fusha e ka marrë emrin prej saj.

104. GROP' E ESHKËS (GROPA E ESHKËS), vend dikur i pyllëzuar, sot shkurrishte *"përme shpei t'Ali Seins"* (përmbi shtëpinë e Ali Sinës). Eshka është një lloj kërpurdhe që rritet në trungjet e kalbur të drurëvevet dhe kur thahet e regjet, përdoret për të ndezur zjarrin, *"për t'zan zjarm me unur"* (për të zënë zjarr me uruar). Duhet të vihet re prapashtesa –KË.

105. GROP' E MULLEZËS (GROPA E MËLLEZËS), vend në brinjë të malit, poshtë Petralbës.

106. GJABZ' E FSHATIT (GJABZA E FSHATIT), vendi ku përshkohet lumi Lezedër midis shkëmbinjvet. Quhet Gjabza e Fshatit në dallim nga Gjabza e Darsit, ku një shë tjetër përshkohet po kështu përmes shkëmbinjvet. Kuptohet që emri Gjabëz nuk është vetëm emër i përveçëm, por edhe emër i përgjithshëm, por cili është kuptimi?!

107. GJARREJA, toka pranë lumit Mat. Janë gurishte. Në Shestan ka Qorëja dhe Gjordhëja.

108. GJURI GJAT (GURI I GJATË), gur në pozicion vertikal në kanionin poshtë Urës së Vashës, monument natyre. Në përgjithësi, kanioni i Urës së Vashës është një monument natyre i madhërishtë, ashtu si edhe Gjabëza e plot vende të tjerë.

109. GJURI GJAT' N'BAREZ (GURI I GJATË NË BAREZË), gur që ka qenë në pozicion pingul nga natyra, por që kohët e fundit e ka shembur rrufeja. Ndodhej te Kalaja e Fshatit, dmth në Petralbë, te vendi, që quhet DY BIRAT në krah të Lugut të Bojës.

110. GJURI KE RRIM (GURI KU RRIMË), vendpushim ku uleshin barinjtë për të ndenjur. Emërtim mjaft interesant. Ndoshta do të mund të cilësohej monument kulture.

111. GJURI ME THUMA (GURI ME THUMBA), një shkrep gëlqeror mbi sipërfaqen e të cilit ka pjesë të ngritura përpjetë dhe të mprehta. Poshtë tij ruhen fragmentet e një kalldrëmi të moçëm, i cili zbret deri te *Vorret e Fshatit*. Shkëmbi vetë është monument natyre, ndërsa kalldrëmi monument kulture dhe monument historik.

112. GJURI MULLEZËS (GURI I MËLLEZËS), gur në një brinjë sipër Çupëvet.

Gjokë DABAJ

113. GJURI SHINJ (GURI SHENJË), gur përmbi shtëpi të Elmaz Voshit. Nuk ndodhet në territorin e Fshatit, por u ka shërbyer banorëvevet të tij për të përcaktuar kohën. Osman Doka thotë: *"Kur e late dielli atë shkam, at'herë e çoshim gjanë për drekë"*. Është monument kulture. Një gur i tillë gjendet edhe Ljare të Shestanit. Ai quhet Rrasa e Diellit dhe u ka shërbyer banorëvevet si një orë.



114. GJURKUSARE (GURKUSARE,-JA), një shkëmb në jug-lindje të *Kroit të Lugut*. Përtej Gjukurusares gjendet Tàllasi. Kuptohet që ka lidhje me ekzistencën e kusarëve dhe në këto anë, si në shumë vende të Shqipërisë.

115. GJURR' E SKËNDERBEUT, burim përtej kalasë së Fshatit në krahun e fshatit Shkallë, në vendin e quajtur *Lugu u Bojës*. Është toponim me rëndësi historike, monument kulturo-historik.

116. HANI I KAPELLIT, vendi ku ka pasur dikur një bujtinë, një han. Ndodhet në vendin e quajtur *Murgjatë* e njëkohësisht edhe *Teqeja e Gurit të Bardhë*. Si territor përbën kufirin midis dy fshatrave Fshat dhe Guri i Bardhë. Duhet theksuar dhe fakti që sot në Gur të Bardhë ka një fis që mban emrin Kapelli. E gjithë kjo na bën të ditur që dikur në atë vend ka pasur një vendqëndrim murgjërish dhe ata natyrisht kanë pasur aty Kapelën e vet, pra një kishëz. Më vonë me ardhjen e turqve, mbi themelet e saj është ndërtuar teqeja, ndërsa bujtina e murgjëve është shndërruar në han, në të cilin kanë vazhduar të ndalojnë udhëtarët. Fisi që e ka trashëguar atë han, ka marrë dhe emrin Kapella, ndonëse është myslimanizuar. Kështu Hani i Kapellit është një toponim i rëndësishëm historik.

117. KALAJA E FSHATIT, rrënojë kështjelle në majën e malit sipër fshatit Fshat. Osman Doka thotë se në popull kjo kështjellë nuk thirret as Kalaja e Gurit të Bardhë, as Petralba. Po, kjo nuk e ndryshon faktin se kjo kështjellë është Guri i Bardhë, i thonë edhe Kalaja e Skënderbeut, përkthyer në latinisht, Petralba. E themi këtë, pasi është pushtuar vendi nga turqit, kështjella është shkatërruar, ndërsa një pjesë e banorëve janë zhvendosur më në veri, duke marrë me vete dhe emrin Guri i Bardhë. Në këto kushte, rrënoja, si duket, ka marrë emrin Kalaja e Fshatit.

Do përmendur këtu edhe fakti që pjesa e banorëve të fshatit Fshat konsiderohen gurabardhas, si dhe disa toponime lidhen me emra fisesh që nuk jetojnë në Fshat, por në Gur të Bardhë. E gjitha kjo na çon te konstatimi se Fshati dikur ka qenë pronë e banorëve të kështjellës. Kështu, krejt natyrshëm, kur kështjella është shndërruar në kullosë për bagëti, ajo është quajtur e Fshatit. Kalaja është monument historik me rëndësi kombëtare, në të cilën do vënë dorë, me qëllim për ta shndërruar në vend turistik me leverdi edhe ekonomike për banorët vendas.

118. KALLDRAM I VJETËR (KALLDRËMI I VJETËR), është një gjurmë rruge, e cila lidh Shkallën e Madhe me Gurin e Bardhë dhe thuhet se e kanë ndërtuar te vendi që quhet Murgjatë. Është monument historik.

119. KAMARJA ME GJUR (KAMARJA ME GURË), është një grumbull gurësh mbi të cilin njerëzit, kur kalojnë andej, hedhin nga një gur, për shkak se thonë, aty ka vdekur një njeri. Ky vend ndodhet para se të dalësh në Qafë të Bunarit. Në të vërtetë është një varr tumular, një tumë, mbi të cilën edhe sot vazhdojnë të kryhen ritet e kohës së ilirëve. Dëshmi e rendësishme, që shqiptarët janë pasardhës të ilirëve. Një tumë e tillë e mbijetuar, mbi të cilën vazhdojnë edhe sot të kruhen rite, ndodhet edhe në Majën e Rumisë përsipër Tivarit. Aty njerëzit çojnë vit për vit nga një gur. Edhe emërtimi KAMARE, fjalë që vjen nga greqishtja, me kuptimin kubë, gungë, dëshmon për një trashëgimi nga lashtësia.

120. KARAKOLLI, toponim në krahun e djathtë të lumit Mat, që i takon Planit të Bardhë, por që lidhet me rrugën e dibranëve, e cila kalon nëpër territorin e Fshatit. Dëshmon për ekzistencën aty të një trupe të armatosur, e cila ruante rrugën që të çonte nga Tirana për në Dibër. Është toponim historik.

121. KEPAT E LQETHIT, gurë që rrinë pingul, ndodhen në fund të vendit me emrin LQETH, poshtë lapidarit të Ibrahim Dukës.

122. KEISH' E DOKËS (KISHA E DOKËS), emër vendi ku dikur ka pasur kishë. Quhet dhe KEISH' E CA ZENELIT (KISHA E CAN ZENELIT). Është monument historik, pasi sot në këtë fshat nuk ka të krishterë.

123. KODR' E PAZARIT, emër vendi poshtë kështjellës, sot ambient mali, ku nuk ka asnjë gjurmë të ekzistencës së ndonjë tregu. Është toponim me rëndësi historike, sepse dëshmon që aty ka pasur një fortesë, por dhe një jetë të gjallë ekonomike.

124. KROI I TURKUT, krua poshtë kroit të Dokës. Prej këndeje, në një gjatësi prej rreth 500 m çohet uji me anë të tubave të dheut, deri në lagjen Tanushaj, te xhamia. Mbeturinat e këtij ujësjellësi gjenden edhe sot në disa fragmente. Toponimi ka rëndësi historike, sidomos kur lidhet me ujësjellësin.

125. LEZEDRA, lum ose shë, që derdhet në krah të majtë të lumit Mat. *Buron ke Gjurrat e Gjurit t'Bardhë* (Gurrat e Gurit të Bardhë), *n'Qaf' t'Ukut* (në Qafë të Ujkut). Dua të ve në dukje këtu, se në pjesën veri-perendimore të Liqenit të Shkodrës ka një ishull me emrin LESENDRO. Nuk besoj të ketë lidhje me Aleksandër, megjithatë, mbetet për t'u hulumtuar.

126. MAJ' E BAREZËS (MAJA E BAREZËS), ndodhet të Kalaja e Fshatit, në anën e prapme. Gojëdhana thotë se në atë majë ndodhen gjurmët e kalit të Skënderbeut, i cili prej andej është hedhur dhe ka fluturuar bashkë me të zotin në anën tjetër të humnerës. Gjurmët, thotë Osman Doka, janë vërtet aty, të gdhendura në gur.

127. MAJ' E QYTETS (MAJA E QYTETËS), është pika më e lartë e vendit që quhet Kalaja e Fshatit. Toponim historik. Bie në sy gjinia fundore e emrit QYTET/Ë, -A, -ËS.

128. MAJ' E KEISHËS (MAJA E KISHËS), arë sipër vendit që quhet kishë, ose kisha e Dokës. Ka edhe varreza. Është toponim historik pasi dëshmon që popullsia këtu dikur ka qenë e krishterë.

129. MULLEN I FSHATIT (MULLIRI I FSHATIT), vendi ku ndodhej një mulli në Grykën e Gjabzës. Ka qenë pronë e Bajr Dulit (e Bajram Çupës të vjetër)

130. MURGJATEU, vendi ku ndodhet Teqja e Gurit të Bardhë. Është toponim me rëndësi historike, sepse dëshmon që aty dikur, para ardhjes së turqve, ka pasur një vendqëndrim murgjish, manastir.

131. PETRALBA, emër që disa nga vendasit e përdorin si sinonim i Kalasë së Fshatit, nën ndikimin e literaturës.

132. QAF'-DERVEN, qafë që ndodhet përtej Urës së Haxhiut. Aty ishte vendosur dikur një rojë turke, e cila quhej Karakoll. Të dyja këto edhe Qafë-Derveni edhe Karakolli i takojnë Planit të Bardhë. DERVEN është fjalë persishte dhe do të thotë grykë mali, pra QAF'-DERVEN është Qafa e Grykës. Ndërsa KARAKOLL është fjalë turke dhe do të thotë rojë, patrullë, truproje.

133. QAF' E QYTETIT (Qafa e QYTETIT), qafë mali *para se me hip n'Majqitet* te kalaja e Fshatit. Toponim me rëndësi historike. Ruan formën mesjetare, e cila për kështjellë, siç shihet, është zëvendësuar me fjalën orientale Kâla.

134. SHKALL' E DENGËS, kalim shkëmbor te shkrepit e Barezës, *n'tefe t'shkambit*. DENGË ose DINGË është emri i një mekanizmi që shërbente për prodhimin e barutit. Toponim me rëndësi historike.

135. TANUSHAJ, lagje në fshatin fshat. Dëgjohet edhe TANUSH, -TË, ose dhe ndonjë formë tjetër. TANUSHI, i pari i kësaj lagjeje ka zbritur këtu në një kohë që s'mbahet mend nga Guri i Bardhë. Do vënë re që emri TANUSH vjen nga koha e Arbërisë, paramyslimane. Është toponim historik.

136. URA ME DERË, është vendosje shkëmbinjtë në formën e një dere, të lartë, afër 2 m, por që i ngjan edhe urës. Nuk i ka vënë dora e njeriut, prandaj mund të konsiderohet monument natyror.

137. UR' E HAXHIUT, urë që kalon mbi lumin Mat, e cila gabimisht përmendet si Ura e Vashës. E ka ndërtuar një i pasur nga Guri i Bardhë, që quhej Haxhi. Po ky, Haxhi, ka ndërtuar edhe xhaminë e Tanushajve.

138. UR' E VASHËS, urë e vogël, që kalon mbi zallin e Gurit të Bardhë e cila gabimisht thirret Ura e Skurës. E ka financuar një vashë (vajzë) prej Gurit të Bardhë dhe prandaj quhet kështu. Ndodhet afër Urës së Haxhiut. ■

TEOLOGËT E GURRËS

Halit MUHARREMI

Curra, një vend i vogël, i dashur e mikpritës në gjirin e saj ka mbajtur edhe plot dijetarë teologë, të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre ndaj atdheut e fesë arritën të përjetësonin emrin e tyre kudo ku shkuan e punuan.

Gjatë shekullit XVIII e deri në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX, shumë djem nga Curra studiuan për teologji në Stamboll dhe Egjipt. Ndër ta mund të përmendim: hoxhë Pepa, mollah Selim Lela, mollah Mehmet Lela, Ismail Arriku, më pas hafiz Sali Kadiolli, myfti Ismail Hasa, hafiz Beqir Hasa, vëllezërit Ramazan e Selim Arriku. Ndërsa Jashar Kadiu e Cen Bajrami (i njohur me emrin Kadi Boza) u diplomuan për drejtësi. Kushtet që favorizuan djemtë e Gurrës për t'u shkolluar jashtë vendit në atë kohë ishin të shumta, por ajo që vërtet ndikoi ishte pozicioni i familjes së tyre në administratën turke, ku ata mbanin funksione të rëndësishme. Kështu, familja Zajmi mbante postin e serasqerit, Pepajt ishin flamurbajtës në taborët nizamije. Familjet Kadiu e Boza gëzonin statusin e gjyqtarit. Haslikajt, Arriku e Muharremi kishin ngritur bizneset e tyre në Edrene.

Në Stamboll ishte arsimuar dhe jetonte hoxhë Xhihani (hoxhë Curra nga Mishtri), ekspert i ligjit Islam pranë shehul islamit. Ai luajti një rol të rëndësishëm në tërheqjen e nxënësve nga vendlindja, duke i mbështetur dhe përkrahur gjatë shkollimit.

Ky shkrim i shkurtër në rrugëtimin e besimit islam i kushtohet dy teologëve: hafiz Sali Kadiolli dhe myfti Ismail Hasa, që dhanë një kontribut të vyer e mjaft të rëndësishëm në ndërtimin e institucioneve të besimit dhe në përhapjen e Islamit në Gurrë gjatë shekullit XX. Hafiz Sali Kadiolli studioi për teologji në Stamboll. Aty mësoi përmendësh Kur'anin dhe mori titullin *hafiz*. Pas mbarimit të shkollës, ku përvetësoi gjuhët turke dhe arabe, kthehet në Gurrë. Në vendlindje i kushtohet deri në fund të jetës detyrave të besimit, si imam dhe mësues i fesë Islame.

Myfti Ismail Hasa i nisi studimet në Stamboll, për t'i përfunduar në Kajro. Shkollimi i zgjati 15 vjet (1895-1910). Diplomohet për Sheriat, mëson shkëlqyeshëm gjuhët arabe e turke. Ismail efendiu nuk u angazhua me detyra në strukturat e komunitetit mysliman. Shkaqet nuk dihen.



Hafiz Sali Kadiolli

Në fillim të shekullit që shkoi, Curra numëronte treqind shtëpi. Në lagjet Hoxhaj, Mishter, Lezaj, Bakej e Shulbatër, sot të gjithë fshatra më vete, ekzistonin objektet e kultit, xhamitë, por mungonin udhëheqësit e fesë, imamët. Në këtë kohë, kërkohej

institucionalizimi i marrëdhënieve imam-xhemat, zbatimi i detyrimeve dhe të drejtat e palëve si dhe përgatitja e imamëve. Ishte i nevojshëm një organizim i ri i thirrjes së njerëzve në besimin islam. Këto përgjegjësi i morën mbi vete teologët e rinj hafiz Saliu e myfti Ismaili. Dituritë në fushën e besimit, shpirti energjik i ushqyer me parimet e shkollave islame do të vërshonin me një ekspansion të fuqishëm krijues në çdo besimtar, duke vënë në lëvizje dëshirat e tyre për të kontribuar në zhvillimin dhe përhapjen e fesë islame. Njerëzit u hodhën në veprim. Në kohë rekord u riparuan e u vunë në gatishmëri xhamitë e vjetra dhe u ndërtuan edhe dy të reja.

Myfti Ismaili e hafiz Saliu ndërtuan institucionin e xhamisë. Ajo, si vend adhurimi i dijes islame dhe i thirrjes së njerëzve në besim, përbënte

thelbin e reformës që synohej. Ata ngritën këshillat e xhamive, përcaktuan statusin e imamet dhe detyrat e komunitetit, fshatit ndaj xhamisë. Sipas statusit, imami ka për detyrë: të prijë faljet në 48 namazet e xhumasë, të bëjë përgatitjen dhe përcjelljen e të vdekurve, të kryejë ritet përkatëse, të bëjë kurorëzimin e martesës ndërmjet çiftëve, të këndojë të sëmurin tre ditë pa shpërblim, nëse i kërkohej nga besimtarët. Komuniteti detyrohej të shpërblente imamin me 15 okë misër ose grurë për familje në vit, të mirëmbante e siguronte xhaminë, ta plotësonte atë me orenditë e nevojshme nga kontributet e besimtarëve dhe vakëfi.

Më 1920 hafiz Saliu hapi mektebin (shkollën) e parë për përgatitjen e imamëve e muezinëve. Shkolla u ngrit dhe funksionoi sipas modelit të mektebeve arabo-turke. Programi përqendrohej te libri i shenjtë, Kur'ani, ku përparësi kishte leximi bukur e me ndjenjë dhe komenti i tij. Nëpërmjet Kur'anit nxënësit mësonin leximin e shkrimit në arabisht. Pjesë e rëndësishme e programit, hartuesi dhe zbatuesi i të cilit ishte hafiz Saliu, ishte edhe tradita profetike (syneti) dhe historia e profetëve. Afati i studimeve zgjaste tre vjet. Më 1924, përfunduan shkollën 20 nxënësit e parë. Më 1926,

pas dy vitesh praktike, me propozim të hafizit shtatë nxënës që mësuan në mektebin e Gurrës morën dekretin nga komuniteti mysliman shqiptar dhe u emëruan imam në xhamitë e fshatit. Ata veshën petkun fetar dhe e mbajtën në trup deri në fund të jetës.

Në vitet pesëdhjetë kam dëgjuar ish-nxënësit e hafizit duke lexuar Kur'anin. Më ka magjepsur zëri i tyre i bukur dhe artikulimi i pastër i fjalëve. Në ato vite në Gurrë, besimi te Zoti u gjallërua shumë. Xhamitë mbusheshin me besimtarë jo vetëm ditëve të xhumasë e në festat e bajrameve. Xhamia kryesore hapej çdo ditë për faljen e namazeve ditore. Njerëzit agjëronin të gjithë. Në muajin e ramazanit, jeta shpirtërore e besimtarëve rigjallërohej. Jepeshin ndihma për njerëzit në nevojë, përgatiteshin iftare dhe shtoheshin vizitat mes miqve dhe të afërmeve. Në të gjitha lagjet falej namazi i teravijve. Dita e bajramit ishte momenti, ku njerëzit uronin festën dhe falnin njëri-tjetrin për ndonjë hatërmetje që mund të kishte ndodhur mes tyre gjatë vitit. Pajtimi dhe falja ishin mbretërit e gjykimeve në ditën e festës.

Hafiz Saliu ishte mësues dhe imam i xhamisë së madhe deri më 1941, vit që shënon edhe largimin e tij nga kjo botë. Zemra e hafizit qëndroi deri në fund e hapur dhe mikpritëse për të gjithë. Ai praktikoi besimin e vërtetë, dashurinë ndaj Zotit dhe njerëzve, predikoi paqen, drejtësinë e mëshirën. Myfti Ismaili ndonëse nuk pati një detyrë të caktuar, punoi deri në fund të jetës për thirrjen e njerëzve në besimin islam.

Mësimet e tij ishin një rreze dritë për të gjithë. Ai thoshte: *"Shpirti i njeriut ka nevojë për besimin te Zoti, siç ka nevojë lulja për rrezet e diellit"*. Ismaili në Ramazan vinte në Tiranë, ku kishte miq të shumtë. Në familjen e Rexhep Shabës ai e kishte derën gjithnjë të hapur. Myftiu e shfrytëzonte muajin e agjërimit për të mbajtur ligjërata në xhamitë e Tiranës dhe udhëhiqte faljen e namazit të teravijve. Që në fillim, myftiu simpatizoi qeverinë e Zogut dhe mbretërinë konstitucionale. Meqë kishte mbaruar shkollën për shariat shpresonte të merrte ndonjë detyrë në administratën e mbretërisë. Por kjo nuk ndodhi, pasi me hyrjen në fuqi të kodit civil më 1928, statusi personal laik zëvendësoi statusin fetar, që vepronte deri në atë kohë në jetën shoqërore të vendit. Kodi i ri përmbante thelbin e reformave në gjithë jetën e vendit. Në fushën e së drejtës, reforma largoi nga puna kadinjtë (gjyqtarët islamë), pasi formimi i tyre nuk i përgjigjej modelit të ri perëndimor të shtetit që po ndërtohej. Me reformën e re shuhet edhe shpresa e myfti Ismailit për të marrë ndonjë detyrë në administratën shtetërore. Ftohja e Ismailit me shtetin laik erdhi për shkak të vazhdimit të reformave në fushën e arsimit dhe vënien nën kontroll nga ana e shtetit e strukturave drejtuese të komunitetit mysliman. Megjithatë, sipas statusit

të 13 dhjetorit, bashkësive fetare u njihej personaliteti juridik, emërimi i myftiut të madh dhe katër myftinjve të rretheve kryesore Tiranë, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, të cilët zgjidheshin nga strukturat e komunitetit mysliman, bëhej nga mbreti. Kjo kishte të bënte me vendosjen e kontrollit të shtetit në formimin e hierarkisë së bashkësisë islame. Reforma në arsim, u pasua me mbylljen e 14 shkollave klerikale islame në të gjithë vendin. Ajo preku më shumë udhëheqësit shpirtërorë të bashkësisë islame, teologët e paangazhuar siç ishte edhe Ismaili. Në fakt, nga kryesia e komunitetit mysliman nuk pati ndonjë reagim kundërshtues ndaj reformave siç ndodhi me komunitet e tjera. Myfti Ismaili u distancua nga reformat, që preknin besimin islam. Ai i

denonconte ato edhe gjatë predikimeve e takimeve me besimtarët. Myfti Ismail Hasa humbi jetën tragjikisht, i vvarë në Tiranë, më 1934 në muajin e Ramazanit. Vrasësi dhe rrethanat e krimit nuk u zbuluan kurrë.

Pavarësisht nga vështirësitë dhe rrethanat e kohës, këta dy teologët mbetën të gjallë në shpirtin dhe zemrat e besimtarëve islamë, si dy pishtarë të mbrojtjes dhe përhapjes së fesë islame; si dy njerëz që jetën e tyre e vunë në shërbim të konsolidimit dhe përsosjes së strukturave institucionale të besimit që ata përfaqësonin.



Myfti Ismail Hasa

Fjalorth i termave me origjinë arabe e turke, që janë përdorur në këtë trajtesë.

imam: arab. - udhëheqës feje dhe faljeje.

muezin: arab. - personi që bën thirrjen për faljen e namazit dhe ndihmës i imamatit në kryerjen e riteve dhe mbajtjen e rregullit në xhami.

myfti: arab. - personi që kryeson punët fetare në juridiksionin e tij. Hierarku më i lartë në atë vend. Myftiu është kompetent për të bërë sqarime për të gjitha çështjet e Sheriatit islam.

kadi: arab. - gjyqtar

mollah: persisht. - mësues feje. Në fillim Mollah thirreshin dijetarët e lartë, më pas ky titull u zëvendësua me emërtimin Hoxhë (i ditur).

hafiz: arab. - personi që mëson Kuranin përmendësh.

shariat: arab - ligji Islam.

namaz: turq. - falje (adhurim)

mekteb: arab. - shkollë, vendi ku zhvillohet mësimi.

serasqer: turq. - komandant në repartet e ushtrisë.

taborr: turq. - batalion i përbërë nga katër kompani

asqer: turq. - ushtri.

shejhul islam: arab. - udhëheqësi shpirtëror numër një në epokën e kalifëve.

SHËNIME UDHËTIMI

NGA GADISHULLI BALLKANIK NË ATË SKANDINAV

(ME ANSAMBLIN “MATI”)

Artan KURTI



orkestrale, këngë matjane, të trevave fqinje dhe më gjerë. Udhëtimi panoramik buzë brigjeve dalmate solli dhe ndalesën e parë në Makarska, bregdet turistik kroat, ku na pret Luigji, shqiptar i Gjakovës, i cili punon e jeton në këtë qytet që nga 1973-i. Darkojmë së bashku me këngë. Nisemi në mëngjes herët duke shijuar bukuritë panoramike të bregdetit dalmat me shtëpitë dhe hotelet që zbresin shpateve shkëmborë deri buzë detit, ku gjatë sezonit të plazhit tejmbushen

djali i tij Ademi na presnin në hyrje të qytetit dhe na prijnë për tu sistemuar në hotel “Bijela Ru•a” (Trëndafili i Bardhë) e na njohin me qytetin dhe dyqanet e tyre, biznese këta që i ushtronin prej dhjetra vitesh në këtë vend. Familja e tyre kishte ndihmuar spitalin ushtarak me të holla, ushqime e automjete gjatë konfliktit me serbët në vitet ‘90. Mehmetali Zenuni, vëllai i Sahidit, përfaqësues i pakicës shqiptare në këshillin bashkiak, bashkë me ambasadorin e Shqipërisë



Vëlaka Gorica, Kroaci



Fillim marsi. Një grup i ansamblit “Mati” përgatitet për të dhënë koncerte për shikuesit shqiptarë e të huaj në Kroaci, Danimarkë e Suedi. Dhe unë si përfaqësues i revistës “emathia” i bashkangjitem grupit të folkloristëve për të publikuar më pas këtë turne që është ngjarje për jetën kulturore matjane. Mëngjesin e datës shtatë, lemë Burrelin dhe udhëtojmë me autobuz për të përshkuar për dhjetë ditë Ballkanin veri-perendimor, Europën qendrore, drejt gadishullit skandinav. Koordinatorin dhe sponsori i këtij udhëtimi, deputeti Qemal Minxhozi, është kujdesur që gjithçka të shkojë sa më mirë. Grupi me drejtues artistik Fatmir Lekën, koreograf drejtorin e qendrës kulturore, Sokol Metën ka në program valle, melodi

nga turistë të ardhur nga e gjithë bota. Udhëtojmë drejt Zagrebit nëpër rrugët e gjera, që herë përshkojnë lartësitë shkëmbore, herë shpojnë malet me tunele disa kilometrash dhe herë kalojnë me ura të larta mbi gjire e lumej. Në Zagreb mbërrimë pasdite, ku drejtohem për në Vëlaka Gorica, qendra e trevës së Turopoljes. Kjo trevë me njëqind mijë banorë është ndër vendet që ruajnë me fanatizëm folklorin dhe kulturën e tyre popullore. Qendra artistike e tyre frekuentohet nga banorë të shumtë dhe grupi artistik përbëhet nga rreth 300 vetë, të cilët në muajin gusht do të dërgojnë një përfaqësi në aktivitete folklorike që zhvillohen në Vlorë. Në Vëlaka Gorica takojmë përsëri vëllezër shqiptarë, këtë radhë të ardhur nga Tetova. Sahidi dhe

në Kroaci, Pëllumb Qazimin, janë organizatorët e përgatitjeve për koncertin e parë të turneut të ansamblit “Mati”. Kanë ardhur shqiptarë nga Zagrebi, që merren me art dhe fusha të tjera, të grupuar në Shoqatën Kulturore Shqiptare “Shkëndia”, Soreni dhe Xhina, danezi dhe amerikanja, të cilët do të mbeten gjatë në kujtesën e matjanëve për dasmën e tyre madhështore në Burrel, nënkryetari i bashkisë së Vëlaka Goricës dhe anëtar i parlamentit kroat Göran Baus me origjinë të hershme shqiptare etj. Koncertin e çelën këngët lirike matjane kënduar nga Jola Muça e Shkëlqim Farrici shoqëruar nga instrumentistët Xhavit Dishani, Hysni Beshku, Enver Kurti, Adriatik Alia, Artisti i Merituar Ymer Nelaj, nën

drejtimin e Fatmir Lekës. Më pas valltarët Sokol Meta, Irma Lami, Enxhi Driçi, Emiliano Lela, Algert Xhetani dhe Gerson Pasha do t'i shtonin emocionet dhe duartrokitjet e spektatorëve. Me artdashësit dhe folkloristët të Turopëljes festuam dhe kërcyem gjatë pas koncertit. Shkëmbyem dhurata me mikpritësit. Deputeti Minxhozi u dhuroi flamurin shqiptar të punuar me shtiza nga nënë Kija, e ëma e Sokolit, qeleshe matjane, numra të revistës “emathia”, fotomontazhin “Mati përballë historisë” të realizuar nga Rakip Lasku dhe Artan Kurti në DVD, të përkthyer në anglisht nga Loreta Abazi dhe raki të prodhuar nga “Vila Bruçi”, Burrel.

Të nesërmen në mëngjes përcillemi ngrohtësisht nga vëllezërit Zenuni dhe marrim rrugën drejt veriut të Ballkanit për të hyrë në zonën Shengen, Slloveni. Gjatë udhëtimit çelet biseda për paraqitjen e koncertit të mbrëmjes së kaluar. Diskutojmë për emocionet e

Kaselit dhe Nurembergut. Dita e nesërme, përsëri udhëtim. Rruga është e gjatë dhe e lodhshme, por nuk e vemë re nga shakatë e Hysniut dhe Shkëlqimit. Grupi përbëhet nga pjestarë që janë rritur bashkë në skenë. Ndalemi për të pushuar në Hanover ku na tërheq vëmendjen emri i Butrintit në tabelën e një agjencie turistike. Pronari i saj Beqiri, nga Kosova, kur u njoh me grupin dhe qëllimin e udhëtimit tonë gjatë qerasjes që na bëri në kafenenë ngjitur, pronë e tij, shprehu dëshirën që në të ardhmen të koordinonte shfaqje të folklorit matjan në Gjermani. Ndahemi vëllazërisht me Beqirin. Gjatë rrugës këndojmë në shoqërimin e Xhavitit, Hysniut, Verit dhe Tikut këngë të vjetra të repertorit matjan të krijuara nga S. Aliaj, Y. Nelaj etj. Udhëtimi vazhdon dhe për shumë kilometra duke kaluar pranë Hamburgut drejt kufirit verior të Gjermanisë në terminalin Burchardkai.

shumë të zhvilluar peshkimin. Janë shumë të lidhur me tokën, bujqësinë, në kultivimin e grurit, patates dhe panxharit. Në pemëtari shquhen për kultivimin e mollës dhe rrushit. Danezët i japin prioritet mbarështimit të derrit, nënproduktet e të cilit i eksportojnë në Amerikë, Japoni dhe Europë, ku tregu kryesor është Gjermania. Ata janë prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj në botë të produkteve dhe nënprodukteve blegtorale. Danimarka 80 % të energjisë elektrike e prodhon nga mullinjtë e erës. Danezët luajnë një rol të rëndësishëm në diplomacinë botërore. Shumë aktivë kanë qenë në Kosovë, Maqedoni etj. Vazhdimisht kanë komisionerë në Bashkimin Europian dhe OKB. Vlera më e shtrenjtë për danezët nuk është politika, por kultura. Këtu prodhohen talente me shumicë në gjini të ndryshme të artit. Ajo vizitohet nga pesë milion turistë në vit. Shteti këtu është tepër i fortë, sidomos për dy çështje: arsimin dhe shëndetësinë. Megjithëse kanë hyrë në



përjetuara nga duartrokitjet e spektatorëve dhe si të paraqitemi sa më mirë në koncertin e radhës në Danimarkë.

Pasi kalojmë Slloveninë, Austrinë hyjmë në shtetin tjetër të euro-zonës, Gjermani. Ara të pafundme të mbjella me grurë në të dy anët e rrugës. Mes tyre dallojmë herë vetëm e herë në grupe kaprollë, lepuj, shkurta, thëllëza e fazanë të cilët në Shqipëri janë drejt zhdukjes, nga shpirti “sportiv” i gjuetarëve tanë. Bashkudhëtarë me ne në këto vende do të bëhen dhe mullinjtë gjigandë të erës dhjetra metra të lartë, që janë një nga burimet kryesore për prodhimin e energjisë elektrike. Rruga e gjatë dhe e lodhshme për shoferin tonë, Asim Terziu, na bën të ndalemi për të kaluar natën në një nga hotelet e Northeimit qytet midis

Vazhdimisht na shoqëron një mot i ftohtë me reshje shiu.

Në Padborg prekim tokën daneze. Udhëtojmë drejt qytetit të Arhusit, ku na pret koncerti i radhës. Pas pishave që na shoqërojnë anës rrugës, tej në fushat e gjelbërta shfaqet ylberi. Danimarka, -na shpjegon zoti Qemal, - është mbretëria më e vjetër në Europë e themeluar nga vikingët në vitin 1050. Sot vazhdon të jetë monarki, ku mbretëresha është një person shumë i dashur, por dhe shumë formal, pasi ajo nuk ka kompetenca në vendimmarrje, por vetëm firmos vendimet që vijnë nga kryeministri dhe parlamenti. Danimarka ka një sipërfaqe prej 42 000 km² me rreth pesë milionë banorë. Ajo ka të zhvilluar industrinë e prodhimit të anijeve, pasi e ka traditë që nga koha e vikingëve dhe

BE ata përdorin si monedhë koronën dhe jo euron. Në Danimarkë janë liberalizuar drogat e lehta, megjithatë për shpërndarësit e drogave të forta ka dënime më të ashpra se për vrasje.

Mes arave dhe buzë pyjeve shfaqen vazhdimisht kapronjtë. Anës rrugës tabela e radhës shkruan Skanderborg-Kodra e Skanderit (?). Po në këtë zonë ndodhet pika më e lartë e Danimarkës. Megjithëse është vetëm 174 m mbi nivelin e detit, vendasit e quajnë “Maja Qiellore”. Afrohemi në qytetin e Arhusit. Drejtuesi artistik i grupit, Fatmiri, ka ndërtuar programin që do ta paraqesë Enxhi dhe e diskuton me Xhavitin, Sokolin dhe pjestarët e tjerë të grupit. Megjithëse shfaqja do të jepet për shikuesit e një qendre ku studjojnë të rinj të ardhur nga e gjithë bota, kanë ardhur dhe disa shqiptarë, nga Mitrovica, Prizreni dhe Mati që

banojnë një qind kilometra larg. Janë miq të zotit Minxhozi, qysh nga 2002, kohë kur ai hapi për herë të parë ambasadën shqiptare dhe ishte ambasador i Shqipërisë në Danimarkë deri në vitin 2005. Sistemohemi në një nga godinat e ngrohta të studentëve dhe darkojmë bashkë me 'ta. Koncerti u prit mjaft mirë nga shikuesit, të cilët kishin informacione të pakta për Shqipërinë dhe kjo shfaqje iu vlejti për të kuptuar se vinim nga një vend me shumë tradita kulturore. Ndahemi prej tyre dhe stafi i pedagogëve duke marrë opinionet më të mira. Drekojmë në Fredericia, qytet bregdetar dhe kalojmë në zonën e ishujve. Danimarka ka katërqind të tillë, ku dy qind prej tyre janë të banuar. Afrohemi në urën e varur 19 km të gjatë, që lidh brigjet e Nyborgut me Korsorin e më pas, ura tjetër, po aq e gjatë e shoqëruar dhe me tunel nënujor për të dalë në qytetin

nga Suhareka, gazetar i radios shtetërore suedeze, e cila jep programe dhe për emigrantët shqiptarë, interesohet për historikun e ansamblit "Mati" dhe interviston Ymerin, Fatmirin, Sokolin dhe Jolën. Me mikpritësit vazhduan festimet në një nga lokalet e Malmoes me kuzhinë turke.

Përsëri në udhëtime, përsëri në koncerte. Marrim rrugën drejt veriut për t'u ndalur në një qytet tjetër të Suedisë, Varnamo. Suedia ka një popullatë prej 9 000 000 banorësh dhe ndahet në 24 qarqe. Qarku ku përfshihet Varnamo ka sipërfaqe prej 29 000 km² qendër e këtij qarku është qyteti i Jorçepingut me 100 000 banorë. Koordinator i shfaqjes në Varnamo është Shpëtim Bushati, që jeton këtu prej 19 vitesh. Ai është mik i vjetër i zotit Qemal qysh nga fëmijëria, por dhe mik i shumë matjanëve pasi në fillim të viteve '80, kur Burreli ishte në kategori të parë ka luajtur portier me ekipin

Sinkronizimi i lëvizjeve të valltarëve tanë bëjnë që salla shpeshherë të shpërthejë me thirrjet: "Bravo". Si kudo, krahas vendasve ishin të pranishëm bashkatdhetarët tanë, të integruar në jetën suedeze, të cilët të entuziazmuar brohorisin pas çdo mbarim kënge apo valleje. Pas mbarimit të shfaqjes, ata, me zërin që u dridhej nga emocionet dhe sytë të përplotur falenderojnë artistët si përçues të folklorit të vërtetë shqiptar, pasi shpesh vijnë këngëtarë komercialë që këndojnë tallavà dhe motive të tjera të huazuara duke deformuar trashëgiminë tonë kulturore. Një nga shikuesit suedeze u shpreh për "Mat TV" dhe kamerën e Afrimi Vanit: "Ky ishte një koncert shumë i këndshëm dhe i suksesshëm. Vura re që ishte një muzikë profesioniste. Veshjet popullore ishin fantastike. Është gjë e mirë që ne shohim dhe kultura të tjera që vijnë nga popuj të ndryshëm të



suedeze të Malmoes duke prekur kështu gadishullin skandinav.

* * *

Ftuesit dhe mikpritësit e koncertit në Malmoe janë bashkëshortët Maksi dhe Rita, që drejojnë shoqatën "Tirana" me aktivitet në Suedi. Ata kanë mbledhur në një nga qendrat kulturore të Malmoes qindra suedeze e bashkatdhetarë me banim atje. Spektatorët brohorasin për zërin e ngrohtë e kumbues të Jolës, në këngën "Lule borë" shoqërojnë Shkëlqimin në këngën "Shqipëri, moj nana ime" dhe kërcëjnë bashkë me Sokolin i cili zbret me grupin e valleve mes rreshtave të spektatorëve në platë. Të rinj e të reja kërcëjnë, këndojnë, brohorasin, hypin në skenë e bëjnë foto me grupin, shkëmbejnë adresat për të mbajtur lidhje me artistët matjanë. Ramadani,

tonë, "31 Korrikun". Shpëtimi jep gjuhën shqipe dhe lëndën për integrim në një qendër shkollore me 1 400 nxënës. Ai gëzon simpatinë e banorëve dhe drejtuesve të qytetit. Mbështetës në promovimin e grupit tonë u bë dhe kryetari i këshillit bashkiak të qytetit zoti Kristesen, me profesion prift, i cili na afroji një sallë të bollshme dhe me një akustikë perfekte për shfaqjen tonë. Banorët e Varnamos janë protestantë dhe shumë të lidhur me kishën, ku kryejnë të gjitha aktivitetet kulturore. Dhe salla që na ofruan ishte një nga famullitë e shumta të kësaj zone. Jashtë nga dritaret shikojmë flokët e borës që fillojnë të zbardhin rrugët. Altoparlantët buçasin nga këngët, vallet dhe orkestralet e luajtura me mjeshtri nga folkloristët tanë. Duartrokkitje të vazhdueshme.

botës. Kam lexuar pak për historinë e Shqipërisë, por nuk kam dëgjuar shumë për muzikën dhe kulturën shqiptare". Kristesen, kryetari i këshillit bashkiak, pas koncertit shtroi një darkë për ne dhe na shoqëroi për të vizituar mjediset e këshillit bashkiak të qytetit të Varnamos. Duke na falenderuar për shfaqjen na bëri një panoramë historike, ekonomike e kulturore të komunitetit të Varnamos. Kjo bashki, duke marrë qytetin dhe fshatrat përreth, ka afërsisht 33 000 banorë. Është interesante të jetosh në këtë zonë, ku është shpirti i solidaritetit dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Zhvillimi ekonomik filloi të marrë hov në vitet 1800. Gjatë kohës kur ishte lufta me Napoleonin, këtu erdhi një grua nga Hamburgu i Gjermanisë, që quhej Emili dhe bashkë me të shoqin

blenë një çiflig. Në atë kohë ishte një varfëri e tejskajshme. Pjesa më e madhe e popullsisë ishin të alkoolizuar, sepse varfëria stimulon dhe alkoolizimin e njerëzve. Kur ajo e pa këtë gjendje, mbledhi gratë e zonës, krijoi një grup shoqatash që filluan të bëjnë punë dore artizanale me tezgjah, duke thurur triko etj. Prodhimet që dilnin nga duart e këtyre grave, Emili filloi t'i shiste në oborin mbretëror në Suedi dhe Angli. Me paratë e fituara mbledhi fëmijë dhe filloi arsimimin e tyre duke iu mësuar dhe profesione të ndryshme. Njerëzit iu kthyen punës, jeta filloi të ndryshojë, vendi të zhvillohej. Pikërisht te kjo lëvizje e ka fillimin shpirti industrial dhe i tregëtisë në zonën e Varnamos. Sot bashkia e Varnamos mbështetet në të ardhurat e veta pa marrë fonde nga pushteti qendror, pra funksionon autonomia lokale, ku të gjitha paratë e mbledhura nga taksapaguesit shpenzohen për investime dhe paga për buxhetorët.

për të gjithë ne që kemi ardhur sonte këtu, duke parë vendin tuaj kuptojmë se kërkohet shumë punë, djersë dhe sakrifica për të arritur atje.

Bëjmë fotografi së bashku në mjediset e bashkisë dhe largohemi me mbresat më të mira për mikpritjen drejt hotelit, i cili është pronë e futbollistit të njohur suedez ndër vite Johans Valderen. Ky hotel ndodhet në periferi, pikërisht në ish-çifligun e Emilisë, gruas gjermane që u ktheu shpresën për zhvillim dhe jetë më të mirë suedezëve. Bora ka zbardhur gjithçka përreth. Asimi e nget ngadalë autobuzin. Nga dritaret shikojmë bukuritë e ndërtimeve të shtëpive që ndriçohen nga dritat e ballkoneve dhe lulishteve të rrethuara me gjelbërim dhe gardhe të drunjtë.

* * *

Mëngjes. Data 13 mars. Lemë hotelin dhe nisemi drejt jugut. Përsëri për në Danimarkë. Këtë herë në kryeqytetin e saj Kopenhagen. Pas disa orë

ndalet në molin e Helsingerit dhe autobuzi ynë merr drejtimin nga kështjella. Zoti Qemal na shpjegon për rëndësinë që ka pasur kjo kështjellë në kohën e lulëzimit të mbretërisë daneze: Fortifikime, ndërtime dhe rindertime të herë pas herë shpesh datojnë vite të ndryshëm, topa që ende qëndrojnë me gryka nga deti si atëherë për të ndëshkuar anijet që nuk paguanin taksën e kalimit. Largësia e bregut suedez është vetëm 7 kilometra nga kështjella, megjithatë mbreti i Danimarkës në sajë të luftëtarëve trima e ruajti për shumë vite kontrollin mbi ngushticën detare. Për t'i stimuluar, ushtarët shpërbleheshin me pesë litra birrë në ditë, duke parë heroizmin ua shtuan këtë shpërblim në tetë litra birrë në ditë. Nga moti shumë i ftohtë dhe alkooli i tepërt, suedezët erdhën dhe i gjetën të dehur e në gjumë ushtarët danezë duke shkatërruar përfundimisht monopolin danez mbi kontrollin e ngushticës. Kjo kështjellë



Malmoe, Suedi



Suedia ka të zhvilluar industrinë plastike dhe mban rekorde për shpikje dhe prodhime patentash. Suedezi Alfred Nobel me shpikjen e tritolit bëri revolucion në shkencë dhe teknikë. Sot për nder të tij jepen çmime botërore për arritje në shkencë, kulturë etj. Po kështu shpikësi i të ashtuquajturit "çelës anglez" është suedez, shpikësi i zinxhirit që përdoret te veshmbathjet është shpikur po nga një suedez etj. Ekonominë e Suedisë e ndihmoi shumë dhe mosangazhimi dhe mosdëmtimi nga lufta e dytë botërore. Në emër të grupit zoti Qemal e uroi për mikpritjen duke i përcjellë konsiderata të mira për natyrën e ruajtur ndër breza dhe shpirtin e bashkëpunimit për të punuar dhe qeverisur. Në Shqipëri, -tha ai, -mendojmë shumë për tu integruar në Bashkimin Europian, por

udhëtimi i afrohemi ngushticës detare që lidh qytetin suedez Helsinborg me atë danez, Helsinger. Kjo ngushticë, -na shpjegon zoti Qemal, -deri në vitin 1870 kontrollohej nga mbreti i Danimarkës. Çdo anije që kalonte duhej të paguante një taksë sa vlera e një lope. Kështu, 75 % e buxhetit të mbretërisë daneze sigurohej nga të ardhurat e mbledhura nga anijet që kalonin aty. Për vite me radhë janë bërë luftime midis suedezëve për të pasur influencë mbi ngushticën dhe danezëve për ta ruajtur monopolin mbi të. Tragetit i afrohet brigjeve daneze. Fillojnë të duken qartë bedenat dhe kullat e kështjellës Kronborg të princit Amleth, e identifikuar sot, si kështjella e Hamletit, në bazë të tragjedisë të shkruar nga Shekspiri i madh. Tragetit

vizitohet nga mbi dy milionë turistë në vit. Oborri i brendshëm ka një akustikë perfekte, këtu çdo vit vihet në skenë tragjedia e Hamletit luajtur nga trupat më të mira botërore.

Dalim nga kështjella e Hamletit dhe nisemi drejt Birkerodit, ku na pret Anders Kloppenborg i cili e ka vizituar Shqipërinë qysh në vitet '70. Ai është dhe krushk Shqipërie, sepse djali i tij është martuar me një vajzë nga Skrapari. Andersi është rektor në një kompleks shkollor me 1 800 nxënës. Shfaqjen e japim në qendrën sportive të shkollës para katërqind nxënësve dhe mësuesve. Muzika popullore elektrizon të rinjtë të cilët shoqërojnë me duartrokkitje Jolën dhe Shkëlqimin në këngën "Kur jemi bashkë të dy", vallen ritmike me motive nga jugu të

prirë nga Sokoli, "Orkestralen e madhe" sidomos solon e Verit me daulle, këngën përmetare "A kanë ujë ato burime" kënduar nga kompleksi i burrave. Shumë mbresëlënëse vallja matjane, ku Irma dhe Enxhi peshojnë mbi njëren këmbë duke u shtyrë herë me gishtërinj e herë me thembër, përkulur lehtë trupin dhe kokën anash me lëvizjet e lehta përcjellin magjinë e valles. Disa të rinj futen në vallen finale të brezave dhe përpiqen të imitojnë lëvizjen e valltarëve tanë duke u hedhur e rrotulluar bashkë me Gertin, Milin, Irmën, Enxhin e Gesin. Artistët tanë marrin falenderimet më të mira për emocionet që përçuan te të rinjtë, nga stafi pedagogjik kryesuar nga rektori, Andersi. Largohemi për të vajtur në Kopenhagen. Zoti Qemal na njeh me pikat turistike të këtij qyteti me rreth 1 000 000 banorë. Në gjirin e quajtur "Porti i peshkatarit" buzë bregut shohim skulpturën Langeline, vajzës që u bë sirenë. Kjo figurë, përjetësuar mrekullisht nga përrallëtari i mrekullueshëm, Andersen, është kthyer në simbol të Kopenhagenit, por dhe prë e dhunuesve. Tri herë i është vjedhur koka. Herën e fundit vetëm para pak vitesh. Duke qenë se danezët u mërzhitën shumë për dhunimin e simbolit të tyre, hajduti u prek nga kjo vuajtje ndaj pranoi ta kthejë atë. Tek sa bëjmë foto pranë Langeline, vjen të na takojë ambasadoria e Shqipërisë në Danimarkë Afërdita Dalla. Ajo na përshëndet dhe na takon me radhë. Me shumë prej nesh njihet prej vitesh pasi Afërdita është rritur dhe shkolluar në Burrel. Shëtisim nëpër rrugët e Kopenhagenit, vizitojmë pallatin mbretëror, qendrën e madhe tregtare, rrugët me ndërtesat qindra vjeçare e më pas i drejtohemi sallës, ku do të mbahet koncerti. Nisatorët dhe mikpritësit e kësaj radhe janë anëtarët e shoqatës së miqësisë Danimarkë-Shqipëri të kryesuar nga Lis Jesterson ish-funksionare e lartë e ministrisë së jashtme daneze, e cila ka dalë të na presë me flamurin shqiptar në duar. Është koncerti i fundit i këtij turneu. Pasi bëjnë prova për t'u përshatur me skenën, Fatmiri, mbledh grupin dhe ju kërkon të mobilizohen e të paraqiten sa më mirë për ta mbyllur me sukses këtë turnë. Salla është mbushur, përveç shikuesve shqiptarë e vendas dhe me diplomatë e miq të tjerë danezë. Takimi hapet me përshëndetjen e mirëseardhjes nga shoqata "Miqësia Danimarkë-Shqipëri". Ka ardhur për ta

përshëndetur këtë shfaqje në cilësinë e përfaqësueses së Shqipërisë dhe ambasadoria Afërdita Dalla e cila theksoi se e ndjente veten si pjesë e grupit pasi një pjesë të mirë të jetës e ka kaluar midis katyre njerëzve, ka qenë bashkëqytetare me ne. Artistët më me përvojë të këtij grupi, -tha ajo, -unë i njoh si qytetarë të ndershëm dhe si artistë të mirë. Le ti ndjekim në performancën e tyre dhe më besoni se ata janë vërtet virtuozë.

Grupi shpalos vlerat më të mira profesionale. Shkëlqimi shpërthen në këngët patriotike e Jola në potpurinë matjane. Më pas po ky duet duartrokitet gjatë te Pas mungesës në dy koncerte të Ymerit, për arsye shëndetësore, ai don ta mbyllë me "lavdi" këtë turnë ndaj vesh kostumin kombëtar dhe me virtuozytë që e ka karakterizuar ndër vite mahnit të pranishmit duke interpretuar me fyell, kavall e bilbil, duke u bërë pjesë e orkestrës bashkë me virtuozyt e saj Fatmirin, Verin, Xhavitin, Hysniun dhe Adriatikun. Valltarët të nxitur nga daullja e Verit, herë fluturojnë te vallja e Katjushës e herë rëndë-rëndë, dyshe-dyshe, mbështetur te njëri-tjetri rrotullohen e prekin tokën te vallja e brezave duke u sinkronizuar më së miri. Më tipiket Irma dhe Enxhi me lëvizjet e lehta bëjnë që vazhdimisht të duartrokitet vallja me motive matjane. Ansambli "Mati" u prezantua shumë mirë dhe në rritje nga koncerti në koncert duke shpalosur vlerat folklorike të trevës së Matit të gërshtuara me këngë e valle të Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Vlerësimet ishin më të mirat nga të pranishmit, sidomos nga vendasit, nxënësit, studentët, pedagogët dhe diplomatët e huaj. Nga bashkëatdhetarët vazhdimisht ndaheshim me urimin: "*Faleminderit! Na sollët atdheun, Shqipërinë dhe Kosovën! Jeni të mrekullueshëm! Ju ruani traditën e vërtetë shqiptare!*" Meritë e suksesit ishin interpretimet e mrekullueshme të Jola Muçës dhe Shkëlqim Farricit, orkestrës me instrumenta folklorikë, ku spikatën çiftelitë e Xhavit Dishanit dhe Hysni Beshkut, fyelli dhe kavalli i Artistit të Merituar Ymer Nelaj, daullja dhe dajreja e Enver Kurtit, bilbili dhe klarineta e Adriatik Alisë dhe fizarmonika e Fatmir Lekës. Grupi i valles me kostumet e larmishme, nën drejtimin e Sokol Metës, me kërcimtarët Gerti Xhetani, Emiliano Lela, Irma

Lami, Enxhi Driçi e Gesi Pasha, jo vetëm performuan traditën, por dhe argëtuuan të rinjtë vendas e shqiptarë duke vallëzuar bashkë me ta.

* * *

Pasditën e datës 15 mars kthehemi në Kroaci. Një defekt në dinamion e autobuzit të Asimit na bën të pamundur vazhdimin e rrugës dhe ndalemi për ta riparuar. Në ndihmë na vijnë Soreni, diplomati danez, atashë ushtarak për vendet e ish-jugosllavisë me seli në Zagreb dhe bashkëshortja e tij Xhina. Pas riparimit darkojmë me Sorenin në një restorant me gatime të traditës kroate dhe i drejtohemi shtëpisë së tij në priferi të Zagrebit, buzë një pylli me pemë të larta. Në krye të shkallëve ka dalë Xhina, e cila përshëndetet me të gjithë dhe na uron mirëseardhjen. Ajo njihet nga afër me shumë pjestarë të grupit, pjesëmarrës në dasmën e saj në lokal "Tarzani" në qytetin e Burrelit. Shtëpia e madhe u kthye në strehë e grupit prej nëntëmbëdhjetë vetësh. Kudo ka hapur divanet, krevatë portativë, dyshekë kampingjesh dhe shtroje të ndryshme, peshqirë e ujë të ngrohtë për të gjithë.

* * *

Duke kaluar nga shteti në shtet për dhjetë ditë, ansambli dha shumë shfaqje që argëtoi spektatorët, por dhe vetë artistët u argëtuuan duke i shëtitur këto vende me autobus dhe duke u ndalur në vende historike e piktoreske, që do të mbeten gjatë në kujtesën e tyre.

Ruga e kthimit drejt atdheut kalon nëpër të njëjtat shtete. As lodhja nga ruga e gjatë nuk e zbehu humorin "folklorik" të Hysniut. Gjatë udhëtimeve, duke kënduar herë pas here nën shoqërimin e Xhavitit, Verit dhe Tikut, zbulojmë dhe një pasion tjetër te deputeti ynë, Qemali. Ai di t'i këndojë shumë ëmbël serenatat korçare, këngë të vjetra të muzikës së lehtë dhe nga folklori i veriut. Krahës këngës, çelen debate se si mund të gjallërohet më tej jeta artistike në Mat dhe si mund të afrohen donatorë për ta mbështetur artin dhe folklorin, që në takimet e ardhshme nga ftesat që ka, grupi të jetë dhe më i plotë dhe vlerat e pa shtershme të artit tonë folklorik të shpalosen më tej nëpër botë.

SKËNDER FRASHËRI,

themeluesi i këngës së krijuar në Mat

Esat RUKA

Kanë mbetur pak njerëz në Burrel që e kanë njohur. Po kaq të pakët janë edhe ata që i kanë dëgjuar emrin. As shkruesi i këtyre radhëve nuk e ka takuar kurrë dhe as e ka njohur.

Kam patur fatin dhe nderin të jem i pari artist matjan, që kam shkruar në kopertinën e një albumi muzikor, emrin e tij si krijues i njërës nga këngët e interpretuara nga ana ime. Në fakt prej 60 vjetësh këndohen këngët e krijuara prej tij, nga këngëtarë matjanë e matjane dhe interpretues të tjerë në Radio Tiranë. Atëherë nuk di, i përmendej emri si krijues? Por një gjë është krejt e sigurtë: hitet e para të kënduara në vitet '50 - '60, të vlerësuara me çmime, ishin këngët e krijuara nga Skënder Frashëri.

CIKLA BIOGRAFIE

E përcaktova kështu, pasi origjina dhe kontributi i tij, do të nderonin një pendë të artë për të përshkruar dhe plotësuar një monografi të veçantë në llojin e vet. Skënder Frashëri është pinjoll i një familjeje të madhe me origjinë nga Frashëri i Përmetit. I lindur në Stamboll, në vitin 1901, bir i dr. Rifat Frashërit dhe me nënë stambolleshë nga Bërzështa e Librazhdit, ka mbaruar liceun frëng të Stambollit për piano. I ati, Rifati, ishte profesor në Universitetin e Stambollit dhe kryetar i lëvizjes së shqiptarëve të quajtur Shoqëria "Bashkimi" deri në vitin 1913. Pas këtij viti, për ndjenjat dhe aktivitetin e tij patriotik, internohet në Siri. Me mbarimin e luftës së parë botërore, lirohet nga internimi dhe kthehet në atdhe me banim në Tiranë. Në kohën e qeverisë së Fan Nolit emërohet menjëherë drejtor i Përgjithshëm i Shëndetësisë, duke themeluar kështu të parin institucion të këtij profili në Shqipëri. Rifat Frashëri vdes në vitin 1934 dhe varroset me nderime nga shteti i atëhershëm. Sot njihet si patriot i Rilindjes Kombëtare.

Skënder Frashëri ka punuar sekretar në Ministrinë e Jashtme dhe më vonë duke dhënë mësimet e frëngjishtes, muzikës dhe si përkthyes në legatën turke



deri në kohën e pushtimit fashist. Për ndjenjat e tij atdhetare dhe veprimtarinë e tij antifashiste, burgoset në Tiranë dhe më pas internohet në kampin e Kolfioritos e më vonë në Sienë, ku ka qëndruar 3 vjet. Edhe pas ardhjes në Tiranë ndiqet familjarisht dhe futet disa herë në burg në Tiranë e Vlorë. Vëllai i tij, Vedat Frashëri vritet nga fashistët në mars të vitit 1943, duke u rreshtuar në radhët e dëshmorëve të LANÇ-it. Pas çlirimit, Skënder Frashëri punon si përkthyes e mësimdhënës i frëngjishtes në ambasadën sovjetike në Tiranë deri në vitin 1951. Arrestohet për ngjarjet e ambasadës në atë vit, por merr pafajësinë nga gjyqi ushtarak dhe emërohet nga Bashkimet Profesionale në qarkun e Tiranës, si instruktor muzike. Atë vit, sipas kujtimeve të tij, merr një çmim të parë në një festival artistik kombëtar. Në vitin 1954 arrestohet përsëri dhe internohet deri në vitin 1956, pa iu treguar arsyeja. Ai kishte fëmijë të xhaxhait, Servetit, Naim Frashërin-artist, Safo dhe Mediha Frashërin nëpunëse të asaj periudhe.

VEPRIMTARIA KRIJUESE

Në vitet 1952-1959, me krijimet e tij muzikore vlerësohet me çmime, si dhe regjistron në Radio Tirana disa këngë.

Në vitin 1957 dërgohet me punë në Peshkopi, pranë Shtëpisë së Kulturës, ku çmohet puna e tij krijuese e përkushtuar. Në qershor të vitit 1959 transferohet në Burrel, i emëruar drejtues muzike pranë Shtëpisë së Kulturës dhe mësues i muzikës në ish-shkollën 11-vjeçare të qytetit. Gjatë punës artistike, siç dhe shkruan në arkivin e tij, së bashku me kolektivin që drejtonte artistikisht, ngrejnë grupet e estradave duke shkruar për 'to të gjitha materialet muzikore.

Ardhja në një qytet të ri e një kuadri pasionant dhe të talentuar, në një periudhë ku trashëgimia autoktone artistike ishte krejt e virgjër dhe e panjohur, kishte të mirat, por dhe pengesat e veta specifike. Vetë kompozitori tregon, se "...fillimet ishin shumë ➡

← të vështira. Për shkak të fanatizmit, të rejat dhe gratë nuk pranonin të këndonin përpara meje. Burrat këndonin vetëm këngë trimërie. Mu desh të bëja rrugë të gjata në këmbë për të ndjekur dasmat dhe ceremonitë e ndryshme popullore në fshatra. Frutet e punës sime filluan pas një viti, kur edhe me ndihmën e arsimtarëve u bëra si njeri i brendshëm në shumë familje. Gratë e vajzat u lejuan të këndojnë para meje. Deri na atë kohë Radio Tirana transmetonte nga folklori i Matit vetëm “Valle e Burrelit numër 1 dhe 2”.

Skënder Frashëri, tashmë me përvojën e fituar dhe përgatitjen profesionale, ishte i pari që ngrii siparin e prezantimit të këngëve popullore qytetare matjane. Ai shprehej se, ishte me fat, që ndeshej me një begati e larmi të rrallë lirikash dhe ritmesh popullore dhe që rrethohej nga dashamirës të shumtë të artit, zëra të bukur e origjinalë. Brenda vitit ngrii grupin e estradës amatore me këngë, valle, kuplete e skeçe, grupin e burrave dhe të solistëve, si dhe një orkestër modeste. Në një letër që i dërgon Institutit të Folklorit më 7 qershor 1962, deklaroi bilancin e punës së tij trevjeçare, ku kishte mbledhur 125 këngë, (tekste e melodi), 42 valle popullore matjane. Tridhjetë e dy këngë prej këtyre i kam inçizuar në Radio Tirana me këngëtarë e këngëtare matjane. Këngët që transmetohen, thuhetse çdo ditë për dëgjuesit me kërkesa ishin:



“Ç’farë të donte shtati moj Fate”, “Shtati jot i hollë si kurpna”, “Do të marr mori bardhoshe”, “Lefi qeni, krisi gardhi”, “Fërfëlloj fëllanxa n’ujë”, “Hiq jelekun, qenke djers, moj tranafille”, “Sa gjethe që ka plepi”, “Lujë mori, lujë”, “Paske syn oj cucë, porsi rrush i zi”, “Trandafili me gjashtë rrema”, “Qan një lule n’at rraz’ shkambi”, “O florini i vogël-o”, “A e mban mend moj e vogël-o”, “Kur dole në lëmë”, “Rrushi i kuq i bukur-o”, “Tanë malësore”, “Hypi djali n’mollë”, “Të kërkova lis më lis”, “Cucë e bukur moj matjane”, “Skuadërkomandantes”, “Më ka zanë maraku me një cucë matjane” etj.

Arti rrezellon dhe rezonon në mënyrë specifike. Krenaria me vlerat e vokacionit të shprehur nëpërmjet artit, gjithmonë ndahet me autorët krijues. Në fakt këtë, në mënyrë të hapur, e bëjnë vetëm ato që fisnikërohen nga arti. Dhe nuk ka munguar dhe të matjanët kjo fisnikëri. Rasti me kompozitorin e tyre, që për herë të parë hodhi në pentagram visaret e artit muzikor të Matit, flet shumë dhe qartë. Është fat që ende ruhen letërkëmbime në dorëshkrime midis këtij kompozitori dhe disa kuadrove të asaj periudhe.

VLERËSIME MIQSH

Terzi DUNGU, që aso kohe ishte mësues në Peshkopi, në letrën e tij që mban datën 05. 03. 1962, e falenderon nga zemra për punën e shkëlqyer në nxjerrjen në pah të vlerave të folklorit të Matit dhe jehonën e tyre në shkallë Republike. “Ju lutem →


← të falenderoni nga ana e jeme edhe solistët e solistet, Feriden me shoqe, që kaq bukur po i këndojnë ato knëgë, pa harru edhe orkestrën. Kam besim se ju jeni i palodhun për ta vazhdue punën edhe në zona të tjera të Matit, se kjo për juve ka për të mbetun një meritë e çmueshme dhe e pashlyeshme...”

Dali TERZIU, të cilin e kishte bashkëpunëtor në krijime letrare, në letrën e tij të datës 29. 05. 1962, me një vlerësim të lartë dhe admirim të thellë “si një njeri i shtrenjtë dhe zbulues i ndërgjegjshëm për krenarinë e maleve të vendit tim” i kërkon të vazhdojë punën dhe midis të tjerash i shkruan: “...njeriu i ndërgjegjshëm, me sedër e pa interes, e ka për detyrë të punojë për të ndihmue atë që asht’ një hap ma mbrapa... kjo tregon pjekurinë e kulturës njerëzore” Ai falenderon me përlulesi këngëtarin e mirënjohur, “vajtimtaren e trimave” Fitnete Rexhën, që nuk përtoi për t’i shtue krenarisë së rrethit tim, së bashku me ty i dashur kompozitor, një kangë të vjetër me një dëshmi të gjallë. Edhe sot, pas 106 vjetësh, në gjermadhat e këshillasë së Gjalishit, sheh ferrat që donte të vadiste turku me gjakun e trimave të maleve tona... Me zanin dhe melodinë tuaj, po i kujtoni brezit të ri se sa e çmonin baballarët tonë lirinë. Ju i dhatë matjanit të drejtën të mburret me krenarinë e vet. Për këtë, ju falenderoj me sinqeritetin ma të madh dhe njëkohësisht, na kemi deyrë t’ju themi miq të paharruar. Te ne njerëzit jabanxhi janë largue me moton “syte që nuk shohin, harrojnë”, por ju po tregoni se dhe larg nesh, po vueni dhe sakrifikoni për ne...”

Qamil ÇUPI, që në atë kohë ishte financier i zyrës së arsim-kulturës dhe anëtar i estradës së rrethit, i kërkon profesorit të nderuar, të mos i humbë lidhjet me Matin dhe të ndërhyjë për gjetjen e ndonjë instrumentisti, pasi Burreli ka nevojë për artistë. Ai i kujton se: “...në Mat nuk të ftojnë shumë, por kur na vjen miku i mirë, e presim me shumë bujari e dashuri. Sa herë dëgjojmë këngët tona në radio, ju kujtojmë dhe njerëzit pyesin dhe flasin me simpati për punën e mirë që bëtë...”

Muziktarin Ymer NELAJ është dëshmitari skenik i tij, i cili flet për të me adhurim, sa e krahason Skënderin për muzikën e Matit, si ai që shpiku për herë të parë zjarrin për njerëzimin. “Profesori mbante gjithmonë me vete fletore muzike dhe një lapës. Nuk kishte nevojë për gomë, pasi i hidhte në notë këngët shumë shpejt dhe pa gabime”.

Për krijimin dhe orkestrimin e këngëve, ai përdorte një fizarmonikë. Nga që ishte i sëmurë dhe i lodhur nga jeta, nuk e vinte në krah, por në prehrin e Y. Nelit dhe e përdorte si piano. Ymeri, si një bartës i shkëlqyer i motiveve të folklorit të zonës së Prellit, ishte



njëkohësisht furnizuesi me bulëza muzikore për muzikantin Frashëri. Aftësitë krijuese të Skënderit e shndërruan folklorin burimor matjan në krijime me vlerë të spikatur duke u bërë pjesë e transmetimeve të përditëshme të Radio Tiranës. Mbështetja në motivet e mrekullueshme të këngëve të dasmës matjane, meloritmika e pasur dhe e pastër, harmonia e thjeshtë e përdorur prej tij, shoqërimi me një formacion të vogël orkestral, dhe në mënyrë të veçantë vokali brilant i këngëtareve Feride Kurti, Vera Kurti, Selvie Lena, Hysni Hysneli etj, e prezantuan këngën matjane në skenën shqiptare si pjesë e qytetarisë që ajo meritonte.

* * *

Historia e zhvillimit njerëzor është dokumentuar nga njerëz me dhunti, dashuri dhe seriozitet të veçantë. Në këtë dokumentim dhe rritje të shpejtë progresive kanë kontribut specifik dhe krijues të artit. Nëpërmjet artit, dëshmi të tyre të zbuluara, janë nisur shumë studjues, zbulues, historianë, antropologë, arkeologë, gjuhëtarë, etnomuzikologë etj, për të përcaktuar origjinën e përkatësi, vlerën të vërtetë të universale. Ky universalizëm i përfshin të gjithë: subjekte si prodhues të artit dhe përthithës të vetëndryshohen prej tij. Respekt dhe mirënjohje për intelektualë të tillë! Nuk ka dyshim se e ardhmja jo e largët do të kërkojë një studim të kujdesshëm e të thelluar, jo vetëm në aspektin e folklorit muzikor, por në rrafshin e gjithë etnokulturës së kësaj treve. Ka shumë elementë qytetarie, të dallueshëm nga trevat e tjera të zonës veriore e verilindore. Pasuria e gjuhës e përdorur me disa nëndialekte dhe veçori e aftësisë së ndryshimit të dialektit më me lehtësi se trevat e tjera rrethuese, përbën një aspekt të rëndësishëm. Kështu, mund të flitet dhe për elementë të tjerë në veshje, jetesë etj. Vëzhgime e studime të tilla, mendoj, se mund të çojnë në përcaktime më të sakta e më specifike etnokulturore.

VIT I SUKSESSHËM PËR ARTIN MATJAN TË TRADITËS

Sokol META

Për Qendrën Kulturore Burrel dhe ansamblin “Mati” viti 2008 ishte i suksesshëm. Themi kështu, pasi qendra jonë këtë vit ka marrë pjesë në të gjitha festivalet folklorike të organizuara në Shqipëri, si dhe është përfaqësuar me dinjitet jashtë saj.

E kemi nisur vitin 2008 me pjesëmarrjen e dytë në “Festivalin e Këngës Popullore Qytetare”, organizuar në qytetin e Kavajës. Në përbërje të grupit ishin orkestra e lehtë prej gjashtë personash dhe tre këngëtarë. Në këtë aktivitet u pëlqye loja e mirë e orkestrës sonë, si dhe u vlerësua me diplomë këngëtarja më e re e festivalit, Jola Muça.

Vetëm pak javë pas kësaj pjesëmarrjeje, grupi i valleve dyshe të burrave udhëtoi drejt qytetit të Lushnjes për të marrë pjesë për herë të tretë në festivalin burimor të valleve popullore. Dhe në këtë festival angazhimi ynë ishte maksimal, me gjashtë valltarë për interpretimin e valles së brezave, nën

Në datat 9-10 tetor të këtij viti në qytetin tonë u hap për herë të parë një festival folklorik. Ky festival u organizua për rivitalizimin e këngëve të bukura lirike të të gjitha trevave shqiptare që e interpretojnë këtë zhanër muzikor. Për pjesëmarrjen në këtë festival falenderojmë të gjitha grupet artistike të rretheve e bashkive Dibër, Bulqizë, Kurbin, Lezhë, Mirditë e Mat, si dhe Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshillin e Qarkut Dibër, Bashkinë Burrel, Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike dhe drejtorin e saj, z. Esat Ruka, për organizimin me sukses të këtij festivali. Qendra Kulturore e Burrelit ishte jo vetëm mikpritëse, por dhe partnere në organizimin e këtij aktiviteti të shumëpritur nga artdashësit matjanë. Shpresojmë që me mirëkuptimin e donatorëve dhe të qeverisjes vendore, ky festival do të mbledhë herë të tjera përfaqësime më të shumta në skenën e Burrelit. Në këtë festival juria, e përbërë



“Sharri këndon, 2008” Tetovë

Kryetarët S. Lleshi dhe A. Lika

shoqërimin e lodrës dhe ciganës. Gërshetimi i mirë i brezit të ri me atë të moshuar në ekzekutimin e valles së brezave u duartrokoi nga spektatori. Juria e këtij festivali vlerësoi me çmimin më të mirë vallen dyshe të burrave, interpretuar nga valltarët Ramazan Tefa dhe Sadik Gaçi. Në fillim të muajit qershor përsëri kjo dyshe burrash, së bashku me instrumentistët Enver Kurti dhe Rustem Muça, morën pjesë si grup përshëndetës në festivalin folklorik “Sofra Dardane”, organizuar në Tropojë. Po në këtë muaj, në qytetin e Lezhës, u organizua “Festivali Kombëtar Folklorik i Instrumentave Popullore”. Orkestrina matjane u paraqit me melodi baritore, luajtur nga Artisti i Merituar Ymer Nelaj dhe melodi orkestrale shoqëruar nga orkestrina. Juria vlerësoi me çmim të parë orkestrinën popullore matjane dhe me çmimin “Ndue Shyti” Artistin e Merituar, Ymer Nelaj.

Në korrik i erdhi radha festës së 31 Korrikut, të cilën qendra jonë e organizon çdo vit. Në mënyrë konceptuale jemi munduar ta kthejmë në një Fest-Folk, ku përveç ansamblit tonë, që mban peshën kryesore të këtij evenimenti, ftojme një ansambël nga Shqipëria dhe një nga viset etnike, ku jetojnë shqiptarë. Këtë vit patëm të ftuar ansamblin e valleve të Librazhdit, nën drejtimin e “Mjeshtrit të Madh të Punës”, koreografit, Sadi Halili, si dhe trion e këngëtarëve popullore të Shoqërisë kulturore “Këngët e Sharrit” nga Tetova.

nga muzikologë e etnomuzikologë, vlerësoi me çmim të parë grupin artistik të qendrës kulturore Burrel. Organizatorët e këtij festivali shpërndanë disa mirënjohje për artistët. U vlerësua bartësi i folklorit matjan Sabri Alia, kompozitori Munir Shehu, instrumentistët e laurisë Hajrulla Ceni e Qamil Beshku si dhe orkestrina popullore matjane. Ditët e para të tetorit Orkestrina Popullore Matjane festoi 40-vjetorin e krijimit të saj. Përveç tryezës jubilarë me kumtesa e konsiderata nga studjues dhe etnomuzikologë, u organizua një fotoekspozitë, u shfaq një dokumentar televiziv me skenar të z. Esat Ruka, prodhuar nga TVSH-ja. Për spektatorin matjan orkestrina luajti numrat më të zgjedhur ndër vite.

Në fund të muajit nëntor kjo orkestrinë, së bashku me dy këngëtarë, mori pjesë në festivalin “Oda Dibrane”. Edhe këtu u vlerësua me çmim të parë për interpretim me nivel të këngës popullore matjane nga këngëtari Shkëlqim Farrici. Në javën e tretë të dhjetorit 2008, nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike u organizua Festivali Folklorik, Tipologjik i Iso-polifonisë në Berat, ku orkestrina jonë ishte e ftuar për të pershendetur me disa numra artistikë. Të nesërmen një pjesë e ansamblit “Mati” rrugëtoi drejt Maqedonisë, në qytetin e Tetovës, për të marrë pjesë për herë të dytë në festivalin



ARTISTËT E VEGJËL I KËNDOJNË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Shemsi SULAJ

Pas shumë sukseseve artistike në skena festivalesh kombëtare, mbarëkombëtare e ndërkombëtare, artistët e vegjël matjanë ishin në 1-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, ftuar nga komuna e Lipjanit. Ftesa lidhej me festivalin e instrumentistëve të vegjël, organizuar në Fushë-Arrëz, ku konkuroi dhe grupi i fëmijëve të Lipjanit. Ajo u mirëprit nga vetë fëmijtë dhe gjithë drejtuesit e qeverisjes vendore në Burrel. Masat organizative nga Zyra Arsimore dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve bënë të mundur repertorin e duhur për një ngjarje historike, siç ishte pavarësia e Kosovës. Udhëheqësi artistik i grupit, Artisti i Merituar Ymer Nelaj dhe metodistët e QKF-së, Hysni Heta e Miranda Haxhiu, përzgjedhën repertorin, ku bënte pjesë dhe kënga e re për pavarësinë e Kosovës, kënduar nga Serxhio Lleshi dhe kompleksi i

djemve e vajzave, melodi të njohura orkestrale me instrumenta tradicionale të trevës sonë, potpuri vallesh të kënduara matjane etj.

Ftesës nga Kosova, talentit dhe dëshirës së zjarhtë të fëmijëve iu gjendën pranë kryetari i bashkisë ➡



Lipjan, Kosovë

➡ “Sharri Këndon”, por këtë radhë me ståtusin e konkurentit. Pritja e ngrohtë, që iu rezervua ansamblit tonë nga grupi organizator i festivalit, i motivoi për të interpretuar me virtuozyt numra të zgjedhur nga folklori matjan. Në Tetovë ansambli shoqërohej nga kryetari i bashkisë Burrel, z. Skënder Lleshi, i cili në hapje të festivalit përshëndeti evenimentin kulturor mbarëkombëtar, duke shkëmbyer me kryetarin e komunës Tetovë, z. Azbi Lika, në mënyrë simbolike, emblemat e dy qyteteve me motivacionin e mirënjohjes, në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit artistik e

kulturor. Pas interpretimit me nivel të lartë artistik të grupit tonë, juria e festivalit i dorëzoi Qendrës Kulturore Burrel, kupën e festivalit “Sharri Këndon, 2008”, diplomat për artistët pjesëmarrës, çmime të para për Orkestrinën Popullore Matjane, si orkestrina më e mirë e këtij festivali dhe për instrumentistin Enver Kurti, si instrumentisti më i mirë me lodër.

Edhe një herë themi që viti 2008 ishte nga vitet më të suksesshëm për Qendrën Kulturore Burrel dhe “Ansamblin Mati” në pjesëmarrjet lokale e kombëtare.



Berat



Skënder Lleshi, këshilli bashkiak dhe Zyra Arsimore, të cilët mundësuan financiarisht udhëtimin për në komunën e Lipjanit. Më 16 shkurt 2009 artistët e vegjël matjanë u përcollën nga Burreli drejt Kosovës me urimin e zjarrtë dhe dëshirën për përfaqësim dinjitoz të vlerave të artit matjan.

Në qytetin e Kukësit fëmijët matjanë u bashkuan me grupet e tjera nga Shqipëria. Në sheshin para Radio Kukësit artistët e vegjël kënduan dhe hodhën së bashku valle kosovare. Grupi ynë u filmua nga TV Kukësi e Top Media. Udhëtimi nëpër viset e bukura dhe historike kosovare ishte mbresëlënëse. Pas njëmbëdhjetë orësh udhëtim nga Burreli, arritëm në qytetin e Lipjanit. Para shkollës fillore “Tre vëllezërit Frashëri” u pritëm me entuziazëm nga nxënës, kolektivi i mësuesve, përfaqësues të komunës dhe shumë qytetarë të Lipjanit. Të buzëqeshur e të gëzuar shtrëngonim duart dhe iu uruam gëzuar pavarësinë vëllezërve kosovarë. Në sytë e tyre shihje dritë, liri, gëzim, dashuri, respekt e mirënjohje, shihje festën e parë në liri, flamurin kombëtar dhe atë të Kosovës, të cilët valëviteshin të lirë e krenarë. Fëmijët lipjanas, së bashku me mësuesit e shkollës dhe shumë qytetarë, kërkuan të merrnin në shtëpitë e tyre për mysafirë fëmijët nga Shqipëria. Dhe kështu ndodhi. Për pak minuta u bë sistemimi i fëmijëve nëpër shtëpitë e vëllezërve e motrave të tyre nga Lipjani.

17 shkurt 2009. Ditë festive madhështore në gjithë Kosovën dhe kudo ku jetojnë shqiptarë. Lipjani ishte zbuluar me drita shumëngjyrëshe e flamuj kombëtarë. Edhe pse shumë ftohtë, në rrugët dhe sheshet e qytetit u bë parakalimi i grupeve artistike të fëmijëve nga Lipjani, Shtimja, Fushë-Kosova, Mati, Mirdita, Fushë-Arrësi dhe Hasi. Fëmijët artistë sipas grupeve u ngjitën në skenën, ku do të jepej programi artistik. Altoparlantët përhapnin këngë trimërie dhe heroizmi të shqiptarëve ndër shekuj për liri e pavarësi.

Kryetari i komunës së Lipjanit, z. Shykri Buja, uroi artistët e vegjël pjesëmarrës në këtë ditë të shënuar historike për tërë kombin shqiptar. Më pas nisi manifestimi artistik. Pas tre grupeve nga Kosova, spikerja ftoi në skenë grupin e artistëve të vegjël nga Mati. Duartrokitjet e fuqishme të mirëseardhjes nga të pranishmit i ndërpreu ritmi i fuqishëm i daulles dhe thirrja

e fortë e majëkrahut nga Serxhio Lleshi: “E hej, hej... Ka shpallë Kosova pavarësinë... o hej, ej...” Dhe përsëri ritmi lajmëtar i lodrës nga Erjon Abazi. Menjëherë kënga për pavarësinë e Kosovës filloi nga gjithë grupi dhe valltaret e vogla Kejsi Gjoni e Orkida Dedja. Sheshi oshëtiu nga këngët dhe duartrokitjet e pjesëmarrësve për artistët e vegjël matjanë. Më pas u duartrokit gjatë melodia orkestrale me instrumenta popullore të krëhinës së Matit, interpretuar nga Mikeli, Xhulio, Almiri, Mirjani, Bilbili, Jurgeni, Fatjoni, Serxhio e Klodiani, nën drejtimin e mësuesit të tyre, Artistit të Merituar Ymer Nelaj. Folku i pasur matjan u shpalos edhe nga interpretimi i potpurisë në vallet e kënduara matjane. Këtë herë në kompleks e valle janë dhe Ervisa Sulaj, Desantina Doçi e Sara Frisku. Pas mbylljes së manifestimit sërish mysafirë në shtëpitë e lipjanasve. Në darkën e shtruar nga komuna për nder të festës së pavarësisë, përshëndetën deputeti i Kosovës R. Buja, kryetari i bashkisë Fushë-Arrëz, Ndue Paluca, kryetari i komunës së Lipjanit, Shykri Buja etj. Nga kanalet televizive mësuam se në zonat verilindore të Shqipërisë kishte rënë borë dhe rrugët ishin bllokuar. Megjithatë, në orën pesë e tridhjetë të mëngjesit u nisëm nga Lipjani për tu kthyer në Burrel. Bënte shumë ftohtë. Rruga vështirësohej sa më shumë ngjiteshim drejt kthesave të Qafës së Malit. Takuam shumë automjete të bllokuara nga bora, pasi e kishin të vështirë kalimin pa zinxhirë. Por shoferi ynë, Lutfi Punavia, zinxhirët i hoqi kur arritëm në rrethin e Mirditës.

Pas 12 orësh udhëtim u kthyem shëndoshë e mirë në vendlindje, ku prindërit, të afërmit dhe shumë qytetarë na pritën krahëhapur. Detyrat i kishim realizuar shumë mirë, duke lënë të hapur rrugën dhe për veprimtari të tjera po kaq të bukura. Edhe këtë herë grupi i QKF-së Burrel “Folk muzikë Mati” nderoi veten, krahinën, Zyrën Arsimore dhe bashkinë Burrel. Me sukseset që kanë arritur dhe përfaqësimin dinjitoz që i kanë bërë Matit brenda dhe jashtë kufijve të atdheut, këta artistë të talentuar ftojnë drejtuesit vendorë dhe donatorë të ndryshëm për t’i ndihmuar me mjedise pune, vegla të mira instrumentale tradicionale e kostume popullore të krahinës.

Figura të shquara të Albanologjisë

MILAN SHUFLAI

MBROJTËS I GJENEZËS SHQIPTARE

Historiani kroat me origjinë gjermane, dr. Milan Shuflai (Šufflay), ishte albanologu më i devotshëm i periudhës kur jetoi. U lind në Lepogllavë më 9 nëntor 1879 dhe vdiq nga një atentat barbar në Zagreb më 19 shkurt 1931. Shuflai ishte njohës i mirë i gjuhëve ballkanike dhe profesionalisht një nga historianët më të mirë të gadishullit ballkanik. Formimi e tij prej studjuesi ishte produkt i shkollave austro-gjermane të albanologjisë dhe shkollave kroate e sllovene.

Interesimin e Shuflait për shqiptarët dhe Shqipërinë e ndeshim që në fillim të karrierës së tij shkencore. Duke hulumtuar e mbledhur dokumente nëpër arkivat e Dalmacisë, ai zbuloi materiale burimore, shumë interesante, të pa botuara, që i takonin mesjetës shqiptare. Kjo periudhë në atë kohë ishte e pa hulumtuar dhe zgjoi interes të jashtëzakonshëm te studiuesi i ri, interesim ky që e preokupoi aq shumë, sa u bë qëllim kryesor i veprimtarisë shkencore për gjithë jetën. Gjatë asaj periudhe kohore, dr. Milan Shuflai shkroi studime të jashtëzakonshme me vlera të larta shkencore në fushën e albanologjisë. Pas zbulimit të lëndës arkivore, ai bëri studime dhe analiza të posaçme, të cilat e paraqesin kulturën shqiptare në një shkallë të lartë zhvillimi në mesjetë, duke mbrojtur teorinë se kjo kulturë ishte më e afërt me bizantin dhe dalmatët, se sa me sllavët e ngulur në Ballkan dhe, se kishte një traditë të pasur që nga kohët më të lashta. Kontributi i tij në këtë drejtim është i argumentuar dhe ka themele të forta shkencore. Ndër studimet e tij më të mëdha është botimi me bashkautorët L. Thalloc dhe K. Jireček i “Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia”, dëshmi dhe dokumenta që ilustron ngjarjet e Shqipërisë në mesjetë. Kjo vepër në dy vëllime njihet me emrin “Acta Albaniae”. Volumi i parë u botua në Vjenë më 1913, kurse i dyti më 1918, po në Vjenë. Ato flasin për Shqipërinë e viteve 334 - 1406. Studime të tjera të këtij albanologu janë “Rrethanat kishtarë të Shqipërisë paraturke” dhe “Politsche Schicksale det Themis Durrachin” (Fatet Politike të Themës së Durrësit), “Biologjinë e fiseve të popullit shqiptar”, në gjermanisht. Në vitin 1920 botoi “Qytetet dhe



kështjellat e Shqipërisë në Mesjetë”, ndërsa më vonë studimin “Historia e shqiptarëve të veriut” dhe monografinë “Serbët dhe shqiptarët”. Trajtimin e çështjes së ngritjes së dinastive shqiptare në Shqipërinë e Veriut dhe problemin e gjenezës së tyre e zbërthen në atë mënyrë, që duke gjetur lidhje të ndryshme farefisnore, të gjakut apo martesore me bujarët fqinj, malazias, kroatë, grekë, maqedonas, bullgarë apo serbë, vëren ndikim të caktuar në organizimin e strukturës shtetërore shqiptare dhe institucionet e tjera, që në këto treva kishin një traditë të gjatë.

Aktiviteti studimor i Milan Shuflait në dobi të historisë së shqiptarëve nuk i pëlqente hegjemonizmit serb. Ky hegjemonizëm kishte filluar të ndjehej dukshëm, që nga fundi i viteve 20’ dhe inspirohej hapur nga mbreti serb, Aleksandër dhe mbështetësit e tij, të cilët i kryenin kërcënimet dhe spastrimet e personaliteteve kroate e më gjerë nën moton: “Za kralja i otad•binu” ➡

← (Për mbretin dhe atdheun). Viktima të këtyre spastrimeve u bënë qeveritarë kroatë dhe deputeti i Shkupit, Kolë Bojaxhi, babai i Nënë Terezës, i cili u helmua me kafë në godinën e parlamentit në Beograd. Ekzekutimi i dr. Shuflait u krye nga antarët e grupit ilegal “Mlada Jugosllavija”, (Jugosllavia e re), e cila në fakt ishte për mbrojtjen e politikës së vjetër shoviniste të mbretërisë serbo-kroato-slllovene, ku dominonte hegjemonizmi serb. Shkak i drejtpërdrejtë i atentatit ishte vizita e shkencëtarit Shuflai në Tiranë. Simpatia e madhe ndaj popullit shqiptar, lidhjet e afërta me Shqipërinë, pranimi dhe argumentimi në mënyrë shkencore i tezës së prejardhjes së drejtpërdrejtë të shqiptarëve nga ilirët, si dhe autoktonia e tyre në trojet shqiptare, ishin shkaqe që e shtynë Beogradin për të organizuar vrasjen e Milan Shuflait. Menjëherë pas atentatit policia konfiskoi të gjitha dorëshkrimet, që ndodheshin në apartamentin e tij. Një pjesë e mirë nga këto dorëshkrime humbën përgjithmonë. Megjithatë Shuflai ishte pedagog i universitetit të Zagrebit dhe shumë i njohur me studimet e shumta shkencore, në rang Europe, për ekzekutimin e tij, gazetat e Zagrebit, të kërcënuara nga klanet serbe, nuk guxuan të publikojnë shkrime homazh për aktivitetin e tij, madje as lajmin e vdekjes. Në njoftimin zyrtar të vrasjes së dr. Milan Shuflait, më 19 shkurt, policia deklaronte se autori nuk ishte identifikuar, ndërkohë që vrasësit njiheshin, po ashtu dhe organizata “Mlada Jugosllavija”, së cilës i përkisnin. Ata u larguan në Beograd dhe pas afro dhjetë vitesh iu kthyen gjykatës së Zagrebit, ku ku deklaruan se: “...vendimi për likuidimin e Milan Shuflait u mor, pasi ai u kthye nga Shqipëria. Pas kërcënimeve për të hequr dorë nga studimet e tij, më 15 shkurt, në zyrën e shefit të policisë së Zagrebit u vendos likuidimi i tij”.

Duke iu referuar ngjarjes tragjike, Albert Ajnshtajn dhe Hajnrih Man, i shkruan Ligës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, degës së Parisit:

“Fort të nderuar miq! Ne nuk mund të bëjmë lëshime e të mos ia tërheqim vërejtjen Ligës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut për ngjarjen e 18 shkurtit të këtij viti (1931), e cila solli vdekjen e shkencëtarit kroat dr. Milan Shuflai. Kur ky shkencëtar ditën e përmendur po shkonte në shtëpi, ishte në një rrugë të Zagrebit, kur u sulmua pas shpine dhe, sipas burimeve tona, e plagosin rëndë me shufër hekuri. Dhe ditën tjetër vdes nga plagët e rënda, kurse më 22 shkurt varroset në Mirogojë pranë martirëve kroatë”.

Ekzekutimi i Shuflait u pasqyrua në shtypin mbarëbotëror të kohës, në Gjermani, Itali, Amerikë etj. Në Shqipëri shkruan gazetat “Arbënia”, “Vullneti i Popullit” etj. Krahas të sipërpërmendurve reagues dhe shumë organizma dhe personalitete të shkencës e letrave europiane e botërore, mes të cilëve shqiptarët Lumo Skëndo (Mit’hat Frashëri) e Faik Konica.

Shuflai në veprat e tij e paraqet kulturën shqiptare në një shkallë të lartë zhvillimi në mesjetë, me një traditë të vazhduar që nga antikiteti. Prejardhjen ilire të shqipes

e të shqiptarëve, ai e dëshmon me argumente shkencore, ndër të tjera dhe me praninë e emrave të vendeve, krahinave e vëllazërive, të cilat i trajton si emra ilirë, që mund të zëbërthehen me brumin gjuhësor të shqipes. Në anën tjetër shpreh mendimin, se shqipja është një idiomë e ilirishtes dhe fazë e re e një të folmeje të moçme ilire, sepse shqiptarët jetojnë aty, ku në kohë të lashta kanë jetuar ilirët dhe ishin në këto treva pa asnjë dyshim, para dyndjes së sllavëve. Në studimet e dr. Milan Shuflait bie në sy pasuria e madhe e materialit burimor faktologjik. Historia e shqiptarëve është për shkencëtarin e shquar historia etno-kulturore e një kombi të dalluar, me rrënjë të lashta autoktone e vazhdimësi të pandërprerë, me një aftësi të jashtëzakonshme rigjeneruese, e cila paraqet thelbin autentik të historisë së Ballkanit në përgjithësi dhe asaj shqiptare në veçanti.

Qeveria shqiptare e asaj kohe, duke treguar respekt dhe nderim të veçantë për shkencëtarin dhe albanologun e njohur kroat me famë botërore, e kishte ftuar në fund të vitit 1930, që të vizitonte Shqipërinë. I pritur me nderimet më të larta shtetërore, që nga mbreti Zog I, kryeministri, ministri i kulturës dhe anëtarët e Parlamentit, para të cilëve më 16 janar 1931 ai mbajti një fjalim në gjuhën shqipe, ku në mënyrë të hollësishme përshkroi punën rreth botimit të vëllimeve në vazhdim të “Acta Albaniae”, si dhe të “Historisë së Shqipërisë”. Ata e përgëzuan për punën që kishte bërë, në hulumtimet dhe kërkimet shkencore në fushën e albanologjisë dhe veçanërisht në studimin dhe botimin e dokumentave mesjetare, të cilat deri në atë kohë, pothuajse ishin fare të panjohura. I shoqëruar nga intelektualë dhe politikanë shqiptarë, studiuesi i madh kroat vizitoi arkiva të ndryshme kishtare, biblioteka, pika arkeologjike dhe u njoh nga afër me kulturën dhe traditën shqiptare, për të cilën kishte shkruar aq shumë. I impresionuar nga mbishkrimet dhe dokumentat e shumta mesjetare, pjesën më të madhe të tyre i fotografoi, me qëllim që, kur të kthehej në Zagreb, t’i studionte me themel dhe të nxirrte konkludime shkencore. Për fat të keq një gjë të tillë nuk arriti ta bënte kurrë.

Metoda e shqyrtimit shkencor të dr. Milan Shuflait, paanshmëria, korrektësia, pedantëria, analizat dhe studimet e vazhdueshme, qofshin ato paleografike, diplomatike, onomastike, toponomastike apo të tjera, edhe sot e kësaj dite kanë vlera të rralla. Një gjë të tillë ia mundësonte kultura e gjerë, njohja e gjuhëve të shumta, vullneti dhe këmbëngulja, që e vërteta çdo herë të ngadhënjë, edhe në ato raste kur kjo gjë dikujt nuk i pëlqen.

Duke përkujtuar abanologun e shquar në 130-vjetorin e lindjes dhe 78-vjetorin e vrasjes, i bëjmë homazh veprës së tij dhe njëkohësisht përgënjeshtrojmë mohuesit e mbrapshtë të popullit shqiptar, të gjuhës shqipe dhe trojeve etnike shqiptare.

HISTORIA E SHQIPËRISË DHE FAMILJES MBRETËRORE 1443-2007



P. Najbor dhe S. Zogu, Prizren

Dr. Patrice NAJBOR është diplomuar në Institutin e Studimeve të Mardhënieve Ndërkombëtare në Paris, për diplomaci dhe administrim të organizatave ndërkombëtare. Më 1992, ka realizuar tezën: “Dykenorja e Shqipërisë në mardhëniet ndërkombëtare bashkohore” dhe shumë shkrime në kuadër të studimeve të thelluara të mbrojtjes dhe sigurimit europian, midis të cilëve “Sistemi dhe politika e sigurimit të Shqipërisë” dhe “Çështja shqiptare e Kosovës”. Dr. Patrice Najbor është autor i librit “Dinastia e Zogut”, 2002 dhe “Historia e Shqipërisë dhe e familjes së saj mbretërore 1443-2007”, në pesë vëllime. Vepra e tij “Historia e Shqipërisë dhe e familjes mbretërore”, botuar në gjuhën frënge më 2008, ndahet në pesë vëllime dhe përfshin periudhat më kulmore të historisë së Shqipërisë dhe familjes mbretërore. Kjo lëndë është rezultat i dokumentave të rrallë autentikë, shkrimorë e fotografikë, të cilët do të shërbejnë për të hedhur dritë mbi figura e ngjarje, me qëllim që historiografia shqiptare të bëjë vlerësim real të tyre. Gjatë prononcimeve të tij për punën e bërë për këtë libër ai thotë se është përpjekur të vendosë të vërtetën historike duke paraqitur me objektivitet, veçanërisht, në sajë të burimeve të jashtme, faktet dhe personat të cilët nuk janë njohur deri tani nga historiografia shqiptare. Kështu sjell një kontribut në rishikimin e historisë së Shqipërisë.

Skënder ZOGU

“Histoire de l’Albanie et de sa Maison Royale 1443-2007” është libri më i fundit i studjuesit francez Patrice Najbor, i cili po qarkullon kohët e fundit në Francë dhe më pak në vendin tonë në gjuhën frënge. Ky botim voluminoz: “Historia e Shqipërisë dhe e familjes së saj mbretërore 1443-2007”, është i përfshirë në pesë volume.

Vëllimi I, “Lufta për pavarësi e shqiptarëve 1443-1925”, paraqet përpjekjet shekullore të kombit shqiptar, për mëvetësi e sovranitet, veprimet e Fuqive të Mëdha për të ruajtur ose zgjeruar sferat e tyre të influencës, si dhe rolin e tyre në zgjedhjen e princ Ëied (Vidit) më 1914, politikën e diskutueshme të Esat pashë Toptanit, i cili është konsideruar nga shumë shqiptarë tradhëtar, kur pranoi dorëzimin e qytetit të Shkodrës më 1913, në një kohë kur nga ky veprim, ai jo vetëm shpëtoi ushtrinë e tij dhe armatimin nga një humbje e sigurtë, pasi ushtria ishte e raskapitur pas disa muajve luftë, por dhe ndërkombëtarizoi këtë krizë midis Shqipërisë e Malit të Zi. Nga ky veprim i tij, sot themi, se ai ka qenë largpamës dhe i shkathët, meqenëse disa ditë më vonë, nën presionin e Fuqive të Mëdha, mbreti Nikolla i Malit të Zi u detyrua t’ua kthejë qytetin shqiptarëve.

Vëllimi II, “Periudha zogiste dhe krijimi i Shqipërisë moderne, 1925-1939”. Në këtë vëllim dr. Najbor paraqet periudhën e viteve ‘20, duke sjellë një veshtrim të ri përsa i përket figurave të Fan S. Nolit dhe Ahmet Zogut. Në kundërshtim me atë që për shumë kohë është folur, Fan Noli ishte larg të qenurit demokrat. Qeveria e tij bolshevike eci drejt diktaturës duke shpallur në të gjithë vendin gjendjen e shtettrrethimit, duke vendosur gjykatat e jashtëzakonshme dhe duke mos mbajtur premtimin e tij për të organizuar zgjedhje të lira. Studimi i kësaj periudhe tregon se mbreti Zog, me realizimet e tij në fushat institucionale, legjislativë, edukative, shëndetësore, ushtarake, diplomatike, ekonomike dhe në drejtim të zhvillimit të ndërtimit të rrugëve dhe të infrastrukturës së vendit, ka vendosur bazat e një shteti modern, demokratik të tipit perendimor dhe duke zëvendësuar të drejtën e forcës, me forcën e së drejtës, ai paraqitet si njeriu më progresist i kohës. Ahmet Zogu, “Ataturku shqiptar”, shfuqizoi feudalizmin, dekretoi shtetin laik dhe kontribuoi në zhvillimin e ligjit për vendin e gruas në shoqërinë shqiptare.

Vëllimi III, “Familja mbretërore në mëgrim, 1939-2002”. Në vëllimin e tretë autori tregon udhëtimin e gjatë e të vështirë të familjes mbretërore në mërgim dhe luftën e vazhdueshme të mbretit Leka I për çlirimin e Shqipërisë nga komunizmi dhe të ➡

PËRKUJTOHET MASAKRA E MARTANESHIT



Në fshatin Peshk, në oborrin para shkollës “Mësonjtorja e parë”, më 26 tetor 2008 u mbloodhën qindra njerëz nga treva e Martaneshit dhe krahinat fqinje, për të përruar memorialin ngritur në kujtim të 22 burrave dhe djemve të këtij fshati, të vrarë pafajësisht. 22 viktimave të luftës Nacionalçlirimtare, vrarë më 3 mars 1944 jo nga pushtuesit e huaj, por nga vëllezërit e tyre shqiptarë, të cilëve krahina e Martaneshit u kishte dhënë strehë e mbështetje. Ishin partizanët e Brigadës I të prirë nga komandanti internacionalist, Mehmet Shehu, të cilët gjatë marshimit nëpër Peshk, ishin qëlluar nga periferitë e fshatit, ku kishte mbetur i plagosur një partizan, i cili më pas kishte vdekur. Gjakatarin e kishte pushtuar tërbimi ndaj kishte dhënë urdhër për hakmarrje. Partizanët ishin shpërndarë nëpër fshat dhe kishin sjellë 22 burra të lidhur me brezat e tyre, të cilët i kishin tërhequr zvarrë deri në Tërshanas, mbi Peshk dhe i kishin ekzekutuar dhe dhunuar kufomat me të vetmin faj: ishin nga fshati, ku mbeti i vrarë partizani. Për 46 vite me radhë familjet e të vrarëve u privuan nga gëzimet dhe jeta e “lumtur” kolektive me bashkëfshatrë. Vëllezërit, fëmijët, nipat dhe mbesat e tyre morën njollën e “armikut të klasës”. U desh të kalonin vite, derisa të vinin ndryshimet e shumpritura nga i gjithë populli shqiptar në fillim të viteve '90-ë që këto familje të ngrenë kryet. Erdhën ditët që të mblidhen e të flasin

lirshëm dhe jo tinnëz. Bilanci: të lodhur nga jeta e stërmundimshme në frontet më të vështira të punës në miniera, të pashkolluar e burgjeve.

Më 26 tetor 2008, pas shumë përpjekjesh dhe me grumbullimin e fondeve nga biznesmenë lokalë dhe kontribute të tjera, u mundësua ngritja e memorialit në kujtim të asaj ngjarje, që ndërpreu në mes jetët e 22 burrave dhe ndryshoi rrjedhën e jetës së pasardhësve të tyre. Ishte përkujdesi i deputetit të zonës Idriz

Xhomara dhe këmbëngulja e familjarëve të të vrarëve, Kujtim Balla, Shyqyri Peshku, Ibrahim Grrica etj, që memoriali të konkretizohej sa më parë, paçka se data 26 tetor nuk përkonte me ngjarjen e dhimbshme. Në ditën e përrimit, Kujtim Balla, krahas dhimbjes për të atin Musain, që e la një vjeç e gjysmë e nga cili nuk ka as një fotografi për ta njohur si ishte, ndjen dhe gëzimin që sot ata kanë një memorial, simbol të përbashkët në sheshin para shkollës së Peshkut, që fëmijët të njohin dhe respektojnë pafajsinë e tyre. Para memorialit të zbuluar nga deputeti Sali Shehu dhe ish i dënuari politik Sali Grrica, vendosën kurora me lule deputeti Xhomara dhe Skënder Lleshi, ndërsa në emër të familjarëve e vendosën Sybe Gjoka e Vera Peshku. Para memorialit u përkul me respekt dhe Baba Hysniu i Teqes së Martaneshit i cili këndoi lutje për shpirtat e viktimave.



← Kosovës nga zgjedha serbe. Dr. Patrice Najbor sjell për këtë problem, shpesh të panjohur, veprimtaritë e ndryshme politike të mbretit Leka I. Përtej mosmarveshjeve të shqiptarëve të diasporës, mbreti Leka I ka punuar për ribashkimin e kombit shqiptar, ndërsa princi trashëgimtar, Leka II, është përgatitur për t'i shërbyer vendit të tij.

Vëllimi IV, “Kthimi përfundimtar i familjes mbretërore në Shqipëri, 2002-2007”. Këtu përshkruhet kthimi i familjes mbretërore në atdhe dhe rrethanat politike në Shqipëri e rajon. Këto rrethana sollën pas një rruge të gjatë pavarësinë e Malit të Zi dhe Kosovës, kthimin në pushtet të Sali Berishës dhe tranzicionin e gjatë e të vështirë demokratik, marrjen të pandehur nga gjykata e Hagës njërin nga komandantët e UÇK-së, Ramush Haradinajn, miratimin nga kuvendi i Shqipërisë të ligjit për familjen mbretërore, kthimin e pallatit të princeshave, nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Bashkimit, si dhe vdekjen e presidentit Ibrahim Rugova e të mbretëreshave Geraldinë e Suzanë.

Vëllimi V, “Dokumenta”. Vëllimi i pestë përmban dokumenta të arshivave, traktateve ndërkombëtare dhe të marrëveshjeve sekrete, letrave e pemëve gjenealogjike. Duke botuar këto tekste origjinale në tërësinë e tyre, autori nëpërmjet përshkrimit të thjeshtë synon që lexuesi të ketë mundësi vetë të shprehë mendimin e tij mbi faktet e treguara. Libri përfundon me një bibliografi të pasur të veprave që nga shekulli XV, deri në ditët tona. Rrallë qëllon që botimet historike të jenë të ilustruara kaq dendur me foto, dokumente, faksimile gazetash e librash, dokumentesh origjinalë, hartografi të situatave të ndryshme historike etj, në të gjitha ngjarjet historike të trajtuara në vepër dhe për të gjithë personazhet që ajo përmend. Vepra historike e voluminoze e dr. Patric Najbor, krahas botimit dokumentar, është dhe një arkiv i rëndësishëm me foto dhe dokumente shumë të rëndësishme historike dhe dokumentare. Shpresojmë, që së shpejti, këtë përmbledhje do ta kenë në dorë dhe lexuesit e gjuhës shqipe.

← Deputeti Xhomara preku në fjalën e tij atë, që do ta ritheksonin më pas dhe shumë folës të tjerë: “Përse duhet të ndodhte kjo masakër, kur Martaneshi, në emër dhe të ndikimit që kishte Baba Faja, i dha gjithçka luftës?! I dha djemtë, bukë, shëllirë dhe opingat me gjalmë”. Sali Shehu deputet i Bulqizës, iu drejtua të pranishëmve: “Sot për Peshkun, Martaneshin, për gjithë Veriun është ditë e shënuar, ditë historike. Ky është një moment, që flet se historia duhet të rishikohet dhe 3 marsi 1944 duhet të hyjë në histori. Gjaku i bijve tuaj, të këtyre burrave të pafajshëm, bëri që Mehmet Shehu ta pësojë ashtu siç e pësoi, i eliminuar nga shokët dhe bashkëpunëtorët e tij.” Në fjalën e tij Sali Grrica, njëri nga familjarët e viktimave dhe ish i dënuar politik theksoi: “Më tre mars 1944 në krahinën tonë, djegur krejtësisht nga pushtuesit gjermanë, u futën dhe ata, partizanët, forcat që mendonim se do ta ndihmonin këtë popull dhe jo ta pushkatonin... Shumë pak është bërë këto vite për krahinën e Martaneshit, por edhe për këtë kategori të persekutuarish. Klasa politike duhet të bëjë diçka më tepër në këtë drejtim, për këtë popull të lodhur e të vuajtur, prej një periudhë mjaft të gjatë.”

Takimin e përhëndetën kryetari i bashkisë së Burrelit Skënder Lleshi, i Klosit, Bedri Hoxha, përfaqësuesit e bashkisë së Bulqizës Agim Tuci e Ali Shehu, përfaqësuesi i komunës së Krastës, Ibrahim Gjoni, skulptori Artan Kurti, i cili ideoi dhe realizoi me ndihmën dhe të familjarëve këtë memorial, Luftim Vani, president i “MAT TV”, kryetari i Shoqatës Kulturore-Atdhetare “Martaneshi” Sulë Peshku, pasardhës të viktimave të cilët dënuan aktin e turpshëm të vëllavrasjes. Ngjalli emocione e dhimbje kënga e rapsodit Avni Hoxha kushtuar 22 të vvarëve. Me duartrokitje u pritën Esat Ruka dhe Shkëlqim Farrici, këngët e të cilëve me ritmet e tyre sollën atmosferë gëzimi te të pranishmit.



Çast nga ceremonia

Më 30 nëntor 2008, përsëri në Peshk. Përsëri nciator deputeti i zonës, Idriz Xhomara. Këtë radhë për të mbjellë pranë memorialit, në shenjë përjetësimi të emrave të viktimave, dy cedra (pisha), varietete të ardhura nga Himalaja dhe të sponsorizuara nga biznesmeni Aqif Klosi. Kishte ardhur dhe princ Leka, i cili duke iu drejtuar të pranishmëve tha: “Ndjem i emocionuar sot që jam këtu, bashkë me deputetin e zonës, për të respektuar ata, që u vranë barbarisht nga regjimi komunist. Erdha në fshatin Peshk të Martaneshit për të respektuar dhe familjet, që kanë humbur të afërmit në këtë akt kaq tragjik. Këta janë një pjesë e 96 000 shqiptarëve të vvarë gjatë kohës së komunizmit. Duhet të përpiqemi të gjejmë mundësi të ndyshme për ta zhvilluar këtë rajon, që është lënë në harresë.”

Sot në fshatin Peshk të Martaneshit, në oborrin para shkollës “Mësonjtorja e parë”, ngrihet një memorial. Ai mban të shkruar në pllakën e bardhë, të betontë, 22 emra burrash e djemsh të ri. Më në fund të afërmit e tyre ndjejnë një fije gëzimi. Ata vendosin tufa me lule, poshtë emrave të tyre, të shkruar afër e afër, si para 65 vjetësh të lidhur duarsh me brezat e tyre.

“emathia”



Princi Leka II me familjare të viktimave

Maskra e Martaneshit akuzon

Uran BUTKA

Martaneshasi në çdo kohë, deri në shekullin XX, ka qenë fshatar i lirë. Ai nuk i është nënshtruar asnjë invazioni të huaj e as ndonjë autoriteti vendas. Edhe kur këta kanë tentuar ta shkelin Martaneshin, apo ta bëjnë rob malësorin e lirë të kësaj krahine të thellë e të ashpër, kanë dështuar. Këtë e thotë kënga historike “Martaneshi vend i mirë / s’durojnë pashë, s’durojnë vezirë! Ai nuk u mposht as nga osmanllinjë, as nga serbi, fashistët italianë dhe as nga nazistët gjermanë, duke ruajtur kështu traditat më të mira të shqiptarit, siç janë trimëria, besa, mikpritja dhe ndershmëria. Tempulli i fesë bektashiane, që predikonte panteizmin, harmoninë, mirësinë, dashurinë si dhe patriotizmin shqiptar, Martaneshi u bë dhe tempulli i këtyre virtyteve si dhe i gjuhës së bukur e të pasur shqipe.

Mirëpo, komunizmi e nënshtroi Martaneshin dhe i ktheu në rob martaneshasit. Akti i parë i kësaj robërie është 3 marsi i vitit 1944.

DITA E PARË E TERRORIT KOMUNIST

Brigada I sulmuese e komanduar nga Mehmet Shehu dhe zëvendëskomisari politik Dushan Mugosha, marshonte nga Kaptina për në Shëngjergj. S’kishte dalë ende dimri i ashpër i atij moti, ndonëse ishte fillimi i marsit. Brigada po kalonte nëpër Martanesh në fshatrat Lenë e Peshk, pothuajse e patrazuar megjithëse Mehmet Shehu shkruan më vonë në veprën e tij për të rrëfyer heroizmat e Brigadës I e të udhëheqësve të saj “legjendarë” se luftuan 6 orë me xhandarët dhe ballistët e Martaneshit! “*Posa dalim në lagjen Lenë, -thotë ai, -shpërthejnë krismat e pushkëve e mitralozave nga të gjitha anët kundër kolonës. Janë xhandarët e Abaz Kupit (!) dhe tradhtarët e Martaneshit (!)*”.

Abaz Kupi s’ka pasur ndonjëherë xhandarë, ndërsa Martaneshi ishte një trevë me tradita të shquara patriotike, vatër e luftës për liri, djepi i çetës së njohur partizane në të tërë Martaneshin, që i fali atdheut në luftë kundër okupatorëve nazifashistë gjakun e dëshmorëve: Hysen Koxheri, Hajdar Mali, Shaban Kenga, Ramazan Alhasa, Myslym Grica, Riza Kenga, Zenel Koçi e Riza Fejza. Si është e mundur që ky Martanesh të shpërthejë nga të gjitha anët me mitralozë kundër Brigadës I për gjashtë orë apo për nëntë orë rresht, siç thuhet në një libër tjetër, e mos të vritet asnjëri?! Është e vërtetë se vetëm kur arriti në fshatin Peshk, pati një shkëmbim të shkurtër zjarri në largësi e me persona të paidentifikuar, që shkaktoi vrasjen e një partizani, Kamber Sadikut. Banorët e Martaneshit u shqetësuan për krismat e pushkëve dhe pyesin njëri-tjetrin, mos erdhën përsëri gjermanët për të na djegur? Ndaj dolën prej shtëpive e kasolleve, por u qetësuan e u gëzuan kur morën vesh se po kalonin

partizanët. Mirëpo pas kësaj ndodhi e pabesueshmja. Me urdhër të Mehmet Shehut njerëzit e tij u futën në çdo shtëpi të fshatit, kapën dhe rrëmbyen me forcën e armëve djemtë dhe burrat që ndodheshin atje, i lidhën dhe i morën me vete. Një burrë nga çdo shtëpi, është urdhër i prerë. Nën, gratë e fëmijët u shkonin pas duke klithur:

-Pse i merni, ku do t’i çoni? Çfarë kanë bërë? Kështu s’kanë bërë as gjermanët...

Nga një kasolle në tjetrën, nga një lagje në tjetrën, ky lajm i kobshëm u përhap në të gjithë Martaneshin. I mblodhën të gjithë të rrëmbyerit në një vend të veçantë, që quhet Tërshana, i lidhën dorë për dorë në varg me brezat e leshtë të mesit. Gjithsej 22 burra të fshatit Peshk dhe i pushkatuan.



E PAIMAGJINUESHMJA

Sali Grica, ish-i burgosur politik nga fisi i njohur i Gricajve të lagjes së sipërme të kasollexhinjve, fis nga i cili u pushkatuan pesë veta: Fejzullau, Shabani, Rexhepi, Rizai dhe Abdullahi, e përshkruan me habi e me dhembje të paimagjinueshme: “*Këta burra të pafajshëm i morën dhe i pushkatuan pa u thënë asnjë fjalë, pa u bërë asnjë pyetje, pa u bërë asnjë lloj gjyqi. Po cilët ishin këto viktima? Ishin bij të kësaj krahine, ishin burra që kishin ndarë me partizanët bukën e fëmijëve, rrobat e trupit, konakun e votrën. Po kush ishin vrasësit? Dikush thoshte gjermanët. Të tjerë e kundërshtonin: -Jo, jo, partizanët. Si Partizanët?! E pamundur! Po, po, partizanët me urdhër të Mehmet Shehut...*

E paimagjinueshme për mendjen e këtij populli. E papranueshme për traditat e Martaneshit lufta vllavrasëse. E pabesueshme, sepse ishin të gjithë bujq e blektorë të mirë, që me mall e shpirt kishin ndihmuar luftën. E paligjshme sepse u vranë pa gjyq e faj.”

Lufta civile që kishte filluar pas prishjes së marrëveshjes së Mukjes nga Partia Komuniste po bënte kërdrinë kudo. Enver Hoxha, Mehmet Shehu e udhëheqës të tjerë të PKSH-së, si dhe emisarët e Beogradit, Miladin Popviç e Dushan Mugosha, që e nxisnin dhe drejtonin këtë luftë, e pranojnë vetë këtë vijë praktike terroriste të politikës së tyre në Shqipëri. Enver Hoxha thotë me gojën e tij: “*Asgjë s’e peshonim. Parulla o me ne, o kundër nesh, ishte në rend të ditës. Nuk shikonim të bëheshin ato ekzekutime në Vlorë, vrasjet nga Brigada I...*” (AQSH. F,14. D. 2)

Mehmet Shehu ishte zbatuesi më i aftë i kësaj vije terroriste, që shkaktoi luftën vllavrasëse në Shqipëri. Në Lushnje, për shembull, në tetor të vitit 1943, ai vrau 62 fshatarë nacionalistë, njëherësh. Ata që s'i zuri plumbi i theri me thikë vetë zëvendëskomisari i Brigadës I, Dushan Mugosha. Masakra të tilla bëri ai me gardën e kuqe edhe në Vlorë, në Dumrë, në Mallakastër etj. Le të përmendim edhe vrasjen e 111 ushtarakëve italianë, të dorëzuar në zonën e Shëngjergjit, ku Mehmet Shehu urdhëroi t'i vrisnin vetëm e vetëm për t'u marrë këpucët. Në Martanesh me urdhërin e këtij xhelati u vranë 22 fshatarë të pafajshëm. Më pas u coptuan sipas stilit të Mugoshës aq sa familjarët mezi i dallonin nga rrobat e trupit a ndonjë shenjë tjetër.

Dëshmitarët e kësaj skene tragjike kujtojnë sot me tmerr e dhembje fjalët e viktimave të pafajshme.

-Ku po na çoni, bre burra, se kemi nga një tufë fëmijësh për të rritur, -u thotë Musa Balla.

-Jemi krejt të pafajshëm, -u thotë Abaz Gurra.

-Kemi dëgjuar se komunizmi vjen për të çliruar vatanin nga fashistët e jo për të vranë njerëzit e tij, -u tha Ali Gjoka i lidhur dorë për dore me bashkëfshatarët e tij Qerim Gjoka, Sulë Peshku, Kamber Peshku, Islam Çela, pra pesë vetë të pushkatuar nga tre familje.

-Mos na vrisni djemtë! -Klithi kryeplaku i nderuar i katundit, Rremë Çela, kur pa se po i rrezikohej jeta nga plumbat e bishave komuniste dhe djalit të tij Ibrahimit.

-Mosni burra, se kjo është faqja e zezë! -U foli Liman Hasballa, i lidhur për dore me Sulë Ballën, kur atyre iu drejtuan grykat e pushkëve.

-Ju po i vrisni vëllezërit tuaj. -Thanë Hysen Peshku, Isa Çela e Qazim Koçi. Të tjerët heshtën e në heshtje pritën vdekjen, si burrat e motit. 22 të pushkatuar të pafajshëm.

22 familje të pushkatuara.

22 shtëpi të nëmura, të damkosura e të mbyllura si për dasëm dhe për mort. Askush s'mund të shkelte më në pragun e tyre.

Një realitet i paimagjinueshëm për Martaneshin.

PASOJAT "POZITIVE" TË MASAKRËS

Historiografia e Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe "veprat" e M. Shehut e pasqyrojnë dhe e trajtojnë natyrisht shkarazi dhe në mënyrë të pavërtetë këtë ngjarje

"Martaneshi i djegur si bazë e partizanëve, si një pishtar i lëvizjes, që kish dhënë dërmën aty e një vit përpara ushtrisë fashiste italiane, tani po i kthente pushkën ushtrisë NÇL. Gjithçka tregonte se brigade nuk mund të dilte nga Martaneshi pa u ndeshur përsëri me armiqtë...

Një ndikim, veçanërisht të madh në shpartallimin e armiqve në Martanesh, pati pushkatimi, pas një gjyqi të shkurtër partizan, i disa reaksionarëve të kapur rob... Pasoja e saj pozitive u ndie menjëherë... (Mbi jetën dhe luftën e Brigadës I sulmuese, Tiranë 1977, fq. 270-273).

Së pari historiografia komuniste e quan Martaneshin dhe martaneshasit reaksionar e armik, sikur të ishte pushtues italian, gjerman apo serb.

Së dyti, për të justifikuar masakrën massive trillohet fabula e një gjyqi të shpejtë, që s'është zhvilluar kurrë (s'ka asnjë document apo dëshmitar) dhe që as vetë Mehmet Shehu në kujtimet e veta nuk e pretendon.

Së treti, quan, nga njëra anë, në mënyrë fyese, martaneshasit robër, nga ana tjetër edhe pse pas dyzet vjetësh për ligj vrasjen makabre e të paligjshme "të robërve" martaneshas.

Së katërti, e quan të domosdoshme këtë terror masiv. Së pesti, si konkluzion, e quan të vlefshme dhe me pasoja pozitive këtë genocid të organizuar, pra vrasjen e 22 "reaksionarëve", si dhe panikun që sjell në popull. Është filozofia, strategjia dhe praktika komuniste e krimit, që u ngrit në sistem nga PKSH.

Mehmet Shehu edhe pas dyzet vjetësh, me gjakftohtësi e në largësi kohore shkruan: "Në Martanesh pushkatuam 25 xhandarë e ballistë..." (M. Shehu, Vepra I), duke përfshirë këtu edhe tre viktima të tjera të vrara më pas gjatë marshimit. Por ai e ka ndryshuar në favor të komunizmit raportin e hakmarrjes nga një me dhjetë, siç e kishin gjermanët, në një me njëzetepesë. Dhe kjo ndaj shqiptarëve.

Edhe kur erdhi në Martanesh 34 vjet pas kësaj ngjarje, pra më 1978, në krye të marshimit të madh ushtarak-kalitës, në gjurmët e Brigadës I Sulmuese dhe sipas modelit kinez të marshimeve të mëdha, M. Shehu mbajti po atë qëndrim përbuzës e armiqsor, sadist e criminal. Për fat të keq unë me gjithë familjen ishim në atë periudhë (1977-1987) në Martanesh të dëbuar nga Komisioni i Dëbim-Internimeve me firmën e Manush Myftiut. Ai fund dimri i motit 1978, kur bëhej marshimi, ishte shumë i rreptë, sa s'ishte parë prej vitesh. Mjaft djem zboristë nga Tirana, Elbasani etj, të veshur e të ushqyer keq, humbën në dëborë apo u sëmurën rëndë. Kur zboristët arritën pas disa ditësh në Martanesh, ra mbrëmja. M. Shehu dha urdhrin e prerë: "Asnjë të mos afrohet e të mos futet në shtëpitë e popullit reaksionar të Martaneshit, që na vuri pushkën gjatë Luftës..."

Atë natë ishte ngricë e jashtëzakonshme. Zboristët, kursantët të Shkollës së Bashkuar dhe të shkollës "Skënderbeg", si dhe oficerët fushuan përjashta, megjithëse shtëpitë e martaneshasve atë natë nuk i shuan dritat e nuk i mbyllën portat. Po kush guxonte e kush i linte të hynin Brenda? As të sëmurët e as ata që kishin filluar të ngrinin. Doktoresha e spitalit, Merjemja, vraponte nëpënatë për ndihmë mjeksore urgjente sa në një grup në tjetrin, san ë një fshat në tjetrin. Zjarret ndriçonin, por nuk ngrohnin dot jetë e njerëzve që po fikej.

Nuk ishte ngopur ende lubia komuniste me gjakun e martaneshasve, por edhe pas 34 vjetësh kërkonte t'i poshtëronte, të mbillte ende hakmarrje e urrejtje ndaj "reaksionarëve" të vjetër dhe "reaksionarëve" të rinj, bijve të tyre, një politikë antishqiptare e antinjerzore, e përçarjes dhe e sundimit, e nënshtrimit dhe e terrorit, e hurit dhe e litarit.



VËLLEZËR TË PANDARË NË NJË HULLI

Rakip LASKU

Duke shfletuar enciklopedinë frënge, krejt rastësisht më tërhoqi vemvendjen një fotografi e vëllezërve Louis e Auguste Lumier, që kanë hyrë në historinë botërore si pionierët e artit të shtatë, kinematografisë. Në Paris nuk i njihje askush nga njerëzit e sferës së lartë. Në një tubim për të promovuar këtë shpikje të madhe, ata u treguan aq të thjeshtë, modestë dhe të mënjanuar, sa shumë prej atyre që ishin mledhur, s’e morën vesh se kush ishin autorët e kësaj shpikjeje. Por dhe atyre që e kishin marrë vesh, nuk u ishte besuar që këtë shpikje të madhe të një rëndësie botërore ta kishin këto dy njerëz të thjeshtë, me pamje varfanjake, por që ngjanin çuditërisht me njeri-tjetrin, sepse ishin vëllezër dhe po hynin triumfalisht në krye të historisë së kinematografisë borërore.

Edhe Dilaver e Sefedin Kurti, qysh në fillimet e njohjes sime me ‘ta, më kanë tërhequr vemendjen. Dhe as s’kam mundur të ndahem prej tyre. Më kanë kujtuar gjithmonë vëllezërit Lumierë, jo vetëm për faktin që ishin vëllezër, të thjeshtë e modestë, por dhe për faktin që ata plotësonin në mënyrë perfekte njeri-tjetrin, duke ecur krah për krah e të pandarë në të njëjtën hulli, kur dihet se Dilaveri ishte arkeolog, etnolog e historin, ndërsa Sefa, zdrukthtar, bletërritës i përkushtuar e mbi të gjitha mik i natyrës dhe amator i pasionuar për të gjurmuar historinë kudo ku ajo ndodhet.

Kanë kaluar 10 vjet nga ikja e Dilaver Kurtit dhe pata kujtuar se pas kësaj ikjeje të beftë do të këputeshin ato fije, që më lidhnin me familjen Kurti, familje me një traditë të vjetër, që gjithmonë gjatë

rrjedhës së saj ka nxjerrë njerëz të ndershëm e të devotshëm. Por çuditërisht nuk ndryshoi asgjë, përkundrazi lidhjet u bënë edhe më të forta, më solide, aq sa më duket sikur kam hyrë në një valle tjetër, prej të cilës edhe sikur të dua, nuk dal dot.

Ishte së pari Artani, sakaq Sefa dhe të gjithë të tjetët, që më ulën në karrigen e Dilaverit, duke më besuar arkivin dhe veprat që ai kishte lënë për t’u kujdesur për botimin e tyre. Kjo nuk ishte ndonjë përgjegjësi e vogël për mua. Nuk munda ta kundërshtoj e as ta shpërdoroj. Dhe nuk bëhej fjalë, që të kërkoja ndonjë shpërblim material. Ishte një obligim, që unë nuk kisha kurajo civile t’i shmangesha, sepse Dilaver Kurti për mua kishte bërë shumë. Por ishte dhe një përgjegjësi, që unë kisha frikë se nuk do ta përmbushja, ashtu siç duhet dhe ashtu siç mund t’i pëlqente atij. U vura në krye të grupit nismëtar të formimit të Shoqatës Kulturore “Dilaver Kurti” e të botimit të revistës “emathia”. Gjatë udhëtimeve që kam bërë me Artanin, i përkushtuar për të vijuar rrugën dhe punën e të atit me çdo lloj çmimi, kam konstatuar me kënaqësi, që Mati ëshë trevë interesante historike, që Dilaver Kurti i ka kushtuar gjithë jetën e vet. Vepra e tij ka vlera të mëdha unike e të pakontestueshme, por fusha e kërkimeve nuk është e as nuk do të jetë e mbyllur. Kjo veprimtari, që Artani i ka vënë gjoksin e bashkë me ‘të dhe unë e ndonjë tjetër, kërkon një farë mbështetjeje, që ata që kanë mundësi, duhet ta japin, pa dëmtuar interesat e individit, të familjes dhe të komunitetit. ➡

➡ Fjalët e M. Shehut, shkruar në kujtimet e tij të luftës, gjithashtu tregojnë se Brigada e I Sulmuese nuk mund të dilte nga Martaneshi pa u ndeshur përsëri me “armiqët”. Mbeteshin aktuale, si gjatë luftës ashtu edhe në vitin 1978, ashtu edhe tërë periudhës së diktaturës komuniste.

Kur erdhi Ramiz Alia për vizitë në Martanesh 1987, i larguan dhunshëm gjithë “reaksionarët” e Martaneshit. Madje larguan nga fshati Peshk edhe ish-mësuesin Kujtim Balla, që e kishin pushuar sit ë deklasar nga puna, me gjithë gomarin e shtëpisë së tij, sepse mund të pëlliste pa prituri dhe të prishte fjalimin e Ramiz Alisë. Lufta e pamëshirshme e klasave dhe viktimat e saj përbënin anën tjetër të medaljes së krimit komunist për gjatë pesëdhjetë vjetëve. Burrat “reaksionarë” të Bamajve, Gricajve, Ballajve, Koçajve, Peshkajve, Dervishajve, Çelajve etj, s’i qasnin as në mbledhje, as në festa, as në punët më të përbuzura. Nënata, gratë shtatzëna e vajzat e rreshkura të krahinës niseshin

për në ara a me bagëtitë e kooperativës, ose në pyll dhe ktheheshin të raskapitura e të ngarkuara si kafshët me dru ose gjethe, duke përtytur rrugës misërniken e papjekur e të helmuar, të lyer me qullin e groshëve të kuqe dhe fëmijëve rakitikë e të uritur zgjasin duart për një krodhe bukë e një gotë dhallë. Dhe shpërblimi: As pesëdhjetë qindarka për një ditë pune. Apo valatosët e mjerë, që vdisnin për një pikë ujë, se dhe pika e ujit ishte më e shtrenjtë se kokrra e misrit.

NJERËZORJA

Sot pamja e ringjallur e Martaneshit, pamja e njerëzve të tij, e nënave dhe fëmijëve me fytyra të çelura, rrezatojnë atë që u mungoi aq gjatë; NJERËZOREN. Dhe ata e çmojnë mbi gjithçka qënien e tyre si njerëz të lirë e të respektuar.

“RINGJALLJE”, Tiranë 1995

Sefa, një libër ende i palexuar

➔ Dëshmitë gojëdhane, përpos dëshmime lëndore dhe dokumentare, me të drejtë janë trajtuar si fare pak të përfillshme në rrëfimin e historisë, por kur ato tregohen me vërtetësi dhe pa manipulime, vlera e tyre do të thosha se është e pallogaritëshme, sepse përveç sinjeritetit, kanë brenda edhe sentimentin e njeriut. Miku im i paharruar, at Zef Pllumi, ndjesë pastë, më pati thënë: *“Për mue nuk ka me kenë nevoja të ma bajë biografinë tjetërkushi, se unë ate e kam ba vetë me ato qi kam shkruar n’librat e mi, se jam mundue t’rrëfej atë qi kam ndje, atë qi kanë pa sytë e m’kanë ndigjue veshët e atë qi e kam provue n’kurrizin tem...”*

E solla këtë model, ngaqë desha të them, se dhe Sefedin Kurti, atë që di, ta rrëfen me përlulësi, ashtu siç e ka dëgjuar, siç e ka parë e jetuar, pa shtuar apo hequr gjë. Ai është dëshmitar autentik i së kaluarës dhe meriton të dëgjohet me vemendje e përgjegjësi, sepse jo kudo e kurdoherë e gjen të vërtetën, ngaqë më ka rastisur të hetoj se, në përgjithësi, ata që rrëfejnë, sipas rastit, ose shtojnë, ose heqin dhe rrëfimit të tyre i mungon diçka thelbësore, që nuk mund të kapërcehet dhe doemos, si në një problemë matematikore, përfundimi do të jetë i gabuar. Nga kjo sindromë jo rrallë janë molepsur edhe historianët.

Sefa është lindur në këtë vend, që është quajtur qysh herët Burrel dhe është rritur bashkë me ‘të, ndërsa fshati i dikurshëm po merrte përmasat dhe fizionominë e një qyteti të ri provincial. U ndërtua një xhami, ndërtesa e gjindarmërisë, burgu dhe godina e internatit “Mati”. Ato ishin shenjat e para që tregonnin, se këtu po lindte një qytet dhe do të ruajë emrin i fshatit nga po lindte. Dhe sido që të quhet Burreli, dikur fshat, pastaj fshat-qytet, dikur qytet-fshat dhe më në fund vetëm qytet, ku banorët e parë duhen konsideruar si ata, që e kanë përjetuar më tepër se të tjerët evolucionin e vendbanimit të tyre dhe për rrjedhojë janë qytetarët e parë, ose fshatarë që brenda një harku kohor jo më shumë se prej afro 30 vjetësh u bënë qytetarë. Këtë Sefa ta thotë me detaje të imta dhe me një vërtetësi të besueshme dhe është një dukuri tepër interesante për të cilën do të flasim një herë tjetër.

Dilaveri dhe Sefa ishin shtyllat ktyesore të shtëpisë, shtylla më e re kurrizore e kësaj familjeje në hullinë e traditës. Dilaveri, siç e kemi thënë, shkëlqeu qysh në fillimet e veta, duke zgjeruar hullinë e vlerave intelektuale, ndërsa Sefa, si më i ri në moshë, kishte prirje dhe interesa të tjera, por që plotësonin dhe mbështesnin të vëllanë në një mënyrë perfekte, falë unitetit dhe mirëkuptimit vëllazëror e familjar. Por befasi nga kjo familje në linjën femërore doli një këngëtare e madhe, e famshme Feride Kurti, që me zërin e saj të bukur melodioz dhe proverbial pushtoi si me magji zemrat e të gjithëve, jo vetëm në Mat e Gegëri, por dhe në rrafsh kombëtar, si një risi dhe monument i gjallë kulturor, në zëna fillën e lindjes së një qyteti. Në vazhden e saj bëri ca hapa edhe motra e saj, Vera, jo më pak e talentuar, por që s’e di pse u shmang, pa arritur të bëjë një karrierë të madhe si e motra.

Sefa, përveç se vëlla i Dilaverit, Ferides e Verës dhe i katër motrave të tjera, edhe

pse në një pozicion anonim, është njeriu i urtë, i ndershëm dhe më i padjallëzuar që kam njohur në Burrel. Si Sefa, s’e ve në dyshim, mund të ketë dhe shumë të tjerë, që me këtë rast dua t’i përgëzoj dhe tu uroj gjithë të mirat. Sefa nuk e di ç’është Epi i Gilgameshit, as ligjet e Hamurabit, Kodin e Justinianit, as Misteret e Kamasutrës, sepse ka bërë pak shkollë dhe është në një farë mënyre “argumentum baculinum”, një farë “ens a se a posteriori”, që ia vlen të dëgjohet për fjalët që thotë, mendimet dhe përvojën që ka. Ai e ka bërë ushtrinë në Pashaliman, kur aty ishte instaluar baza e flotës detare shqiptaro-sovjetike. Atje paska takuar një arkeologe ruse, e cila i ka folur për lashtësinë në luginën e Matit dhe ai është mbushur me krenari. Kur ka ardhur në shtëpi pas mbarimit të ushtrisë, në dhomën ku flinte me Dilaverin, ka parë ca trasta të varura në mure dhe xhakata të lidhura te mëngët të mbushura me eksponate muzeale, të mbledhura nga Dilaveri, që asokohe punonte sekretar në prokurorinë e rrethit.


Pas ushtrie Sefa ka filluar punën zdrukhtar në ndërmarrjen e artizanatit në Burrel. Pasioni për punimin e drurit i ka lindur qysh në rininë e hershme. Këtë zanat e ka marrë në ndërmarrjen e artizanatit, ku mësoi si bëhen sofrat, djepat, enët e bulmetit dhe të ujit. Aty gjeti njerëz të talentuar me duar të arta dhe ka përfutur shumë prej tyre. Nga ata që i kanë lënë më tepër mbresa, përmend Salë Cekën e Liman Kokën, por me konsideratë më të lartë flet për Kros Metën me të vëllanë, Asllanin. Për Krosin të thotë, se “*çfarë i shihte syri, ia bënte dora*” dhe si të thuash ishte inxhinier e kaluar inxhinierit, pa asnjë klasë shkollë. Kur ka shkuar atje si nxënës, Kros Meta e paska pyetur:

-A të pëlqen ky zanat, or mec? Sefa i ka thënë:

-Po. Pastaj Krosi i ka thënë atij:

-Merr këtë zanat, që s’të kërkon bukë, se ujku nuk ta ha, zjarri nuk ta djeg, uji nuk ta merr e hajduti nuk ta vjedh. Në fjalët e Kros Metës ngre krye një porosi e vyer dhe një amanet i madh, që të gjithë, sidomos të rinjtë, duhet ta mbajnë vath në vesh. Kështu, Sefa është rrekur të hyjë në rrugën e Kros Metës dhe është përpjekur t’i hedhë hapat sipas modelit të tij në jetë.

Për Krosin të thotë se ai bënte çarqe uji dhe projektonte kanale, të cilët janë edhe sot. Kur paska projektuar vijën në Lusën e Mallunxës, paska marrë pushkën e ➔



S. Kurti pranë maketit të tij të punishtes së barotit


← ka qëlluar. Dhe atje ku do të rrihnin plumbat, do të ishte shtrati i vijës së ujit. Menjëherë projekti i vijës së ujit, që do të kalonte nëpër një terren të vështirë me formacione shtufi, u bë gati dhe nisi puna, siç kishte thënë mjeshtri. Në ato ditë Kros Meta befasisht kishte zënë shtratin i sëmurë rëndë. Ndërkohë ujin e Lusës e futën nëpër vijën shkëmbore, por diku, ishte harruar pa u hequr një kunj dhe uji kishte mbetur në vend, pa mundur të ecë më tej. Në lëndinën nën hijen e një dardhe ishin mbledhur të gjithë dhe po prisnin ardhjen e ujit, që kishte mbetur në një pikë të vdekur. Një gojëleshuar u paska thënë të pranishmëve me arrogancë: hidhni një litar në atë dardhë e të varim aty Kros Metën. Fjala e maskarait kishte marrë arratinë dhe kishte shkuar menjëherë në veshin e mjeshtrit të madh, që dergjej në shtrat. Fjala i ishte ngulur si gozhdë prapa shpinës. Ai pastaj ishte ngritur, duke lënë shtratin dhe, si Gjergj Elez Alia, i hipur në kalë, kishte shkuar në Mallunxë dhe e kishte zgjidhur atë nyje, si Nyja e Gordit. Dhe uji kishte vazhduar udhën drejt atyre, që po e prisnin me padurim. Pastaj të pranishmëve u kishte thënë: *“Mos e hiqni atë litarin prej rremit të dardhës, se do tu duhet për të varë ata horrat, që kanë vetëm llafë e nuk punojnë”*. Dhe kishte hipur vetëtimthi përsëri mbi kale, si mbi kalin e legjendës dhe kishte ikur andej nga kishte ardhur për të zënë përsëri shtratin dhe pas një jave kishte ndërruar jetë, duke lënë midis të gjallëve një kujtim të bukur, si një hark triumfi midis legjendës dhe realitetit, ndonëse ai nuk dinte asgjë për Karl Gegën dhe nuk kishte kurrëfarë njohurie për gjeometrinë e Euklidit, apo të Lloçevskit.

Kros Meta, personazh gjysëm përrallor dhe jo larg legjendës, po një legjendë e gjallë, i ka shërbyer Sefës si etalon dhe udhërrëfyes për të ecur në rrugë të pashkelura, për t'i bërë punët mirë e më mirë, edhe përtej Kros Metës.

Sefa gjithë jetën, mbi një gjysëm shekulli, është marrë me bletën, drurin, natyrën dhe historinë. Me insektin më të dobishëm të universit është lidhur qysh në moshë të re dhe asnjëherë nuk e ka braktisur atë. Ka qenë krejt rastësi takimi i tij me bletën, që të jep mjaltin, por që s'ta kursen as thumbin, kur i bie në qafë. Thuhet në një urtësi popullore: *“Më thuaj me kë rri, të të them se cili je”*. Dhe po ashtu Sefa është thuar si bleta, që fluturon pa pushim nëpër miliona e miliona lule për të mbledhur mjaltin, këtë lëng viskoz e hyjnor, si nëpër Kopshtin e Edenit. Sefa të thotë se bleta i ngjan një shteti, që udhëhiqet nga një femër, që quhet mbretëreshë, ose ndryshe Mëma, që u jep jetë gjeneratave dhe me largpamësi drejton të gjitha punët e kësaj bashkësie të madhe, ku disa bartin ujin, disa nektarin, ca të tjera dyllin e polenin dhe disa të tjera vigjëlojnë për të ruajtur sovranitetin, që pak t'ua cënosh të kundërpërgjigjen, duke të ngulur thumbin. Kur mbretëresha nuk mund të pjellë më e as nuk është në gjendje të sigurojë vazhdimësinë, ata e rrëzojnë nga froni, duke sjellë aty një tjetër dhe krejt ashtu në mënyrë instiktive vihet në krye të punëve ajo që është më e zonja, duke marrë miratimin dhe “votën” e të gjithëve, pa luftë klanore, pa grindje, pa dinakëri e sherre, pa vjedhje, apo manipulime. Sa mirë do të ishte, të thotë Sefa, që zgjedhjet dhe punët e tjera të shtetit të ndërtoreshin sipas modelit të bletës. Po në shoqëri nuk ndodh kështu. Senatori i përjetshëm, italian i Xhulio Andreotti, me të drejtë ka thënë: *“Pushtetin e vuajnë ata, që nuk e kanë”*. Këtë e pranon dhe Sefa, ndërsa aspirojnë për një shoqëri ndryshe, ku maskarenjtë të mos të kenë mundësi të marrin në duar frenat e shtetit dhe ta çojnë popullin në greminë. Në këtë pikë ai është shumë i ndjeshëm dhe të rrëfen të gjitha maskarallëqet dhe paudhësitë, që janë bërë në Burrel në të shkuarën dhe sot. Po le të mbetemi te bleta, se Sefës nuk i intereson

shumë politika. Sefa bletën e mbarshtron më mirë se kushdo tjetër në Mat, por e kërkon edhe në gjirin e natyrës nëpër pyje ku ajo gjendet. Shkon te burimi i ujit dhe vëzhgon bletët, që venë e vijnë aty për të marrë ujë dhe në atë drejtim që ikin, ai lëviz drejt pyllit dhe duke kërkuar më në fund e gjen. Nuk ka gjetur një, po dhjetra e vit për vit. Pret me sharrë pjesën e drurit, ku ndodhet bleta dhe me gjithë fole sjell në park përkrah koshereve të tjera. Po të shkosh midis bletëve të tij, të syri trungje drurësh, ku hyjnë e dalin bletët, një gjë e bukur për syrin kureshtar të një vizitori.

Duke shetëguar në natyrë, si gjahtar pasionant i bletës, ai gjurmon edhe historinë që del nga dheu. I ka zënë syri diku një tjegull a tullë, një fragment ene prej balte të pjekur apo një objekt tjetër. Dhe ato ia sillte Dilaverit. Këtë punë ka bërë gjithmonë, madje dhe në këto vite që nuk është më Dilaveri. Ai në këtë mënyrë ka shkëlur krejt luginën e Matit e nëpër gjithë kurorën malore, nga Biza në Ferrë-Shkopet, nga Deja në malin e Kaptinës e nëpër kurrizet malore prej grykës së Shkopetit e



Maket i çarkut të ujit punuar nga S. Kurti

gjer në pyjet e Malit me Gropa. Ka vizituar të gjitha kalatë e qytezat dhe vendbanimet. Ka qenë Dilaveri ai që e ka futur në këtë rrugë. Sipas porosisë së Dilaverit, ka qenë i pari që ka shkuar te vendbanimi shpellor i Bruçit. Pasi ka gjurmuar të gjitha shpellat dhe ka hyrë edhe brenda në 'to, ka sjellë prej andej një mori fragmente enësh e mbeturina të tjera antike dhe i ka dërguar në muze. Këtë e ka bërë pa asnjë lloj shpërblimi.

Mbi bazën e këtij informacioni paraprak, më pas në këto shpella u kryen gërmimet arkeologjike, nga ku u përfitua një material i bollshëm e me vlera të mëdha për historinë e antikitetit. Sefa me modesti nuk don të rrahë gjoksin e të krenohet, që këtë e ka zbuluar ai dhe vetëm ai, po me këtë rast ai don tu japë mesazh të gjithë atyre, që me paturpësinë më të madhe hedhin baltë mbi të tjerët dhe denigrojnë punën e tyre, duke gënjyer e shpifur gjithëfarëlloj alibish, sikur gjoja atë zbulim e të tjera të këtij lloji i kanë bërë ata, kur në të vërtetë as që kanë marrë mundimin për t'i pare. Dhe, më e keqja, as nuk dinë se ku gjinden ato.

Sefën e ka lidhur me historinë edhe puna me drurin. Dilaver Kurti ishte i pari që gjurmoi dhe studjoi zejen e punimit të barutit në Mat. Po si ishin këto punishte që bënë barutin, këtë lëndë aq të kërkuar si buka për armët e zjarrit në atë kohë? Sefa, me porosi të Dilaverit, ka shkuar në Kryemat dhe është takuar me të moshuarit që kishin ushtruar këtë zeje, me Sadik Kacelin në Bel, Mahmut Halilin në Dars dhe Llaveshajt në Fshat dhe, pasi është konsultuar me 'ta e me ndihmën e Dilaverit, ka ndërtuar maketin e dingës së barutit. Jo një, po katër të tillë ka bërë. Më të fundit e ka në shtëpi. Kur u xhirua filmi "Flaka e maleve", u përdor maketi i tij. Ai e riprodhoi me përpikmëri këtë mekanizëm me vlera unikalë, që evokon historinë dhe ngjall kureshtje. Po ai ka bërë dhe maketin e valanicës, një mekanizëm që në të kaluarën përdorej për të ngjeshur shajakun, që thurej në avlemend e më së fundi është përpjekur të ndërtojë maketin e një mulliri, që është përdorur në të kaluarën në një zonë ku nuk kishte ujë, ku punën që bënte uji, e bënin kuajt. Dhe të gjitha këto i ka bërë për historinë e në të njëjtën hulli përkrah Dilaverit.

Sefa, ky njeri i veçantë, që nuk pi kafe, cigare, as alkool, as që e ka problem për të vrarë kohën me lojëra e në


kafenetë e tymta, por do ta shohësh gjithmonë në punë, në lëvizje e në shtegëtim dhe doemos që koha nuk i mjafton dhe as që ka kohë për të vrarë, sikurse shumë moshatarë të tij, që koha i ka nxjerrë në pension dhe u duket vetja si limonë të shtrydhur.

Por nuk është i qetë dhe as që do të jetë ndonjëherë, sido që shkel dhe jeton mbi tokën e vet, që e ka trashëguar nga të parët, por që "barbarët" ia kanë dhunuar e grabitur, sipas ligjit të xhunglës, kur dihet nga të gjithë që *de jure* prona është e shenjtë, por *de facto* fatkeqësisht ende jo. Në këtë lojë kanë pjesën e vete dhe institucionet, madje do të thosha pjesën e luanit. Ai është si bleta dhe s'mund të jetë ndryshe. Një herë i ka rastisur të kacafytet me një zyrtar, në përputhje me të drejtën e vet e sipas kodit të bletës, e për pak ka shpëtuar pa u thyer një kompjuter. Kjo s'duhej të ndodhte, po ja që ka ndodhur e vetëm për arsyen e thjeshtë se Sefa nuk është si Don Kishoti, por si bleta, që të jep atë që meriton.

Po ka dhe një merak, që nuk e fsheh e një revoltë, që nuk mund ta përmbajë, nga që është mbushur me mllëf, kur në muze ka parë përdhosjen e historisë dhe shkatërrimin total të gjithë atyre vlerave, të mbledhura me aq mund e sakrifica. Sot në muze ai nuk sheh asgjë nga gjithë ajo punë voluminoze që pati bërë Dilaver Kurti për vite me radhë dhe aspiro që aty të vijë një dorë e fortë, si dora e Dilaver Kurtit për të vendosur aty ku duhet dinjitetin e përdhunuar të historisë. Edhe don ta ngrejë zërin gjer në kupë të qiellit, po ç'e do se nuk e dëgjon njeri.

Jo pak e trishton edhe fakti, kur të ashtuquajturit historianë hedhin baltë mbi njeri-tjetrin dhe shkelin me paturpësinë më të madhe mbi veprën e Barletit, duke e çvendosur vendori gjinën e Kastriotëve dhe të Skënderbeut nga një krahinë në tjetrën pa kurrëfarë kriteri shkencor, po ashtu si në një lojë toreadorësh luajnë me heroin kombëtar si me një mollë sherri në qorrsoakun e historisë.

Më në fund them, se Sefedin Kurtit nuk mund t'i gjindet pranë një tjetër për ç'ka bërë dhe don të bëjë përkrah të *vëllaut*, pa mëdyshje do ta quaja nderi i këtij qyteti, pa çka se na janë errur sytë për shkak të paragjyimeve dhe sindromës së etheve për tu pasuruar në arenën banale të materializmit vulgar e për të nxjerrë sytë e njeri-tjetrit, si në mitet e lashtësisë.



Maket valanicës punuar nga S. Kurti



Maket i mullirit me kalë punuar nga S. Kurti

MATI DHE RESURSET NATYRORE

Haziz PORJA



Rrethi i Matit shtrihet në jug të zonës verilindore të Shqipërisë. Qendra e tij, qyteti i Burrelit, me rrugë automobilistike ndodhet rreth 96 km larg nga kryeqyteti ynë, Tirana, me të cilin kufizohet në jug-perëndim dhe rreth 20 km në vijë ajrore. Për të shkuar në Mat, duke u nisur nga Tirana, rruga kalon nëpër fushat e bukura e të begata të Krujës e Kurbinit dhe pastaj në Milot do të kthehesh djathtas, buzë lumit të Matit, duke kaluar përbri urës muze, të Zogut, tuneleve dhe liqenive të bukur të Shkopetit e Ulzës. Me të arritur në qafën e Ulzës, prezantohesh me luginën e Matit, që shtrihet në të dy anët e lumit me të njëjtin emër. Përrreth saj ngrihen madhështorë në formë kurore malet, që e kufizojnë këtë rreth.

Matit është një zonë me klimë mesdhetare tranzitore, që fillon nga lartësia 132 m mbi nivelin e detit, në liqenin e Shkopetit, deri në 2 246 m në majën më të lartë të malit të Dejës. Është luginë me kundrejtim kryesor veriperendimor, por në detaje ka dhe kundrejtime të tjera lindore. Nga vetë pozicioni gjeografik dhe zona fito-klimatike, në të cilat shtrihet, është zonë shumë e pasur nga ana natyrore, përta i përket biodiversitetit, por dhe pejsazheve që krijojnë këtë larmi biodiversive të ndërthurura me orografinë dhe resurset natyrore të shumta. Vendet piktoreske, pejsazhet e kësaj zone fillojnë që në hyrje, në luginën e bukur të Shkopetit, ku ndodhen dy liqenet artificialë, mbi të cilët ngrihen dy hidrocentrale. Këto liqene me ujë të pastër të lidhur njëri pas tjetrit, me shpatet e bukura, me pyje përreth dhe me tunelet e shkëmbinjtë e bukur në të dy anët, krijojnë një kompleks piktoresk të vlerësuar jo vetëm nga turizmi vendas, por dhe të huajt. Vlerë tjetër e madhe e kësaj zone është luginë e lumit Mat dhe brigjet e bukura e të veshura me pyje, me gjatësi rreth 40 km dhe frekuentohen, sidomos gjatë verës, për plazh e pushime nga vendasit dhe udhëtarë të ndryshëm e turistë, që kalojnë dendur në këtë zonë. Në perëndim të rrethit të Matit, në kufi me Krujën, shtrihen pyjet e Qafë-Shtamës dhe të liqenive të Germanit, që me bukuritë e tyre dhe vlerat kurative e turistike kanë mbi 70 vjet që përdoren si vend pushimi, shlodhjeje dhe kurimi, në veçanti për njerëzit me sëmundje të mushkrive. Në jug të kësaj zone ndodhen masivet e bukura pyjore e kullosore të Martaneshit, nga të cilët buron lumi i Matit, resurse këto, që bashkë me disa liqenij akullnajorë, me kanionet e këtij lumi, malet dhe shkëmbinjtë e lartë, i japin vlera

pejsazhit të kësaj pjese të zonës. Në lindje dhe verilindje të zonës së Matit, rreth 40 km larg nga qyteti i Burrelit, shtrihen malet e bukura të Dejës e Balgjajt, me një biodiversitet të lartë natyror, me liqenij të bukur akullnajorë, propozuar për zona të mbrojtura, të cilat janë të kufizuara me perlën natyrore shqiptare të Lurës. Në mes të këtyre masiveve të bukura ndodhet dhe rezidenca e Kastriotëve, kalaja e Stelushit, monument historiko-kulturor i shqiptarëve.

Pozicioni gjeografik, orografik, ndërtimi gjeologjik dhe biodiversiteti natyror, i japin Matit vlera të panumërta panoramike, që duhen ruajtur, trajtuar dhe reklamuar. Që këto resurse të kenë vlera në rritje dhe perspective, duhet infrastrukturë.

VLERA FLORISTIKE DHE FAUNISTIKE

Siç përmendëm, zona e Matit ka vlera të mëdha me leverdi ekonomike, shoqërore dhe ekologjike. Pozicioni gjeografik, klimaterik, edafik etj, krijojnë mundësi dhe kushte natyrore për një florë dhe faunë të pasur e të larmishme. Kjo zonë ka një sipërfaqe rreth 100 000 ha, nga e cila rreth 60% është e veshur me lloje pyjore dhe barishtore, rreth 56 000 ha sipërfaqe pyjore dhe rreth 4 000 ha sipërfaqe kullosore. Në këtë zonë rriten masive të mëdha dhe të pasura me pyje, ku shquhen ahu, dushqet, pisha, arneni, rrobulli, lloje të tjera fletore e halore dhe ka një sasi të madhe shkurresh të ndryshme mesdhetare. Këto, si dhe livadhet e kullotat përreth, rrisin në gjirin e tyre mbi 3 000 lloje drusore e barishtore. Ndër kryesoret përmenden pisha (pinus spp), bredhi i bardhë (abies alba), dushku (quercus spp), gështenja (castanea sativa) panja (acer spp), frashëri (fraxinus spp), mëlleza (ostrea carpinifolia), shkoza (carpinus spp), lajthia (corylus spp), dëllinja (juniperus spp), murriza (crataegus spp), bliri (tilia spp) dhe lloje të tjera të rralla, si krekeza, krifsha, ulëza, mareja, rrap, vërrini, vidhi, trëndafili i egër, kulumbria, shelgjet, plepat, thana, fshikëkartha, gorricat, dardha e egër, molla e egër, vodha e egër, boshtra (forsythia europea), driza (paliurus spina-kristi), fermana, rrushkulli etj. Përveç florës drusore kjo zonë është shumë e pasur dhe me florë barishtore, graminace dhe leguminoze të ndryshme, ndër të cilat përmendim festuca sp, poa sp, lolium sp, bromus sp, dactylis glomerata, trifolium sp, vicia sp, larythus, lotus corniculatus, medicago lupulina, geranium spp, ranunculus spp, verbascum spp, plantago spp,

veronica spp, bellis perenis, achillea millefolium, helleborus, urtica dioica, salvia officinalis, tymus, teucrium, centaurea, silyba, sedum spp, euforbia spp, dixhitalis spp, sanguisorba officinalis, primula acaulis, agrimonia eupatoria, ononis spinosa, gentiana, liliun, stacys, hypericum, capsella bursa-pastoris, taraxacum officinale, tusilago farfara, saturea montana, campanula etj. Nga këto lloje, përveç vlerave të mëdha ekologjike, ekonomike, turistike, një pjesë e tyre kanë dhe vlera mjeksore, sepse këtu rriten mbi 150 lloje bimë medicinale, që grumbullohen e tregëtohen. Në këtë zonë takohen pothuajse të gjithë llojet e kafshëve dhe shpendëve të egër: ariu i murmë (ursus arctos), ujku (canis lupus), dhelpra (vulpes) lepuri i egër (lepus europaeus) si dhe më rrallë: vjetulla, ketri, kunadhja zardafi, macja e egër, derri i egër, nusja e lalës, dhia e egër, kaprolli, riqebulli, lundra etj. Ndërsa nga shpendët më të përhapur janë thëllënxa e malit, mëllenja, harabelat, shapka, pëllumbat, laraskat, grifsha, korbat, sorra, shqiponja, skifteri etj. Gjendja aktuale dhe kushtet stacionale në rigjenerim premtojnë për shtimin e faunës së egër, për rrjedhojë dhe të asaj për gjah, nëse do të trajtohen sipas kriterëve tekniko-ligjore.

Kjo zonë, duke patur liqenin e Ulzës dhe të Shkopetit, lumin e Matit, disa rezervuarë artificialë, liqenet natyrore, malorë dhe shumë burime të mëdha ujore, ka aktualisht sot, por ka dhe perspektivë për shtimin e shumë lloje peshqish, sidomos troftën në Bruç, krapin, qefullin e blinin në Ulzë etj. Treva e Matit është shumë e pasur në burime natyrore me vlera të mëdha ekonomike, turistike, ekologjike, gjenetike etj. Si pjesë e një biodiversiteti të larmishëm dhe të pasur kemi edhe disa lloje endemike shqiptare si zambaku shqiptar (lilium albanicum) në Dejë e zona të tjera,

festucopsus albanicum, genista hasertiana etj. Në zonën e Dejës dhe të Mbasdejës rriten lloje të rralla si rrobulli (pinus heldreigi), arneni (pinus peuce), lajthia e egër (corylus colurna), tisi (taxus bacata), i cili jeton deri në 4 000 vjet. Në vitin 1976, në zonën e Mbasdejës, në vendin e quajtur Hurdha e Thellë, është prerë një ekzemplar rrobulli me moshë 860-vjeçare, me diametër 220 cm dhe lartësi 32 m. Mendohet se në këtë zonë ka pasur dhe mund të ketë ekzemplare rrobulli dhe më të vjetër se ai që përmendëm. Treva e Matit, natyra e saj e bukur dhe e pasur, biologjikisht, përveç perlave natyrore të Dejës, Mbasdejës, Zall-Gjoçajve, Balgjajt, Qafë-Shtamës, Martaneshit, Gurit të Bardhë, Trodhnës, liqenjtë të Germanit, masiveve të bukura dhe të mëdha të lisit, pyjeve shekullore të geshtenjës, ka dhe pasuri të rralla natyrore ujore me vlera turistike e shëndetësore, si liqeni i Ulzës dhe i Shkopetit, liqenjtë e bukur të Balgjajt, liqeni i Lopëve dhe ai i Fushës së Gurit në Mbasdejë, liqenet e Balgjajt, të Cerujës, liqeni i Sopeve, i Germanit dhe Batrës etj. Në Mat ka burime të mëdha dhe të bukura ujore si ato të Mbasdejës, të Livadhit të Gjonit në Zall-Gjoçaj, Gurra e Varme në Vinjall, Gurra e Shëlliut, Shutrreja në Bruç, pa harruar asnjëherë ujin më të mirë me vlera kurative dhe shumë të ftohtë të kroit të Bardhë në Mbasdejë, kroi i Nanës Mbretneshë në Qafë-Shtamë, Kroi i Gjeneralit në Linos, burimet e Balgjajt, të Martaneshit, Gurit të Bardhë, Xibrit, Qafë-Shtamës, Gurrës, Shkopetit etj, të njohur dhe të frekuentuar për vlera të tilla.

Kjo zonë ka pasur në vitalitetin e saj lloje të rralla dhe mahnitëse të kafshëve e shpendëve të egër, që për ca kohë arritën deri në zhdukje. Por, për fat të mirë, natyra nuk bie prë e qëllimeve të mbrapshta dhe antinjerëzore të disa individëve, që në vitin 1992 këto lloje kanë filluar të shtohen në disa zona, si kaprolli, derri i egër, dhia e egër, riqebulli, macja e egër, pula e gjeli i egër, shqiponja, thëllëza e malit etj. Vemendje e veçantë dhe kontroll i rreptë duhet vendosur për mbrojtjen dhe shtimin e llojeve të rralla, si derri i egër, kaprolli, dhia e egër dhe të llojeve të tjera, si lepurit dhe thëllënxa.

POTENCIALET EKONOMIKE

Zona e Matit ka potenciale të konsiderueshme ekonomike, kryesisht natyrore, por dhe industriale, bujqësore etj. Të ardhurat më të mëdha në zonën e Matit realizohen nga burimet minerare, konkretisht të kromit, që në këtë zonë ka pasur dhe mendohet të ketë rezerva të konsiderueshme. Nga minierat e shumta merreshin rreth 40% e të ardhurave të zonës, rreth 20% e të ardhurave siguroheshin nga shfrytëzimi pyjor dhe nga pyjet, kurse pjesa tjetër vinin nga bujqësia, blektorja, energjia elektrike dhe tregtimi i mallrave të ndryshëm. Vot nuk është

më ky raport të ardhurash. Pjesa më e madhe e minierave janë të mbyllura, ose nuk kanë më kapacitetet prodhuese e tregtuese të mëparshme. Shfrytëzimi pyjor dhe prodhimet e tjera pothuajse janë të mbyllura, ose prodhohet në masë fare të vogël. Ka shumë pak të ardhura nga bujqësia e blektorja, sepse në këtë sektor nuk ka politika të qarta dhe përkrahje ekonomike. Fermerët nuk kanë mundësi ose interes që të investojnë. Përsa i përket të ardhurave nga turizmi, nuk ka programe dhe planifikime të qarta, por dhe pse ka resurse të tilla, infrastruktura ose investimet në këtë drejtim janë të papërfillshme.

SITUATA AKTUALE DHE SHFRYTËZIMI I VLERAVE

Përmendëm më lart të gjitha burimet natyrore dhe të tjera që ka zona e Matit dhe vlerat e tyre, duke cilësuar se janë shumë të larta për komunitetin e kësaj zone dhe ekonominë kombëtare. Aktualisht të gjitha këto resurse mbeten të pa shfrytëzuara dhe vetëkuptohet që nuk i kanë më ato vlera për dy arsye kryesore:

-Së pari, në këtë rreth nuk ka politika dhe investime qeveritare për t'i vënë në efikasitet këto vlera.

-Së dyti, biznesi dhe investitorët vendas nuk i kanë mundësitë financiare për t'i kthyer në rentabilitet këto pasuri natyrore dhe industriale të zonës.

Në zonën e Matit jetohej vetëm me pak të ardhura nga prodhimet bujqësore e blektorale. Shumë pak njerëz punojnë në miniera e shfrytëzim pyjesh, po kështu shumë pak paguhën nga buxheti i shtetit. Ato pak njerëz që kanë mbetur në Mat mbahen në nivelin e mbijetesës vetëm me të ardhurat nga pjestarët e familjeve të tyre në emigracion. Zona e Matit, duke qenë shumë e pasur nga natyra dhe resurse të mëdha, vetëm për mungesë politikash ekonomike, efikase dhe mungesë financimesh të biznesit lokal, kombëtar dhe të huaj, mbetet padrejtësisht një zonë e varfër, ku banorët janë detyruar të shpërngulen masivisht në metropolin shqiptar, ose jashtë vendit. Kësaj i thonë: "Këmbë zbathur mbi florinj". Në burimet natyrore të Matit, dy periudha kanë qenë më tragjike.

-E para, në vitet '60 deri '80. Me fillimin, deri në falimentimin e sistemit ish-kooperativist, pyjet e ulta, sot pyje komunale, u shkatërruan deri në degradim të plotë nga ky sistem për dru zjarri dhe nga kullotja pa kriter. Në këtë periudhë pyjet e kullotat vajtën deri në 20 000 ha.

-E dyta, në periudhën e tranzicionit. Mosfunksionimi i shtetit, shpeshherë dhe nga abuzimet për qëllime përfitim të drejtuesve të pyjeve, pushtetit lokal dhe të specialistëve të kësaj fushe, si dhe nga egoizmat, xhelozitë, konfliktet e pronësisë, masive të mëdha pyjesh u dëmtuan nga prerjet apo u dogjën, duke shkaktuar një dëm të madh të

pariparueshëm, jo vetëm ekonomik, por, aq më keq, ekologjik, me pasoja për pyllin, tokën, klimën, ujërat nëntokësorë dhe mbitokësorë, infrastrukturën, qendrat e banuara dhe akoma më keq, për kulturën sociale, që mendohet të kultivohet në shoqërinë e sotme për këtë pasuri. Si rezultat, u prenë pa leje në mënyra shumë barbare, u dogjën dhe u shitën me çmime qesharake masive të mëdha pyjore, lloje të rralla e me vlera, duke shkaktuar gati një katastrofë natyrore në pyjet e Mbasdejës, Zallë-Gjoçajve, Balgjajt, Martaneshit, Qafë-Shtamës, Gurit të Bardhë, Liqenjtë të Germanit. Trodhnës, Hurdhë-Tolles etj. Këto masive pyjorë, për ata që i kanë njohur dhe i kanë mbrojtur për dekada të tëra, ka qenë një krim i pafalshëm dëmtimi dhe djegia e tyre. Të gjitha këto masive arrijnë një sipërfaqe rreth 5 000 ha. Por, theksojmë dhe njëherë se natyra bën mrekulli, duke iu kundërpërgjigjur veprimtari keqbërës të njerëzve. Ndaj në këto zona, për fat të mirë, në 60-70% të tyre, ka shenja rigjenerimi të këtyre grumbujve në mënyrë natyrore, në disa ngastra në mënyrë tepër simbolike. Duhet theksuar se 60% e pyjeve dhe kullotave kanë kaluar në përdorim dhe pronësi të pushtetit lokal. Me kënaqësi mund të thuhet se, rreth 80% e tyre janë rigjeneruar dhe vazhdojnë një rrugë të tillë, falë marrjes në pronësi nga ish-pronarët, ose ndarjen me vendime të fshatit. Kështu, pyjet jo vetëm janë rigjeneruar, shtuar në sipërfaqe, por dhe janë bërë burim i madh të ardhurash e vlerash të tjera për komunitetin rural, si për kullota, dru zjarri, lëndë ndërtimi etj. Ato janë bërë të favorshëm për gjah, turizëm dhe rekreacion, mbrojtjen e tokës, ujrave e rrugëve, përmirësimin e klimës, të ujrave freatikë, si dhe në shumë funksione të tjera, që po t'i dinin njerëzit, do të sillleshin shumë më ndryshe me pyllin dhe gjithë burimet natyrore.

Në qoftë se do të merren masa me efikasitet, jo vetëm matjanët do të kthehen në vendin e tyre, por do të ketë nevojë dhe për të tjerë që të shkojnë e të punojnë, ndoshta dhe të jetojnë në këtë zonë. Sikundër theksuam, arrihet në konkluzionin se kjo zonë është lënë pas dore në të gjitha drejtimet, nga vetë matjanët, pushteti lokal dhe ai qendror. Kjo është padrejtësi që i bëhet kësaj treve. Edhe ato pak njerëz që investojnë e jetojnë në Mat, me të ardhura të konsiderueshme, që kanë bindjen dhe dëshirën për të punuar e jetuar në këtë zonë, ndjehen të vetmuar, pa përkrahje dhe punojnë me sakrificë. Megjithatë, sidomos kohët e fundit, kanë filluar shkëndijat e para të këtyre investimeve dhe rendimentet janë të kënaqshme, frutdhënëse dhe perspektive.

Letërsi



Basir BUSHKASHI

Mimozat e kujtimeve

Nga vëllimi me poezi të zgjedhura në proces botimi

FRYN KJO ERË E FUSHËS

Nëpër degë të kumbullës
i çoj fjalë të bukurës;
një djalosh këndonte
fshatit në të mugët.

Fryn kjo erë e fushës
dehur nga gjelbërimi,
një thëllëzë dëgjon
seç i thotë bilbili.

Dhe diku një portë
hapet me ngadalë
del një vajzë e bukur,
del një vajzë e bardhë.

Kumbulla derdh petale
si për nusëri.
Prehëri i saj bleron
mall e dashuri.

KUNGULLI

Shoh një kungull të fryrë në arë,
thua se misri e paska zili;
dhe më sjell ndër mend ndonjë zyrtar
që në zyrë merr pamjen e tij.

LULJA

*"Kur pata një lule t'bukur
thash' se do ta kem përherë".*
Erdhi kjo këngë nëpër vite
mbushur mall e mbushur brengë.

Ne s'e dimë se ç'fat i hidhur
e gremisi dashurinë,
ndoshta ish kanuni i egër
a dikush shpirtzi, s'e dimë...

Veç dikush për ty me dhimbje
ngriti këngë e në këngë të la,
brymë e viteve s'të veniti
malli i tij kurrë s'të la me u thà...

ISH VJESHTË E GJETHET SAPO BININ

Ish vjeshtë e gjethet sapo binin
dhe malet thinjeshin nga bora e parë!
një tufë patash qiellit iknin
duke lënë pas frushullimën e bardhë.

Duke kundruar këtë pamje vjeshte
befas n'stacion u shfaqe ti,
sikur ta ndieje që unë të prisja
një copë pranverë të sillja aty...

PROLOG

Në jetë
kam ndier
dhe gaz
dhe brenga.

I urtë,
i sertë
i heshtur,
gazmor.
Ndoshta, prandaj,
më mori
dhe kënga.

E t'qetë,
s'e ndiej
kurrë kraharorë...

DIMËR NË MALLUNXË

E frymëzuar, hap pas hapi,
era gjethet seç i ndjek
Loz e loz kreshpëruar,
herë i ndanë, e herë i mbledh
E pastaj lozonjare,
palë-palë ngado i hedh
Gjersa bien lodhur-lodhur,
sa i mbulon harrimi krejt...

Bora e parë, sipër malesh,
nis e bie, zbardh e ndrin
Përmbi krye të kaprovje
radhë-radhë kaq qirinj...
Nusëron bredhi e pisha,
hedhur vellon madhështore
Thua vallen tok po ngrenë
si të zënë dorë për dore.

Pa rrjedh lumi plot zhurmime,
melodios, jo si më parë
Si poet mbushur frymëzime,
që shpërthen me varg të bardhë
Ja, për qiellin e përhimtë,
me rë dimri të ngarkuar
Seç po thotë dallgë pas dallge,
ja, ashtu duke zhurmuar...

Unë eci pragut dimrit
me fletore e laps në xhep
Një tufë zogjsh, shpupurisur,
dhe për pak më ngre me fletë
Nëpër ngricë, tokës mardhur,
jeshilon gruri i ri
Ç'mbet nga dimri për të shkruar,
ja, pranvera përsëri...

FLUTUROI NJË ZOG I BARDHË

Fluturoi një zog i bardhë
Fluturoi dhe qiellit humbi
Nëpër dallgë kaltërsie
Nëpër retë ngjyrë plumbi

Unë e ndoja ziliqarë...
Të bukurin shpend nëpër hapsirë
Fluturoi si ëndërr e bardhë
Fluturoi si një dëshirë...

FËSHFËRIN PLEPI I GJELBËR

Fëshfërin plepi i gjelbër
Prehërit të erës rreth e qark
Seç më zë një mall i vjetër
Që më hedh në vite larg.

Më zë malli e humbas
Nëpër vite, nëpër jetë
Që shkollar në gjimnaz
Diç më fsheh i shtrenjti plep.

Diç më fsheh e diç më ruan
Tek derdh pushin si kujtime
Plep, o plep, vallë a s'më thua
Mos është shfaq prap mikja ime.

Fëshfërin plepi i gjelbër
Dhe lot kryet nëpër erë
Më s'është dukur, ngjan se thotë
Ajo vashëz si pranverë.

Fëshfërin plepi i gjelbër
Fëshfërin e fëshfërin
Vallë era i dridh fletët
A i dridhi malli im...

1991

KËNDOJNË DY BILBILË

Këndojnë dy bilbilë dehur dashurie
Mbretër përmbi mbretër ndihen në
korie...

THUA, VËRTET?

Çudi, vërtet
Si u ftohëm bashkë
Dikur,
(ti e di)
Pa njëri-tjetrin
Ndjeheshim të zbrastë

Ti magjistare
A unë magjistar
Na mrekullohej
Çdo gjest, çdo fjalë...

Tani,
unë tjetër grua
Ti tjetër burrë
Veç urës kujtimeve
shembur çdo urë
Thua vërtet
u deshëm dikur?!!

VEÇ VAJZËS QË DESHA

Iu luta lules
-Çil për mua
Dhe lulja çeli.

Iu luta qiellit
-Kaltëro për mua
Dhe kaltëroi qielli.

Iu luta pemës
-Gjelbëro për mua
Dhe pema gjelbëroi.

Iu luta detit
-Dallgëzo për mua
Dhe deti dallgëzoi.

Iu luta zogut
-Këndo për mua
Dhe zogu këndoi.

Iu luta lumit
Fresk e vullë
Dhe lumi më dëgjoi.

...Veç vajzës që desha
S'ju luta kurrë
T'më ndjente për burrë...

IKËN DY PËLLUMBA

Ikën dy pëllumba
E unë u shqetësova
Se ikën të trembur
Nga hapat e mi.

Pas pak qetësohem
Se fundja thashë
Vërtet ikën
Po ikën bashkë...

A TË KUJTOHET?

A të kujtohet tregimi "Yjet"
(Nga Alfons Dodë aq bukur shkruar)
Dhe Stefaneta e bukur mbi kalë
Që fjeti në stan me gunë mbuluar

Po ai bariu i lumturuar
Kur gjoksit ndjeu frymëmarrjen e saj
Dhe unë që të thashë, ashtu si
kaluar...
Ç'do të desha dhe unë bariut t'i
ngjaj...

E sjellë ndërmend? Patjetër e sjell
Ti heshtje menduar, skuqur prush
Unë s'dija ç'të bëja, vërshëlleja ngadalë
Dhe lule s'koti, këpusja në fushë

Qiellit të kaltër një mjelmë e bardhë
Rrihte krahët e bukur në erë
Ti kokën e ngrite e the ngadalë
"A s'ngjan me nuse, pa shihe
njëherë..."

DINJITETI

Përbaltet dinjiteti
Nëpër llum të kohës
Njerëz-
Vini gishtin kokës...

KEQARDHJE PËR BOTËN

Bota ha veten
Tmerrësisht çdo ditë
Nga krimet,
luftërat,
pabesitë.

MIMOZAT

Kanë çelur mimozat nazike,
Dimër. Acar.
Një borë e butë,
Qeleshe mbi ballë...

Nuk di pse mimozat,
I quajnë mendjelehta,
Pse vallë s'përfillin dimrin?!
Të brishtat mimoza!
Krifëverdhat mimoza!
I admiroj,
Për guximin...

PLAKAE PËLLUMBAVE

Jeton vetmuar në Barberino
Një plakë e urtë, e kërrusur, e paktë
Në shtëpinë e vjetër, gati të harruar
Ku pëllumbat gugasin ditë e natë...

Ajo i ushqen me bukë e grurë
Pëllumbat e egër gjithë fëshfërimë
Që e zgjojnë mëngjeseve kaq të urtuar
E i ulen mbi supe, mbi krahë dhe
shpinë...

Kur sytë do të mbyll një mbrëmje a
mëngjes
Ndoshta pa t'afërm, e paktë, e vjetër
Përlotur pëllumbat do ta ngrenë në krahë
Në udhëtimin e fundit par në botën
tjetër...
Barberino, Firence, korrik 2006

N'U PAFSHIM NDONJËHERË

N'u pafshim ndonjëherë
Nëpër mote
Nëpër jetë
Nuk ka pse të shkrepim
Siç shkrepin rrufetë...

Asgjë e jashtëzakonshme
Mes nesh s'ka ngjarë
Në u tret dashuria
Si përrua i tharë.

Megjithatë,
Diçka e jotja
Tek unë ka mbetur
Diçka e imja
Tek ti gjithashtu...
Eh, sa e çuditshme
Bota njerëzore
Ndarë copa-copa
Aty-këtu...

NËPËRDALLGË

Dallgë brenda meje...
Dallgë brenda teje...

Dallgë nëpër dete
Dallgë nëpër shtete...

Me gjoksin me plagë...
Shtegtoj nëpër dallgë...

Duke mbart me vete
Qindra e qindra derte...

VERË NË SELANIK

Eci rrugës nëpër Selanik
Mbështjellë me natë
Mbështjellë me dritë...
Pamje marramendëse
Që të verbojnë sytë...

Diku buzë detit çlodhem i qetë
Përpara meje një park i blertë,
Ku shkrihen në një dashuritë e njoma
Në avuj rinie,
Në zjarr e aroma...

Deti oshtin e i përkëdhel me dallgë
Eh, ç'natë e këndshme, eh, ç'natë...!

BASTUNËT

Bastunë të fildishtë
Dyqaneve varg,
Punuar me art.

...Nëpër vegime
Më shfaqet im atë,
Me shkopin e drunjte,
Me kollën e thatë...

I shoh në heshtje
E pikëllimi më zë
Babai s'është më...



Qemal CENAJ

Rrugë pa rrugë (Fabula)

BUFIDHE BILBILI

Nëpër pyll bufi
bilbilin ç'po shan,
këngë këndon gjinkalla,
gjithë ditën s'ia ndan.

Ju sulën gjithë shpendët:
-S'mund ta vlerësosh
këngën,
sepse buf kënete
ke babën dhe nënën.

UJKUDHE DHELPR

Ujku dhe dhelpra
në seancë gjyqsore,
jo e hëngri ujku,
jo, po ti e more...

Trupi gjykues vendos
të jepet e drejta,
hajdut shpallet njëri,
skile mbeti tjetra.

PAS SHKOLLËS

Tha gomari:
-Të kthjellët e kam zënë,
do të shkoj në shkollë,
t'mësoj pentagramë.

Brez pas brezi trashëgim
soji ynë bën muzikë,
që të marr një diplomë
vallë s'paskam meritë?

Kur u kthye nga shkolla,
s'pranoi më samar,
as kapistër jo.
-Shihni, -tha, -kam
kollarë...

S'pranoi të bënte muzikë
siç qe më përparë.
-Tani që kam diplomë
dua të jem kryetar.

PATKOI

Patkua këpucën
që bën kovaç ustai
i zoti ia veshi kalit.
-O zot, na le me shëndet
ustain tonë,

që kur të vihesh në krye
të pushtetit
këpucë nga dora e tij
t'i veshim kryetarit.

PESA DHE TRESHI

Numri pesë tha për treshin:
-Hyj tek ai tak-fap...
I thotë treshi:
-Ti hyn sak,
po t'përdredh unë
njerin mustak.

FAKTORËT

Bualli dhe buallica
shamatën ç'e ngrehën:
-Pse ti s'je i zoti,
s'e ha dot kurbetin?

Thotë bualli:
-Heshtja moj bullicë
është ambient mbyttës,
vërtetë fjala jote
është faktor shtytës.

Për kurbet bualli
u nis me këtë pretext,
shkoi ku kish dashnoren
faktori tërheqës.

QEVERIAE KAFSHËVE

U mblodhën në kryesi
kafshët qeveri:
-Rrugët të ndryshojmë
që t'komunikojmë.

Në diskutim ujku
u tregua i ngurtë:
-Soji ynë, -tha
shkon dhe rrugë pa rrugë.
Përfaqësuese dhelpra
në diskutim ngeci:
-Unë bëj si bëj
deri te koteci.

Majmuni prezent
ngrihet si debil:
-Do t'i shtrojmë rrugët
vetëm me granil.

U ngrit një ministre,
qe harusha plakë:
-Rrugët do t'i shtrojmë
të gjitha me pllakë.

Më pastaj u ngrit
ministri shejtan:
-Rrugët do t'i shtrojmë
të gjitha me xham.

Kur nga mbledhja dolën,
të tjerët panë çudi,
secili nisi të ecë
në rrugën e tij.

RRENA

Skilja sorkadhes
i pëshpëriste në vesh
dhe hundën mbante
përperjetë,
dua fjalën t'ia ngjesh,
rrenën t'ia bëj të vërtetë.
SAMARI

Ministrit ujku për ankesë
seç i vajti kali:
-Më mbyti barra e rëndë,
më vret dhe samari...

Ofshan ministri shumë,
i thotë kalit:
-Më vjen keq,
do më presësh pak në holl,
samarin kam me ta ndreq...

Thërret këlyshët
badigardë:
-Rrotull kalit të m'i vini,
ia bëni gati samarin
bashkë me këmbët kthyer
për dielli.

ME VEPPRA

Bishtin duke tundur,
belin duke hedhur
vjen zonjusha dhelprë
vota për të mbledhur.

-Më akuzojnë për pula,
më akuzojnë për rrush,
unë punoj për ju,
koshaat do t'ua mbush.

Provoni dhe një herë
se kush jam unë dhelpra,
në zgjedhjet e tjera
do tu flas me veptra.

RREGULLI TRESHIT

Më duket,
dritat janë ul paksa,
por më shumë
paguajmë qera,
ma nxirr pak, si bëhet kjo?
-Qeranë rrit, dritat pakso!
Fare thjeshtë,
rregull i treshit
të mbyll sytë,
ta jep pas veshit.

NASTRADINIKËNDEZ

Ia pat njeri: -Bëra vezë!
Edhe tjetri si i pari
dhe me radhë
gjithë sa ishin,
nga një vezë
të fshehur kishin,
Nastradini rrahu krahët,
ki, ki, ki filloi këngën,
gjithë këto pula
që bëkan vezë
duan patjetër një këndez.

TI, ANUKE SHEH?

Gomarin kish vënë përpara,
xha Aliu prapa tij,
një makinë e ndiqte pas
ta-ti-ta me bori,
xha Aliu mirë s'dëgjonte,
ndaj gomarin s'e trazonte.
Me grusht shoferi rreh
gabinën:
-A s'e sheh, or qorr,
makinën?
-Unë nga prapa s'të
paskam parë,
ti, përpara, s'e sheh
gomarë?!

Edmond Z. ÇUPI

Brenda dhe përtej hekurave

...Ajo që dua t'ju them lexuesve të mi, është se unë nuk ju drejtohem në emër të një poeti, i cili "rënkon" me ngulm dhe në të njëjtën kohë me dëshirën që talenti dhe dhuntia e botës së tij shpirtërore të dalë në pah, por unë ju drejtohem si bashkëatdhetar dhe, nëse më lejoni, si shoku juaj, që të mundoheni të kuptoni dhe t'i bashkoheni pak, një bote, që pa dashur ka ngacmuar dhe trazuar një qetësi, e cila ndoshta s'do të kthehet kurrë, madje as hija e saj...

RRUGAE JETËS

Një rrugë e gjatë
që s'ka mbarim,
Ec ditë e natë
e vuan shpirti im.
Kjo rrugë e shkretë
s'e di ku të çon
Vallë në këtë jetë
ndokush a mendon
Që rruga e jetës
mund të jetë e gabuar
Këtë faj i vë vetes
pse nuk kam menduar.
Ah! Kjo jetë e vrarë
shumë, më është tretur
As nuk jam gjallë
e as nuk kam vdekur
Si një rrugë të qetë
e pa errësirë
E dua këtë jetë
e dua sa më të mirë.

JETA

Jeta është e bukur,
po unë s'e vlerësova,
Jeta është dashuria,
po unë s'dashurova,
Jeta është si mjalti,
po unë s'e provova,
Jeta është fëmija,
po unë s'e krijova,
Jeta është dhuratë e unë
s'e pranova,
Jeta është gjithçka,
po unë s'e mendova.

DRITË E SHUAR

Një dritë qenka shuar
e një tjetër e zbehur.
Dhe dielli qenka larguar,
thua se është tretur.

Qielli duket i turbulluar
e toka krejt e nxirë.
Trishtimi është shuar
asgjë s'po duket mirë.

U fikën të gjitha dritat,
që ishin të ndezura flakë.
U shuajtën, u tretën,
humbën krejt nëpër natë.

Kur do të kthehet ajo dritë,
që rrugën të ma ndriçojë
dhe nata të bëhet ditë
gëzim, lumturinë të ma
zgjojë?!

SIKUR TADIJA

Sikur ta dija që do të vuaj
kaq shumë.
Do të hidhesha në
humnerën
e pafud.

E atje do të tretej
trupim.
Pa zemër mbi shtat dhe
shpirti
në perëndim.

Një zog do të qëndronte
në kafkën time.
Me këmbët fije
e shtatin thërime.

Zogu do të këndonte
këngë
kaq të bukur.
Për jetën time të fituar
apo të humbur?!

Shpirtin do të ma preknin
retë e bardha.
Deri në shkëmbin
dhe male të larta.

Aty ku dëborë as në verë
nuk shkrin.
Aty ku dhe zjarri flakëruet
ngrin.

Në këtë botë do të mbetej
vetëm varri im.
I pagjetur ndoshta kurrë
dhe pa mbishkrim.

ENDACAKU

Endu, endu nëpër rrugë,
o i gjori endacak.
Kush të jep një copë bukë
zemrën ta ngroh ndopak.

Endesh ditë e endesh
natë,
nëpër rrugët e paanë.
Në një vend po të rrish
ty as toka nuk të mban.

Këmbëzbathur e rroba
grisur,
endesh rrugëve pambarim.
Asnjeri ty s'të ka grishur
veç të shohin me përçmim.

Sa po vuan i shkreti ti,
ta ndjen veç e bardha
zemër.

Kush të thotë se ti nuk di
nuk është zgjuar, por në
ëndërr.

VAJI INËNËS

Aty ku malit të shkretë,
këndon qyqja me rënkim,
ulur përmbi një degë
shpreh një ngashërim.

Zbehet dielli nëpër ditë,
shuhet hëna nëpër natë
në qiell shkon një shpirt
dalur nga njeriu i ngratë.

Kush rënkon? Kush qan?
Dhimbja cilin prek?
Po vajton e shkreta nënë,
se djali i ka vdek...

K'NO BILBIL

Shkruajtur në dialektin
e fshatit tim Kaçinar,
Mirditë.

K'nò bilbil, k'nò
se pranvera q'tash ka dâl'.
Dil maleve ene g'zò
se lirin' ta kam fâl'.

Ene un' k'tu k'noj,
kangën e vajit tëm.
Se ki ven më shkat'rroi
më bani krejt verëm.

K'noj lirin', qi s'e kam,
K'noj për dekën, qi s'më
merr.
Tash në varr un' jam
frymën kam e zanin djërrë.

K'nò bilbil, k'nò
për mu, fatzì.
Mos rri, por shko
ene un' do t'vij...

CUCA E MALIT

Oj cuca e malit,
a ma qet pak ujë.
Ta laj dërsën e ballit
etjen pak ta shùj.



Po mor mec i ri,
ujë unë po të qes.
Veç mos më shif me sy
se dikush na njëf.

Kushdo le të na njofë
se nuk ka kurrëgjà.
Prej kësaj kohe,
nuse du me të bà.

Kadal mos u ngut,
se fjalën s'un ta jap.
Vitët kur t'i mbush
hajde më shif prap.

SILULE

Si lule e porsa çelur,
më dukesh se je ti.
Duke të përkëdhelur
më ngjall veç dashuri.

Sa yje ka qielli,
sa ujë ka në det.
Ti, më je si dielli
që na jep dritë dhe jetë.

Fytyra jote plot shkëlqim
e flokët e tua të arta.
Pa ty, s'kalon jeta në
trishtim
ku ditët dhe netët s'janë
më të gjata.

Në ëndërr kur të shikoj
e veshur për nusëri.
Veten e mallkoj gjithnjë,
që s'jam atje me ty.

Për ty unë po mendoj,
e ndoshta ti për mua.
Pse s'bëhemi të dy bashkë
si mish e thua?!



Ervisa RUKA

Shkolla e Mesme, BRUÇ

Melodi zemre

E DUA BOTËN TIME

Mes ëndrrës dhe realitetit ka gjithnjë një zhgënjim, por unë dua të shpresoj për qetësinë e shpirtit tim.

Pa fjalë të kota, pa u ndrojtur nga bota, pa frikë e pa nënkuptime e dua botën time.

MELODI ZEMRE

Hidhen ngadalë hapat në dysheme me psherëtimë që përplasen në mure, qielli është mbushur me rë, zemra me nxehtësi furre.

Xhamat e dritareve kërcasin, era dhe shiu po i godet, të dridhurat trupin e vrasin, dhimbja trupin e vret.

Ndihet një melodi e lënduar qetësia çdo gjë e mbulon, çdo lëvizje e ka gllabëruar dhe melodia e zemrës vazhdon.

JO URREJTJE

Mjergulla më pengon shikimin, shiu po më lag ngadalë, rrufetë kanë nisur shkarkimin por as uragani s' do të më ndalë.

Edhe nëse tërmeti do të më rrëzojë, edhe nëse vullkani do të më djegë, edhe sikur gjithçka të jetë lojë pendimin s' do ta lë të më prekë.

Mbase goja do të më thahet nga etja, zemra e ngrirë s' do të mund të ngrohet, unë, kurrë, s' do të di ç' është urrejtja do të kem veç dashuri, që sa vjen e shtohet.

DUA...

Dua të jem diell për sytë e tua, për ty që je i verbuar, dua të përkthej çdo fjalë që thua sepse kurrë s' të kam kuptuar.

Që të të njoh ty dua të jem vetvetja, nuk dua që nga ato sy të të dalë urrejtja.

Dua çdo armë që të mbron, dua mësimin që ty të spjegon, nuk dua nga vuajtja të vuash, dua një fjalë të më thuash.

KTHEHU DIELL!

Kthehu diell të të shoh, kthehu e më ngroh, mos u bëj ti i lig herë vjen e herë ik.

Kthehu diell për mua të premtot, do të të dua në s'beson në fjalën time nuk të jap më premtime.

Nëse unë të mashtroj, shkrimë, mos të egzistoj nëse të them të vërtetën kthehu diell, shpëtom jetën.

NDRYSHIMI

Kur njerëzia humbi vlerën s' mbeti gjë e vërtetë, unë vendosa për pranverën, botën ta ndryshoja vetë.

Por kur arrita gjithçka dhe formulën pata në duar, e kuptova si në shakà isha unë që duhej ndryshuar.

SIKUR

Sikur të kisha fuqinë e meteorit do të godisja mu në zemër të tradhëtarit, sikur të kisha nxehtësinë e qershorit shpirtrat e ngrirë do të ngrohja të parët.

Sikur të isha magjistare do të pasqyroja ato që dinë të duan, sikur të isha këngëtare me zërin tim do të himnizoja gruan.

Sikur të isha... Mendoj e flas me vete, digjem si pisha nga flaka e kësaj jete.

QAJ ME ZEMËR

Qaj me zemër e jo me sy, qaj për vete, jo për të dy neve, dy, nuk ekzistojmë, asgjë bashkë nuk krijojmë.

Mos u mundo me mashtime nëse e njeh kokën time, kur të flasësh më shih mua, mos ngjyros në ato që thua.

Se unë jam si një bletë të afrojmë mjaltë, të helmojmë vetë mos u shtir me mua, djalë se unë ty s' ta them një fjalë, qaj me zemër, qaj me sy qaj për vete, jo për të dy.

ZEMRA NUK HESHT

Arriti të heshtë goja, arriti syri të shmangë vështrimin, ende pa mbaruar boja humbja dha paralajmërimin.

Në mes inatit hyri tërbimi por ishte betuar mos të shprehej, si shërim do të ishte çlirim, çdo sekondë gjaku nxehej.

Me mendje u shmang gjithçka, ndjenjave u ktheu shpinën, por kjo nuk ishte shakà, as lule që thahej me stinën.

Gjithçka ishte shkruar në zemër, me tërë trupin ajo flet, ndonëse askush s' e dëgjon një përgjigje pret, pret.

TI MOJ ËNDËRR

Ti moj ëndërr e netëve të gjata mos ma bëj realitetin të humbur, me ty e shkurtër më duket nata, pa ty gjithçka zhytet në pluhur.

Ti moj ëndërra ime, sa premtuese aq zhgënjyese më je, që kur fillovet të bëhesh mashtuese besimin tim nuk e ke.

Dua apo s' dua, ti je me mua ti moj ëndërr ke pretendime, nuk do t' i ndjek ato që thua, realiteti është ëndërra ime.

HESHTJA IME

Heshtja ime flet, heshtja ime s' vret, ajo më vret veç mua jo njerëzit që dua.

Heshtja ime s' përbuz, me heshtje unë lus, kërkoj dhe përgjigje të ndryshohen ca ligje.

Të ndryshoj shoqërinë barrë të madhe kam mbi shpinë, ndaj me heshtjen time dua vepra, jo fljime.

DO TË DOJA

Do të doja të isha trëndafil mes luleve, mes barit, në çdo stinë nuk do ta kisha të vështirë pa meritë të fitoja lavdinë.

Do të doja të isha yll i zjarrit, mes qiellit të bija në sy, të ndriçoja në çdo natë dhomën tënde, o njeri.

Do të doja të isha ëndërr, të vija në gjumin tënd, nëpër iluzione të të shoqëroja nëpër botë anë e kënd.

Do të doja të isha gomë të fshija të gjitha gabimet, por më mjafton kjo që jam, pa harruar përmirësimet.

KU?

Ku humbi ëndërra ime që lindi bashkë me mua, ku ikën ata pretendime të kem gjithçka që dua?

Ku humbi ajo zemër plot furi që s' mund të humbiste, po ajo mendje dhe ai sy që realitetin do të shihte?

Mos vallë më janë fshehur e dot s' mund t' i shoh, apo jam e dehur dhe veten s' po e njoh?

Klevisa ÇIRA

Shkolla e Mesme "Shaban Çollaku", KLOS

**Nëse kjo botë...****S'KAM FAJ**

S'kam faj
nëse pranë detit
qëndrojmë.

S'kam faj
që njerëzit me mendime
kaplojmë.

S'kam faj
nëse jeta e vdekja me mua
bashkë qëndrojnë.

S'kam faj
nëse si oaze sytë e mi
të tjerët admirojnë.

GJETA VETEN

Në portën e poezisë trokita,
Mezen e mençurisë porosita.

Në shpirtin e urtësisë mbeta,
Pranë lumit pa kuptim ku
dergjat jeta.

HESHTJA

S'e kam kuptuar;
Pse kërkojnë që unë të hesht
Dhe kur jam në majë të malit,
Kur dihet se një ditë
Patjetër do të hesht...
Në grykë të varrit?!...

UJËRA TË TURBULLUAR

Zgjatëm drejt
inversionit
për të prekur
të ardhmen.

Zgjatëm drejt
paqes

për të prekur
të tashmen.

Zgjatëm drejt
misterit
për të shikuar
ujërat e turbulluar.

BËMATE JETËS

Arësytet për të cilat
unë jetoj,
janë fjalët
që dua të rregulloj,
nga të cilat bota
kaq shumë lëngoi.

Arësytet për të cilat
unë shpresoj,
janë poezitë
ku do të lundroj,
nga të cilat fëmia
ëmbël t'më kundrojnë.

Arësytet për të cilat
unë lutje grumbulloj,
janë dëshirat
që pres të realizoj,
nga të cilat vetja s'di
në do humbasë, apo do
gëzojë?!...

NËSE...

Nëse dikujt
I bëra keq,
Zoti më dënoftë
Si një dreq.

Nëse kjo botë
U mbush me pafajësi
Rituali i saj jam unë,
...ndoshta dhe ti.

Leonard SUXHA

Shkolla e Mesme "Pjetër Budi", BURREL

**Vegimi****-ese-**

I hapa sytë qetësisht. Mëngjes! Bëra të ngrihesha e të ndahesha nga një tjetër botë, nga një tjetër realitet, nga i vetmi muzg i errët e i bardhë që të kuron shpirtin. Trupi me thotë "JO", mendja më thotë "PO". Çfarë dileme! Një peshë mbytëse më pushtoi duke u mbështjellur në krejt qenien time. Si me magji ndryshova botën, ndoshta ngaqë mu mbyllën sërish sytë. U përpoqa të shoh më qartë brenda meje dhe hapa dritaren kah oborri, por në vend të pamjes së përditshme m'u shtrua para një botë e vogël, e ylbërtë, gati e panjohur, ndonëse përfshinte gjëra të njohura. Se di se çfarë me turbulloi mendjen e të bija në këtë humnerë të thepisur, ku në fundin e saj ishte vetë butësia, vetë jeta. Mbylla sytë i turbullt, i paqartë! Edhe me sy mbyllur vegimi qëndronte në veshtrimin tim. Çudi apo e vërtetë, vegim apo realitet! Tani nuk ndjeja më asgjë, as minutat, as të ftohtin, as shpirtin. Po, po, as veten time nuk e ndjeja më. Isha në një hapësirë të pakufizuar nga toka pasi dheun dhe shkëmbin se kisha më pengesë. Isha në një hapsirë të pakufizuar nga uji se nuk notoja më, por mundja të ecja lehtësisht mbi petkun ngjyrë blu. Isha në një hapsirë të pakufizuar nga qielli, ndoshta, nga që ndihesha zoti i tij. Vazhdova të ndiqja misionin tim, atë mision të çudirave, jo të arsyeve e të qëllimeve. Abstrakte më dukej gjithçka. Kjo më bëri të hedh vështrimin drejt vetes. Fillova sërish të belbëzoj në mundimin tim të përditshëm, por tani nuk ishte më mëngjes. Koha kishte shkelur mbi mua vazhdimisht. Ishte ajo që i ktheu shpirtin, trupit tim. Më dhuroi kthjelltësinë e mendjes, qetësinë e dritës, bukurinë e shpirtit, ashpërsinë e duhur, harrimin e veseve, ndarjen nga vegimi...

E përsëri në një realitet të dyzuar për mua...



Bash ditën që u martua, madje fill sapo hyri bashkë me nusen në prag të derës, profesorit të fortnderuar Gjithmonë Rënies, iu kruajt paksa balli. Dhe pse e çonte dorën tash e parë kah rrashta, medemek për të fshirë djersët, dhe pse i ripërshëndeste kuturu miqtë e vet, të cilët tashmë nuk i njihte më, marrëzinë e tij, prapëseprapë, nuk e kuptoi kurrkush. Ndërsa shoi qirinjtë dhe hëngri qershinë mbi tortë, balli iu kall flakë, thua se fshinte nën të rrënojat e Trojës. Pa mbaruar ai rit absurd, pasi kishte ngjeshur shaminë e të ëmës mbi ballin e prushtë, Rënia shtegtoi vetëtimthi drejt odës së gjumit, duke lënë të habitur gjithë çka qenë aty. Pas tij u formua një mishmash zbavitës. Gratë pëshpëritën ultazi: “I shkreti Rënia, sot iu kujtua se është i tredhur”. Burrat thanë: “Nusja, ashtu si pushka, është shpikur për të matur burrat”. Vetëm miku i tij më i shtrejtë, doktor Tërmeti, me të cilin e bashkonin të njëjtat dobësi, nuk bëzajti. Në oborr, dyer e kahdo, njerëzit lëviznin si mizat kur parashohin shiun.

I pari iu avit ungji i madh, mandej tezja e së ëmës, baba Tymi, e kështu me radhë.

- Ç’pate? T’u lag baruti? - e pyeti ungji i madh me të pesë shqisat. Krejt prisnin një përgjigje. Ndërsa Rënia ngriti dorën lart, duke i lënë të kuptonin se duhet ta linin të qetë, sepse në të dy skajet e buzëve i varej lëndueshëm shkumbë e verdhë. Të gjithë njerëzit u hapërdanë, përveç doktorit dhe nuses së sapoardhur, Emës. I shtrirë në shtratin e shenjtë martesor, tërë vullneti i tij qe mbledhur veç me marrë frymë. Para tij po tretej vajtueshëm gjithçka. Ç’e gjeti me të vërtetë profesor Rënie? Pse pikërisht në atë ditë? Ishte magji e plakave të mëhallës apo një tultatje fati?

Si ndenji disa çaste pa bërë kurrgjë, doktor Tërmeti u afrua kah Rënia si pikëpyetje e madhe. Ai ishte një burrë madhosh e me kokë të rruar. I kuq. Me mjekër të dendur. Natyrë e mefshtë dhe serioze. Kishte veshur pallto lëkure, e cila i varej deri tek këpucët. Në fytyrën e vrazhdët dhe të

gjakët. Kurrënjëherë s’kish buzëqeshur. Bash në mollëzën e faqes së majtë, shtrihej një varrë djegieje qyshkur.

-Tërmet! -bëzajti Rënia, me një zë sa të mykur aq dhe të gërvishtur, sakaq hapi njërën sy (të djathtin). -Po shoh vdekjen dhe të vërtetën e ekzistencës.

- Sheh një mut, - i nëpërdhëmbi doktori.

- Dyshimi i tepruar është vetëvrasje, miku im. Si të duash. Unë do t’i rrëfej, në më të lëntë Zoti me kallzue.

- Me syrin që hape apo me tjetrin po i sheh? - e pyeti doktori.

- Me tjetrin, - u përgjigj profesori.

- Si qenka pra, hë?

- Kush?

- Vdekja pra?

- Aha, qenka grua. Më zhgënjeu. Nuk duhet të ishte e tillë. Duhet të ishte burrë. Të paktën kështu e kam imagjinuar gjithmonë.

- Ema! - iu drejtua Emës.

- Na lër vetëm. Nuk dua ta shohësh shpirtin tim që del si ketri nga zgavra e lisit.

Ema, e fantaksur dhe e huaj plotësisht, ngjante si pëlhurë merimange. Sakaq hija lëvizi dhe u zhduk. Ndonëse doktori e mbylli derën me shul, Rënia akoma fliste ultazi dhe i frikuar.

- Si është e mundur që veç në ditë të dielash më bien flokët? - e pyeti Rënia.

- Këtu nuk ka gjë të pazakontë, po ta krahasojmë me rastin tim. Unë jam i sigurt se kam krijuar perendinë dhe nuk e mbaj mend se si. E tash, ajo, tall trapin me mua. Nuk thonë kot; “Rrite këlysh se të ha qen”, as se “Lisin e shqyen pyka e vet”. Të t’a rrëfej ëndrrën kur unë isha tren?

- Jo. Mirëpo, ç’t’u desh me rras veten në telashe që krijove...? - pyeti Rënia.

- Vetmia, vetmia miku im. Të dy palët, si njerëzit ashtu dhe perëndia nuk rrinë pa njëri-tjetrin. A ka gjë shpirtërore dhe njerëzore në biznes? Megjëithse në fillim e kisha nisur me pavetëdiqe, pastaj kot për pordhë. Mandej, nuk do ta duroja më vetminë. Ndiheha bravë e mbyllur, madje edhe pa vend çelësi. Nuk pajtohesha absolutisht me idenë se, në vrapimin jetësor, gjithsecili të jetë i pari dhe i fundit, -tha Tërmeti.

Fytyrën e Rënies e kishte zaptuar një çehre e zbehtë paqefësie. I shtrirë në kurriz, kruante ballin ngjeshëm thua se po zbulonte misterin e vet. Ndërkaq, teksa lëvizte e shkujdesur në mes ballit prush, dora e tij

fatndjellëse, preku diçka imtake, të mezidukshme, si këmbë mize, dhe mbeti e gozhduar në ajër. Pa prituri ndihmën e shokut, doktori kapi pincat, vuri syzet, dhe iu afrua krejt afsh duke e tërhequr me lehtësi atë fije enigmatike (nëse mund ta quajmë kështu). E tërhoqi një bërçik, me kureshtje dhe frikë bashkë.

- Vallë mos të kanë qepur ndonjëherë plagë në vogëli? - e pyeti doktori.

- Shumëherë, por jo me pe, mi mbyllnin me baltë, - iu përgjigj Rënia.

Sakaq doktori u bind, se fija e zezë nuk ishte pe plage, por diçka tronditëse dhe misterioze, jo vetëm në historinë e mjekësisë por për çdo shkencë që ka në qendër njeriun.

- Ah, o Tërmet! Të lutem tërhiqe më fort. Më fort. Fort. Po ndiej një lehtësim madhor. Prekma ballin. M’u bë akull, si guri i varrit tim. Dhe dëshira për vetëvrasje m’u tret, - klithte Rënia.

Si ia tërhoqi nja dy pash, Rënies iu ba gjaku qumësht dhe zgërdhihej si kalë. Peri i qenies së tij ishte i pafud.

- Miqësisë tonë të tmerrshme po i vjen fundi. Pa dyshim, ne do t’i hapim udhë një epoke të re, - i tha befaz Rënia.

- Qenka qartësia jo mjegulla, ajo që e çmend njeriun, - i tha doktori.

- Natyrshmëria dhe çmenduria nuk janë njëlloj.

- Atëherë, pse u martove?

- Martesa ime do të jetë një bushtër mjaft idhnake, e cila do ta ruaj bukurfort mbretërinë tonë.

Ndërkaq, lot të nxehtë e të qartë vareshin në anët e hundëve të të dy burrave. Jo lot dhimbje e dyshimi. Rënia u kënaq edhe më shumë, kur Tërmeti zuri një pëllumb dhe, pasi i lidhi në këmbë fillin e perit që dilte nga balli i Rënies, e hodhi nga dritarja në fluturim drejt qiellit. Ndërsa kishin vënë këmbët në supe të shoqishoqit, ato ngazëlleheshin me kurorëzimin e fatit të tyre. Aty nga ora tre e natës, nga dhoma e çiftit të ri, u dëgjua një krismë e shurdhët pushke, e cila u pasua fill nga disa të lehura qenësh. Ndërsa flinte në hapsanën e shtëpisë, Ema e dëgjoi krismën si në pavetëdiqe, dhe për një çast e mori si emblemën e çnderimit të saj, por, aty për aty u bind se merimangat dhe lakuriqët e natës nuk ia kishte trazuar kurrkush.



Poezitë e jetës

Vjollca KURTI



Suada Tafa, aktualisht është nxënëse në vitin e dytë në shkollën “28 Nëntori” dhe vjen përpara lexuesit me vëllimin e parë poetik të saj të titulluar “Poezitë e jetës”, një titull mjaft domethënës e premtues për lexuesin.

Suada ka filluar të shkruajë që në moshë fare të vogël, që kur ishte nxënëse në klasën e tretë. Lexuesi matjan ka lexuar dhe poezi të tjera të Suadës të cilat janë botuar në gazetën “MATI” dhe revistën “EMATHIA”. Suada ka marrë pjesë në konkurse të ndryshme letrare të zhvilluara brenda shkollës dhe midis shkollave të mesme të rrethit tonë, ku gjithmonë është vlerësuar me çmime nderi.

Talenti dhe këmbëngulja e saj bënë që ëndërra e Suadës tashmë të bëhet realitet. Ajo vjen përpara nesh si poetja më e re matjane me 73 poezitë, të cilat mbartin ndjenjat më të larta njerëzore. Ndaj Suada shprehet mjaft qartë që në poezinë e parë “Po vij”:

*Ndihesha vërtet gati
Gati për të udhëtuar
E duhej nisur vrapi
Për të më patur në duar.*

Tematika e poezive të këtij vëllimi është e larmishme. Suada shkruan për

atdheun, dashurinë, familjen, shoqërinë, për jetën në përgjithësi, për gjuhën shqipe, ëmbëlsinë e saj si dhe për drogën, alkoolin, mërgimin si dhe vdekjen. Por në qendër të saj qëndron ëndërra, ëndërra për jetën, të mirën, të bukurën, ëndërra për të ëndërruar. Në poezitë e saj Suada shprehet herë e gëzuar e me shpresë, herë e trishtuar e me lot në sy, megjithatë ajo është gjithmonë optimiste për të ardhmen, optimizëm ky i shprehur te një varg poezish si: “Optimizëm”, “Pranvera e shpirtit tim” etj.

*S’ë kam as më të voglin dyshim
Kjo është pranvera e shpirtit tim.*

Poetja më e re matjane në poezitë e saj shprehet:

*Rinia mbaron pa filluar
prandaj duhet jetuar.*

Por në dashuri ajo ndihet here e lumtur e herë e trishtuar apo dhe e tradhëtuar. Nëpërmjet poezive të saj Suada ngrihet në mbrojtje të jetimit, të pafajshmit dhe njëkohësisht kundër padrejtësive që i bëhen njeriut në përgjithësi e jetimit në veçanti: “Ku është fshehur

drejtësia?” pyet poetja e re matjane në poezitë e saj.

Një vend të veçantë zënë dhe poezitë atdhetare në këtë vëllim, motiv ky që shprehet që në poezitë e para, ku Suada e ndien veten krenare është shqiptare si në poezitë: “Suada shqipëtare”, “Dy atdhe”, “Shqiptar i vërtetë” etj.

*Vetëm shqiptar unë jam
vërtet për nder këtë e kam.*

Në çdo varg të këtij libri gjejmë një copëz të shpirtit të saj, në çdo varg të tij gjejmë një ndjenjë të saj, në çdo strofë një copëz jete e në çdo poezi gjejmë një ëndërr e çdo ëndërr lind që të bëhet realitet, por ëndërra është një majë që duhet arritur: shprehet Suada.

Të gjitha këto ndjesi shprehen në poezitë e këtij vëllimi me një varg herë të lirë e here të strukturuar mirë metrikisht, në të cilat gjejmë dhe një figuracion të pasur që premtton në ardhmen e një përsosje të vargëzimit poetik.

Dhe së fundmi shpresoj dhe i uroj njëkohësisht Suadës që të arrijë vërtet majat e suksesit në këtë rrugë artistike që ka nisur me vëllimet e saj të ardhshme që do të sjellë përpara lexuesit.



Jashtë absurdit të ligjit të maleve

*“Të ik apo të ndjek ligjin e maleve?”.
Kjo është dilema që zhyt në krizë personazhet e Koliqit dhe Kadaresë,
përkatësisht Dodën dhe Gjorg Berishën.*

Ensuida KOLA

“Nderi e ka selinë e tij në lule të ballit. Je i lirë të mbash burrërinë tënde, je i lirë të zhburrërohesh”, frazë kjo që malësori e ka të ngulitur thellë në mendjen e tij dhe e di më së miri se ky nder nuk ka seli tjetër. Di gjithashtu që pajtimi është tepër, tepër i rrallë, ndaj... duhet të zgjedhë... Por, a duhet vallë të mbetemi robër të kësaj fraze, robër të gjakmarrjes? Pyetje kjo, që me dekada të tëra qëndron në erë e askush nuk jep një përgjigje, sepse edhe po të tentojë dikush të gjejë një të tillë, ata, malësorët, mbrojtësit deri në vdekje të kanunit, do ta refuzojnë, sepse për “ta nderë është pushka e bukur” (*kur hasmi goditet në qendër të ballit*), hakmarrja me gjak dhe s’ka vend për zgjidhje tjetër. Por, a janë të një mendimi me këta të gjithë malësorët njëherazi? A ka ndonjë prej tyre që nuk e do hakmarrjen dhe vuan prej saj?

Pikërisht për këtë, për të përcjell gjendjen shpirtërore të malësorit tjetër që vuan, që është kundër gjakmarrjes dhe është gjendur padashur në vorbullën e frikshme të saj, shkrimtarët e njohur Ernest Koliqi dhe Ismail Kadare kanë mundur ta pasyrojnë qartë portretin e tyre në librat e botuara “Hija e maleve” dhe “Prilli i thyer” nëpërmjet personazheve: përkatësisht Dodës dhe Gjorg Berishës. Dhe natyrshëm lind pyetja: Të gjendur në këtë vorbull të frikshme të gjakmarrjes, sa e duan “pushkën e bukur” Doda dhe Gjorg Berisha?

Po të hedhësh një vështrim në psikologjinë e tyre, vëren një luhatie që të befason, sepse ëndrrat dhe idetë e tyre nuk janë të lidhura me ëndrrat dhe idetë e malësorëve të tjerë. Ata shohin ndryshe, mendojnë ndryshe, dashurojnë ndryshe... Si të tillë, e gjejnë veten jashtë ambientit malësor, jashtë absurditetit të ligjit të maleve. Të dy shkrimtarët, Koliqi dhe Kadare, e kanë paraqitur bukur këtë lënie jashtë ambientit malësor, sepse të dy



personazhet dëshirojnë rrjedhë tjetër të jetës, kërkojnë frymëmarrje, qetësi, liri dhe jo krenari të fituar nga një hakmarrje e dhimbshme. Ndaj, kriza e tyre është e pashmangshme. Kanë në vetvete një luftë të brendshme, e cila i gërryen fort nga brenda. Kjo luftë do të jetë e përkohshme, sepse shtypet nga një vështrim i egër i babait, i cili është sfidues dhe nuk le rrugë tjetër, veçse të hakmerret. “Shikoje këmishën, -tha tjetri, duke bërë me kokë nga këmisha e varur në murin përballë. Gjorgu ktheu kokën anej. Iu duk se damarët e qafës i kërcitën, sikur t’i kishin zënë ndryshk”.

-Gjaku po zverdhet në ‘të, -tha i ati, -i vdekuri kërkon shpagim.

-Ti po vuan shumë, Gjorg, -vazhdoi i ati. -Nderi ynë, por sidomos yti...”¹

Imponimi është i jashtëzakonshëm. Vështrimet janë shigjeta në shpirtin e Gjorgut. E me të njëjtat vështrime dhe shigjeta përballët edhe Doda, vështrime që do ta çojnë drejt hakmarrjes, sepse “ai s’mund ta ndjejë më veten në rolin e misionarit dhe

heroit kulturor, por bëhet një anëtar i zakonshëm i kolektivitetit. Ky kolektivitet madje hyn përfundimisht në jetën e tij personale, në qetësinë e ëndërruar...”²

Mposhtet... E pra, janë dy të rinj, që përfundimisht ligji i maleve arrin t’i bëjë pjestarë të forcës së tij të pathyeshme, arrin t’i shndërrojë në vrasës pa dëshirë. E për tu bindur plotësisht, që as Gjorgu e as Doda nuk duan ta zbatojnë ligjin e maleve, shohim se të dy në një çast të caktuar kërkojnë në mendjen e tyre të gjejnë shpëtim në një mënyrë tjetër, aspak e mirë për zakonin, duke u tërhequr në një “ikje”. Lutja që i bën Doda vëllait të vdekur, Zekës, është domethënëse: “Jo Zekë, mos e kërko prej meje, ma mirë a me vra veten?”³ Ndërsa Gjorg

Berisha e pasqyron edhe më bukur dëshirën për ikje. “Dy-tri herë i shkrepin në kokë të dilte nga kjo gjendje pa kuptim, të ikte me vrap nga ky grumbull kësolltarësh, le ta shanin, le ta tallnin, le të thoshin se ai shkeli zakonet qindravjeçare, madje le të shinin pas shpine po të donin, vetëm të ikte, të ikte...”⁴ Ajo ikje vërtetë ishte e pamundur, sepse zakoni i kishte rrënjët thellë, shumë thellë dhe të dy, si Gjorgu dhe Doda, e dinin se nuk kishte kthim prapa, nuk kishte ikje... “Ashtu siç nuk kishte ikur dot gjyshi, stërgjyshi, katrajgryshi i tij, pesëdhjetë, pesëqind, njëmijë vjet më parë”.⁵

Referenca:

1. I. Kadare: *Prilli i thyer*. Tiranë 1981, faqe 38.
2. S. Hamiti: *Letërsia moderne shqiptare*. Tiranë 2000, faqe 21.
3. S. Hamiti: *Letërsia moderne shqiptare*. Tiranë 2000, faqe 213.
4. I. Kadare: *Prilli i thyer*. Tiranë 1981, faqe 15.
5. Po aty, faqe 15.